



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2026 – Numri: 165

Tiranë – E enjte, 30 korrik 2026

PËRMBAJTJA

	Faqe
Ligj nr. 65/2026, datë 16.7.2026	Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore..... 16717
Dekret i Presidentit nr. 432, datë 27.7.2026	Për shpallje ligji..... 16722
Ligj nr. 66/2026, datë 16.7.2026	Për censin e bujqësisë..... 16722
Dekret i Presidentit nr. 435, datë 28.7.2026	Për shpallje ligji..... 16731
Ligj nr. 67/2026, datë 16.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, i ndryshuar..... 16732
Dekret i Presidentit nr. 433, datë 27.7.2026	Për shpallje ligji..... 16733
Ligj nr. 68/2026, datë 16.7.2026	Për një ndryshim në ligjin nr. 103/2016, “Për akuakulturën”, i ndryshuar..... 16733
Dekret i Presidentit nr. 434, datë 27.7.2026	Për shpallje ligji..... 16733
Ligj nr. 83/2026, datë 23.7.2026	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar..... 16734
Dekret i Presidentit nr. 440, datë 29.7.2026	Për shpallje ligji dhe dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit..... 16735
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026..... 16736

Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16740
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16744
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Prokurorit të Përgjithshëm për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16747
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16750
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Avokatit të Popullit për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16754
Rezolutë e Kuvendit datë 23.7.2026	Për vlerësimin e veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vitin 2025 dhe rekomandimet për vitin 2026.....	16755
Udhëzim i ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe i ministrit të Financave nr. 6, datë 17.7.2026	Për miratimin e procedurës për mbledhjen dhe përdorimin e të ardhurave dytësore që krijohen nga pagesa e subjekteve të interesuara për promovimin e aktiviteteve dhe për shërbimet turistike në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit.....	16758
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 147, datë 30.6.2026	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë të energjisë elektrike në Shqipëri, 2026–2030.....	16759
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 824/8, datë 22.7.2026	Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, “Rikualifikim urban, sheshi pranë shkollës ‘Martin Camaj’”.....	16781
Vendim i Gjykatë së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë nr. 2070, datë 23.4.2026	Me objekt miratimin e Raportit të Administratores së Falimentimit të datës 22.1.2026, për “Mbylljen e procedurës së falimentimit të ‘Albit Diabra’ sh.p.k.” shoqëri në procedurë falimentimi.....	16783



LIGJ
Nr. 65/2026

PËR DËFTESAT TREGTARE MBI
PRODUKTET BUJQËSORE

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky ligj përcakton rregullat për lëshimin e dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, të ardhshme dhe ato të magazinuara, si instrumente financiare të garantuara me barrë siguruese, për procedurat e regjistrimit, si dhe mënyrën e përmbushjes e të ekzekutimit të tyre.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është nxitja e financimeve në bujqësi, mundësimi i pagesave të shpejta dhe të drejta për fermerin, si dhe krijimi i një sistemi kolaterali të produktit bujqësor të ardhshëm apo të magazinuar.

Neni 3
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Aplikim”** është paraqitja e kërkesës *online* nëpërmjet portalit *“e-Albania”*;

2. **“Dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm”** është dokumenti elektronik që përbën titull të transferueshëm në kuptimin e ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, që përcakton detyrimin e pakushtëzuar të debitorit për t’i kthyer kreditorit pagesën ose livruar produktin bujqësor e

regjistruar në regjistrin elektronik e në regjistrin e barrëve siguruese;

3. **“Dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”** është dokumenti elektronik që përbën titull të transferueshëm në kuptimin e ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”, që përcakton detyrimin e pakushtëzuar të debitorit për t’i kthyer kreditorit pagesën ose për t’i dorëzuar produktin bujqësor të magazinuar, e regjistruar në regjistrin elektronik e në regjistrin e barrëve siguruese;

4. **“Debitor në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm”** është fermeri që merr financimin, të cilin e përdor për kultivimin e produktit bujqësor, dhe me të ardhurat e krijuara merr përsipër të shlyejë kreditorin;

5. **“Debitor në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar”** është depozituesi, i cili e përdor dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar si garanci për kontratën e kredisë;

6. **“Depozitues”** në kuptim të këtij ligji është fermeri që depoziton produktet bujqësore në magazinë;

7. **“Fermer”** është personi që ushtron veprimtari bujqësore e blegtorale sipas legjislacionit në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

8. **“Kreditor në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor”** është subjekti që ofron financim për debitorin dhe ka të drejtë të marrë pagesën apo produktet bujqësore në masën e në mënyrën e përcaktuar në dëftesë;

9. **“Magazinues i produkteve bujqësore”** është subjekti që ushtron veprimtarinë si operator i biznesit ushqimor;

10. **“Ministër”** është ministri përgjegjës për çështjet e bujqësisë;

11. **“Ministria”** është ministria përgjegjëse për çështjet e bujqësisë;

12. **“Periudhë e maturimit të dëftesës tregtare”** është afati i përcaktuar në dëftesën tregtare brenda të cilit debitori duhet të përmbushë detyrimin;

13. **“Produkt bujqësor”** ka të njëjtin kuptim sipas legjislacionit në fuqi për bujqësinë dhe zhvillimin rural;

14. **“Regjistër elektronik”** është regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, i përfshirë në sistemin elektronik të ministrisë përgjegjëse për çështjet e bujqësisë;



15. “**Regjistër i barrëve siguruese**” është regjistri i krijuar me ligjin nr. 8537, datë 18.10.1999, “Për barrët siguruese”, i ndryshuar.

KREU II
DËFTESAT TREGTARE MBI
PRODUKTIN BUJQËSOR TË ARDHSHËM

Neni 4

Kushtet e lëshimit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm

1. Fermeri që ka në pronësi ose në posedim një sipërfaqe toke bujqësore në të cilën është duke kultivuar apo ka për qëllim të kultivojë produkte bujqësore në të, ka të drejtë të plotësojë dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm.

2. Transferimi i titullit të pronësisë ose i së drejtës së përdorimit të tokës nuk e shuan detyrimin që buron nga dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe as nuk i shuan të drejtat e debitorit dhe të kreditorit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm deri në fund të periudhës së maturimit, por jo më herët se data e përmbushjes së detyrimit që buron nga dëftesa.

Neni 5

Procedura e lëshimit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm

1. Aplikimi për dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm bëhet *online* nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Fermeri që kërkon të përfitojë financim nga një i tretë kundrejt lënies si kolateral të produktit bujqësor të ardhshëm që kultivohet prej tij plotëson formularin e aplikimit për dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm. Interesi i financimit të dhënë nuk mund të kalojë normën mesatare efektive mujore të interesit të kredive bankare të muajit paraardhës të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Për subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë, interesi i financimit rregullohet nga legjislacioni përkatës.

2. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm gjenerohet automatikisht nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Vërtetimi për regjistrimin e dëftesës lëshohet automatikisht me vulën elektronike të ministrit. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm përbën titull ekzekutiv.

3. Këshilli i Ministrave miraton me vendim formatet tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm dhe të shprehjes së interesit, duke përfshirë elementet e nevojshme për përmbushjen e transaksionit.

Neni 6

Garancitë e dëftesës tregtare

1. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm ka si kolateral vetë produktet bujqësore të përcaktuara në objektin e saj, me përjashtim të rastit të parashikuar në pikën 6 të këtij neni.

2. Vlera e kolateralit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm nuk mund të jetë më e vogël se detyrimi kryesor dhe interesat përkatës të financimit të parashikuar në të, si dhe shpenzime të tjera të financimit të kryera nga kreditori.

3. Debitori është përgjegjës për cilësinë e produkteve bujqësore të kultivuara, të cilat janë kolateral i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm.

4. Kur për shkak të mangësisë së produkteve bujqësore nuk është e mundur shlyerja e plotë e detyrimit sipas kësaj dëftese, debitori duhet ta zëvendësojë produktin bujqësor me një kolateral tjetër me të njëjtën vlerë të mbetur, cilësi dhe karakteristika të rëna dakord në dëftesën tregtare.

5. Nëse debitori nuk arrin ta zëvendësojë produktin sipas pikës 4 të këtij neni, korretet e sezonit pasues të produktit bujqësor nga toka që u përdor për të prodhuar e korrur produktin, objekt të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm, do të konsiderohen kolateral i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm deri në shlyerjen e plotë të detyrimit të parashikuar në të.

6. Në rast mospërmbushjeje të detyrimit me kolateralin e përcaktuar në dëftesë, debitori, me pëlqimin e kreditorit, përdor një pasuri tjetër për përmbushjen e këtij detyrimi. Në rast të mosmarrëveshjeve mbi vlerën dhe cilësinë e kolateralit, aplikohet neni 17 i këtij ligji.

7. Debitori ose kreditori mund të lidhin kontratën e sigurimit të kolateralit të dëftesës tregtare dhe i përballojnë shpenzimet e kësaj kontrate individualisht ose në mënyrë solidare.



KREU III

DËFTESA TREGTARE MBI PRODUKTIN
BUJQËSOR TË MAGAZINUAR

Neni 7

**Procedura e lëshimit të dëftesës tregtare
mbi produktin bujqësor të magazinuar**

1. Aplikimi për lëshimin e dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar bëhet *online* nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Depozituesi i produkteve bujqësore plotëson *online* formularin e aplikimit në portalin “*e-Albania*” për produktet bujqësore që ka magazinuar sipas kushteve të përcaktuara në kontratën e magazinës. Interesi i financimit të dhënë nuk mund të kalojë normën mesatare efektive mujore të interesit të kredive bankare të muajit paraardhës të publikuar nga Banka e Shqipërisë. Për subjektet që licencohen nga Banka e Shqipërisë, interesi i financimit rregullohet nga legjislacioni përkatës.

2. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar gjenerohet automatikisht nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Vërtetimi për regjistrimin e dëftesës lëshohet automatikisht me vulën elektronike të ministrit. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar përbën titull ekzekutiv.

3. Këshilli i Ministrave miraton me vendim formatet tip të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar e të shprehjes së interesit, duke përfshirë elementet e nevojshme për përmbushjen e transaksionit.

Neni 8

Të drejtat e depozituesit

1. Depozituesi ka të drejtë t'i kërkojë magazinuesit të produkteve bujqësore të lëshojë fletëhyrje magazine të veçanta për çdo dëftesë tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar.

2. Depozituesi ka të drejtë të kërkojë që produktet e shënuara në dëftesën tregtare t'i livrohen që nga çasti që janë çliruar nga regjistri i barrëve siguruese.

3. Magazinuesi nuk mund t'i përziejë produktet që ka marrë nga depozituesi me produkte të tjera të të njëjtët lloj e cilësi, me përjashtim të rastit kur depozituesi e ka dhënë miratimin për një veprim të tillë.

Neni 9

Garancitë ndaj kreditorit

1. Kreditori i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të magazinuar, të cilit nuk i është paguar shuma e siguruar me barrë siguruese brenda afatit, ka të drejtë të kërkojë nga zyra e përmbarimit, jo më herët se 2 ditë kalendarike nga mbarimi i afatit të maturimit, shitjen e produkteve bujqësore të lëna si barrë siguruese.

2. Nga shuma e siguruar nga shitja zbritet shuma e nevojshme për të mbuluar koston e shitjes, shuma e detyruar në favor të magazinuesit, nëse magazinuesi nuk e ka marrë paraprakisht shpërblimin e tij, detyrimet e tjera të krijuara nga shitja e produkteve dhe më pas shlyhet detyrimi ndaj kreditorit. Pjesa e mbetur i kalon depozituesit të produkteve bujqësore të magazinuara.

Neni 10

Kërkesat e kreditorit për pagesë

1. Kreditori ka të drejtë të kërkojë kryerjen e pagesës *online* nëpërmjet portalit “*e-Albania*” nga debitori nëse nuk e ka marrë shumën e plotë të detyrimit nga shitja si më lart e produkteve të lëna si barrë siguruese.

2. Kërkesa nga kreditori duhet të paraqitet te debitori brenda 7 ditëve kalendarike, por jo më shumë se 30 ditë kalendarike nga e nesërmja e marrjes dijeni për mosshlyerjen e plotë të detyrimit me të ardhurat e arkëtuara nga shitja e produkteve të lëna si barrë siguruese.

3. Debitori detyrohet që brenda 30 ditëve kalendarike nga marrja e kërkesës së kreditorit, sipas pikës 2 të këtij neni, të shlyejë detyrimin e mbetur.

KREU IV

MONITORIMI I KOLATERALIT

Neni 11

Monitorimi i kolateralit

1. Kreditori ka të drejtë ta monitorojë vetë ose duke përfshirë një palë të tretë objektin e kolateralit gjatë vlefshmërisë së barrës siguruese, me kusht që ta njoftojë debitorin 24 orë para kryerjes së këtij monitorimi.

2. Monitorimi përfshin vëzhgimin e objektit të kolateralit, informimin për proceset e kultivimit të



tokës bujqësore, strukturën e magazinimit, mjetet e përdorura dhe vendet e tjera, ku rritet e magazinohet produkti bujqësor.

3. Kreditori nuk ka të drejtë të ndërhyjë në veprimtarinë e biznesit të debitorit gjatë kryerjes së monitorimit.

4. Nëse gjatë monitorimit kreditori zbulon shkelje që mund të ngrenë dyshime të arsyeshme për sasi dhe cilësi të papërshtatshme të produktit bujqësor, si rezultat i kultivimit ose i mbarështimit, magazinimit, transportit apo proceseve të tjera, ai njofton me shkrim debitorin për këto shkelje dhe përcakton afatin kohor për t'i eliminuar ato.

5. Në rastet kur debitori nuk arrin t'i eliminojë shkeljet brenda afatit të parashikuar në pikën 4 të këtij neni, kreditori mund t'i kërkojë përmbushjen e parakohshme të detyrimit ose të zbatojë mekanizmin e parashikuar në nenin 17 të këtij ligji për zgjidhjen e kësaj mosmarrëveshjeje.

6. Debitori detyrohet t'i mbulojë shpenzimet shtesë me të cilat do të përballet kreditori në rastin e konstatimit të shkeljeve edhe kur kultivimi, mbarështimi, magazinimi dhe transporti i produktit bujqësor do të kryhen nga vetë kreditori.

7. Debitori mund t'ia kalojë detyrimin e tij një të treti, me pëlqimin e kreditorit.

KREU V

TREGTIMI I DËFTESËS TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE

Neni 12

Tregtimi i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm e të magazinuar

1. Kreditori ka të drejtë t'ia shesë një pale të tretë dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm e të magazinuar. Kreditori plotëson *online* formularin e aplikimit për shitjen e dëftesës tregtare, duke përcaktuar çmimin e shitjes, nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Kushtet dhe detyrimet e marra përsipër nga debitori me dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm e të magazinuar nuk ndryshojnë me ndryshimin e kreditorit.

2. Ndryshimet pasqyrohen te regjistri elektronik për shërbimet e ministrisë. Dëftesa tregtare me emrin e blerësit të ri gjenerohet automatikisht nëpërmjet portalit “*e-Albania*”. Vërtetimi për regjistrimin e dëftesës me emrin e blerësit të ri lëshohet automatikisht me vulën elektronike të

ministrisë. Dëftesa tregtare me emrin e blerësit të ri përbën titull ekzekutiv.

3. Përmbajtja e formularit elektronik për tregtimin e dëftesave tregtare, duke përfshirë elementet e nevojshme për përmbushjen e transaksionit dhe rregullat e njoftimit të palëve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI

REGJISTRI ELEKTRONIK I DËFTESAVE TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE

Neni 13

Krijimi i regjistrit elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore

1. Regjistri elektronik i dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore funksionon si pjesë e sistemit elektronik të shërbimeve të ministrisë.

2. Regjistri elektronik i dëftesave tregtare është i hapur për konsultim nga publiku, pa pagesë.

3. Rregullat e hollësishme për përmbajtjen, aksesin dhe funksionimin e regjistrit elektronik të dëftesave tregtare, procedurën elektronike të lëshimit, të regjistrimit të dëftesave tregtare dhe të fshirjes së tyre nga regjistri elektronik, mënyrën e regjistrimit dhe të fshirjes nga regjistri i barrëve sigurorese, si dhe detajet e tjera, në lidhje me ndërveprimin dhe funksionimin e këtij sistemi nëpërmjet portalit “*e-Albania*” përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 14

Njësia e dëftesave tregtare

1. Njësia e dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore ngrihet e funksionon brenda strukturës së ministrisë.

2. Njësia e dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore ka këto kompetenca:

a) ofron këshillim dhe asistencë për të interesuarit për përdorimin e dëftesave tregtare dhe të regjistrit elektronik të dëftesave tregtare;

b) në bashkëpunim me agjencitë rajonale të ekstensionit bujqësor, ushtron në terren kontrolle kur dyshon për të dhëna jo të sakta të hedhura në regjistrë;

c) njofton institucionin përgjegjës për kontrollin e ushqimit dhe të ushqimit për kafshë për ushtrimin



e monitorimit të magazinave, ku ruhen produktet bujqësore për të cilat lëshohen dëftesa tregtare.

Neni 15 Ruajtja e të dhënave

1. Të dhënat e krijuara në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare administrohen nga ministria sipas ligjit nr. 10 325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe ruhen në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale për një afat deri në 10 vjet.

2. Të dhënat e tjera, përveç të dhënave personale dhe të atyre që përbëjnë sekret tregtar, janë të përdorshme, në përputhje me legjislacionin për të dhënat e hapura.

3. Masat teknike dhe organizative të sigurisë gjatë përpunimit të të dhënave personale, si dhe rregullat për nivelin dhe monitorimin e aksesit nga autoritetet kompetente në bazën e të dhënave të regjistrit elektronik të dëftesave tregtare përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VII PËRMBUSHJA E DETYRIMEVE DHE EKZEKUTIMI I DËFTESAVE TREGTARE MBI PRODUKTET BUJQËSORE

Neni 16 Përbushja e detyrimeve të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor

1. Detyrimi i marrë përsipër në dëftesën tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm e të magazinuar konsiderohet i përbushur me kthimin e plotë të shumës së parashikuar në të ose livrimin e produktit bujqësor.

2. Livrimi i produktit bujqësor në lloj e në cilësi të ndryshme nga ajo që është e parashikuar në dëftesë nuk konsiderohet përbushje e detyrimit që buron prej saj, përveç kur kreditori dhe debitori kanë rënë dakord ndryshe.

3. Debitori dhe kreditori mund të arrijnë një marrëveshje për përbushjen e detyrimit të parashikuar, me kthimin e shumës së financuar te kreditori ose me livrimin e një produkti bujqësor të një lloji dhe cilësie të ndryshme nga parashikimi në dëftesën tregtare.

4. Debitori mund të arrijë një marrëveshje me kreditorin për përbushjen e detyrimit të dëftesës

tregtare për produktin bujqësor të ardhshëm, duke ofruar një dëftesë tregtare për produktin bujqësor të magazinuar. Dëftesa tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm konsiderohet e përbushur dhe ky fakt pasqyrohet në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktin bujqësor e me ndërveprim në regjistrin elektronik të barrëve siguruese.

5. Debitori dhe kreditori i dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor mund të arrijnë një marrëveshje për përbushjen e parakohshme të detyrimit nga debitori.

6. Kreditori konfirmon elektronikisht përbushjen e detyrimit nga debitori jo më vonë se 3 ditë kalendarike nga dita e përbushjes së tij, me kthimin e shumës së financimit ose me livrimin e produktit bujqësor.

7. Aplikimi për çregjistrimin e dëftesës tregtare kryhet *online* në portalin “e-Albania” nga kreditori ose nga debitori nëse kreditori nuk ka vepruar sipas parashikimeve të pikës 6 të këtij neni. Vërtetimi për çregjistrimin e dëftesës lëshohet me vulën elektronike të ministrisë.

8. Përbajtja e formularit elektronik për çregjistrimin e dëftesave tregtare, duke përfshirë elementet e nevojshme për përbushjen e veprimit, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

9. Fshirja nga regjistri i barrëve siguruese kryhet sipas ligjit nr. 8537, datë 18.10.1999, “Për barrët siguruese”, i ndryshuar.

Neni 17 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore

1. Subjektet e përfshira në një dëftesë tregtare ose që u rrjedhin të drejta apo detyrime nga një dëftesë tregtare kanë të drejtë t’i kërkojnë mendim agjencisë rajonale të ekstensionit bujqësor një ekspert privat apo t’i drejtohen një ndërmjetësi ose arbitrazhit për ta zgjidhur mosmarrëveshjen e lindur ndërmjet tyre.

2. Marrëveshja për ta zgjidhur jashtëgjyqësisht mosmarrëveshjen ndërmjet subjekteve mund të përpilohet në njëjtën kohë me lëshimin e dëftesës tregtare ose pasi ka lindur mosmarrëveshja ndërmjet tyre.

3. Secili nga subjektet mund t’i drejtohet direkt gjykatës kompetente pa pasur nevojë t’i shterojë paraprakisht zgjidhjet alternative të parashikuara në këtë dispozitë.



Neni 18

Ekzekutimi i kolateralit

1. Nëse nuk konfirmohet përmbushja e detyrimit që buron nga dëftesa tregtare në regjistrin elektronik të dëftesave tregtare mbi produktet bujqësore, kreditori ka të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit nga debitori pa pasur nevojë të paraqesë prova të tjera shtesë.

2. Mospërmbushja ose përmbushja jo e plotë e detyrimit të dëftesës tregtare mbi produktin bujqësor të ardhshëm e të magazinuar mund të sjellë si pasojë ekzekutimin e kolateralit.

3. Ekzekutimi kryhet nga përbaruesi gjyqësor sipas procedurës së parashikuar nga ligji nr. 8357, datë 18.10.1999, “Për barrët siguruese”, i ndryshuar.

KREU VIII**DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT**

Neni 19

Zbatimi i ligjeve të tjera

1. Dëftesat tregtare mbi produktin bujqësor të lëshuara bazuar në këtë ligj konsiderohen si raste përjashtimore në kuptimin e nenit 10, të ligjit nr. 62/2020, “Për tregjet e kapitalit”.

2. Për çështjet e tjera, që nuk parashikohet ndryshe në këtë ligj, gjejnë zbatim dispozitat e Kodit Civil.

Neni 20

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 6 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktet nënligjore në zbatim të neneve 5, pika 3; 7, pika 3; 12, pika 3; 13, pika 3; 15, pika 3, dhe 16, pika 8, të këtij ligji.

Neni 21

Dispozitë tranzitore

Shërbimet elektronike të parashikuara në këtë ligj ofrohen pas ngritjes së sistemit elektronik nga ministria përgjegjëse për çështje të bujqësisë, brenda 1 viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 22

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 432, datë 27.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET**Nr. 432, datë 27.7.2026****PËR SHPALLJE LIGJI**

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 65/2026, “Për dëftesat tregtare mbi produktet bujqësore”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ**Nr. 66/2026****PËR CENSIN E BUJQËSISË¹**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

¹ Ky ligj është përafshuar pjesërisht me:

- Rregulloren (BE) nr. 2018/1091, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 18 korrik 2018, “Mbi statistikën e integruar të bujqësisë dhe shfuqizimin e Faqe| 16722

rregulloreve (KE) nr. 1166/2008 dhe (BE) nr. 1337/2011”, e ndryshuar. Numri CELEX 32018R1091, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 200, datë 7.8.2018, faqe 1–29.



KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Ky ligj rregullon organizimin dhe realizimin e censit të bujqësisë në nivelin e njësive ekonomike bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Qëllimi i censit të bujqësisë

Censi i bujqësisë bëhet me qëllim, që:

a) të sigurojë informacion të përgjithshëm dhe të detajuar për të gjitha njësitë ekonomike bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë;

b) të ofrojë të dhëna të besueshme statistikore, përfshirë ato gjinore në fushën e bujqësisë, të nevojshme për planifikimin dhe vënien në zbatim të politikave të përgjithshme të zhvillimit bujqësor në Republikën e Shqipërisë, duke zbatuar parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare;

c) të krijojë regjistrin statistikor të njësive ekonomike bujqësore.

Neni 3
Fusha e zbatimit të censit të bujqësisë

1. Censi i bujqësisë përfshin të gjitha njësitë ekonomike, që kanë në përdorim tokë bujqësore apo që kryejnë aktivitet bujqësor dhe/ose blegtoral brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Objekt i censit janë njësitë ekonomike bujqësore që tregtojnë plotësisht ose pjesërisht produktet e tyre, si dhe ato që prodhojnë vetëm për konsum familjar.

2. Të dhënat e mbledhura nga njësitë ekonomike bujqësore, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të mbulojnë 98% të sipërfaqes së përdorur për qëllime bujqësore, me përjashtim të kopshtarisë, dhe 98% të njësive blegtorale brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. Pyjet dhe kullotat në pronësi publike nuk përfshihen në fushën e zbatimit të këtij censi, përveç rasteve kur shfrytëzohen drejtpërdrejt nga njësitë ekonomike bujqësore për aktivitetin e tyre bujqësor ose blegtoral.

Neni 4
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Censi i bujqësisë”** është vrojtimi në një kohë të caktuar i njësive ekonomike bujqësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilat janë të detyruara të përgjigjen sipas ligjit.

2. **“Njësi ekonomike bujqësore (NJEB)”** është një njësi e vetme si nga pikëpamja teknike, ashtu edhe ekonomike, e cila drejtohet nga një person i vetëm ose grup personash, që ndërmerr veprimtari ekonomike në bujqësi ose mirëmban tokën bujqësore, duke e kultivuar atë në gjendje të mirë bujqësore dhe mjedisore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

3. **“Drejtues i njësisë ekonomike bujqësore”** është individ, personi fizik ose administratori i personit juridik, i cili, personalisht, si kultivues dhe mbarështues i drejtpërdrejtë ose me vartës e bashkëpjesëmarrës apo me persona dhe subjekte të tjera merr përsipër dhe udhëheq zhvillimin e një njësie ekonomike bujqësore.

4. **“Vendndodhje”** është vendbanimi i zotëruesit të njësisë ekonomike bujqësore ose vendndodhja administrative e selisë së njësisë ekonomike bujqësore.

5. **“Njësi bujqësore e tokës së përbashkët”** është sipërfaqja e tokës mbi të cilën zbatohen të drejtat e përbashkëta dhe e cila përdoret nga dy ose më shumë njësi bujqësore për prodhim bujqësor, por që nuk ndahet ndërmjet tyre.

6. **“Njësi blegtorale”** është një njësi matëse standarde për kategoritë individuale të bagëtive, të vendosura nga INSTAT-i, e cila lejon grumbullimin e kategorive të ndryshme të kafshëve në mënyrë që ato të krahasohen.

7. **“Sipërfaqe e destinuar për përdorim bujqësor”** është sipërfaqja e tokës që përdoret për bujqësi, duke përfshirë tokën e punueshme, tokën me bar të përherëshëm, kulturat e përherëshme dhe tokën tjetër bujqësore të shfrytëzuar.



8. **“Ditë e censit”** është dita e parë e fillimit të mbledhjes së të dhënave në terren.

9. **“Vit referencë”** është viti kalendarik të cilit i referohen periudhat e referencës.

10. **“Kopshtari”** janë zonat e përdorura për prodhimin e ushqimit të destinuar për konsum personal.

11. **“Mbledhje e të dhënave”** është procesi i mbledhjes së informacionit të censit në një territor të caktuar, për një periudhë të caktuar kohore, nëpërmjet intervistave të kryera nga personeli i terrenit, plotësimit të pyetësorëve për secilën njësi ekonomike bujqësore në atë territor.

12. **“Periudhë e mbledhjes së të dhënave”** është periudha kohore gjatë së cilës të dhënat mbledhen nëpërmjet personelit të censit në terren.

13. **“INSTAT-i”** është Instituti i Statistikave të Shqipërisë, që është autoriteti ekzekutiv përgjegjës për planifikimin, zbatimin, menaxhimin e censit, si dhe shpërndarjen e statistikave të gjeneruara nga të dhënat e censit.

14. **“Të dhëna personale”** kanë të njëjtin kuptim me përkufizimin e dhënë në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

15. **“Identifikim i drejtpërdrejtë”** dhe **“identifikim i tërthortë”** kanë kuptim të njëjtë me atë të përcaktuar në legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

16. **“Zonë censi”** është njësi më e vogël gjeografike për qëllime statistikore, e përdorur nga INSTAT-i për mbledhjen e të dhënave në cens.

17. **“Treguesit gjinorë në censin e njësive ekonomike bujqësore”** janë statistika të ndjeshme ndaj gjinisë që synojnë të masin dhe të analizojnë dallimet mes grave dhe burrave brenda strukturës dhe funksionimit të njësive ekonomike bujqësore.

18. **“Anonimizim”** ka të njëjtin kuptim me përkufizimet e dhëna në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 5

Përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore

Shprehjet e përdorura në këtë ligj për personat në gjininë mashkullore nënkuptojnë të njëjtat shprehje edhe në gjininë femërore.

Neni 6

Burimet e të dhënave dhe metodat

1. Për marrjen e të dhënave sipas këtij ligji dhe për të mundësuar prodhimin e statistikave sipas kërkesave të cilësisë statistikore, të përcaktuara në nenin 12 të këtij ligji, INSTAT-i ka të drejtë të përdorë një ose më shumë nga burimet ose metodat e mëposhtme:

- a) të dhënat e censit të popullsisë dhe banesave;
- b) anketat statistikore të zhvilluara për prodhimin e statistikave zyrtare;
- c) të dhënat administrative sipas pikës 3 të këtij neni;
- ç) burime, metoda ose qasje të tjera novatore.

2. INSTAT-i gëzon të drejtën e hyrjes dhe përdorimit të të dhënave menjëherë dhe pa pagesë, duke përfshirë edhe të dhënat personale për njësitë ekonomike bujqësore dhe të dhënat personale për zotëruesit e tyre, të cilat janë të përpiluara dhe disponohen në territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Institucionet publike, përgjegjëse për bujqësinë, turizmin e mjedisin, punët e brendshme e pushtetin vendor dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit për të vënë në dispozicion të INSTAT-it të dhëna administrative për lehtësimin e veprimtarive të censit, sipas kërkesës së këtij organi, nëpërmjet ndërveprimit të databazave.

4. Për zbatimin e këtij neni, marrëdhëniet ndërmjet INSTAT-it dhe institucioneve publike për vënien në dispozicion të të dhënave personale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit në të cilat përcaktohen baza ligjore, qëllimi, kategoritë e të dhënave që shkëmbehen, rolet dhe përgjegjësitë e palëve, mënyrat dhe kushtet e transmetimit, masat e sigurisë, si dhe afatet e ruajtjes së të dhënave, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 7

Të dhënat e mbledhura

1. Kategoritë e të dhënave të mbledhura gjatë censit janë:



a) të dhëna për karakteristikat e përgjithshme të njësive ekonomike bujqësore, ku përfshihen të paktën:

i. të dhëna identifikuese mbi NJEB-të;
ii. statusi dhe forma ligjore e pronësisë;
iii. gjinia, mosha e anëtarëve të njësisë ekonomike bujqësore dhe personave të tjerë të përfshirë në aktivitetet e NJEB-së;

b) të dhëna të hollësishme për tokën, sipërfaqen e kulturave bujqësore (bimë arash, pemëtar), pyjet dhe kullotat, në pronësi dhe/ose në përdorim të NJEB-së;

c) të dhëna të hollësishme për numrin e krerëve sipas kategorive kryesore blegtorale, përfshirë bletarinë;

ç) të dhëna të tjera për metodat e prodhimit bimor, si dhe të dhëna për karakteristikat e punësimit të anëtarëve të njësisë ekonomike bujqësore dhe personave që nuk janë anëtarë të këtyre njësive, por të angazhuar në këtë njësi;

d) të dhëna shtesë për mekanizimin bujqësor dhe infrastrukturën e fermave bujqësore e blegtorale, shërbime shtesë të fermave, si dhe elemente të zhvillimit rural.

2. Të dhënat e mbledhura nga censi përdoren vetëm për qëllime statistikore, në përputhje me legjislacionin në fuqi për prodhimin e statistikave zyrtare, si dhe sipas standardeve e rekomandimeve të Eurostatit dhe të Kombeve të Bashkuara për censet e bujqësisë.

3. Të dhënat e mbledhura nga censi do të shërbejnë, gjithashtu, edhe për ngritjen e regjistrit statistikor të njësive ekonomike bujqësore, i cili do të mirëmbahet dhe do të administrohet vetëm nga INSTAT-i dhe nuk do të përdoret për asnjë qëllim krijimi ose përditësimi të ndonjë regjistri tjetër administrativ.

Neni 8

Pyetësori i censit

Pyetësori i censit është instrumenti i hartuar dhe i miratuar nga INSTAT-i, i cili përmban pyetjet e detyrueshme dhe kërkesat e nevojshme për mbledhjen e informacionit për prodhimin e statistikave zyrtare, sipas pikës 1, të nenit 6 të këtij ligji.

Neni 9

Detyrimi për t'u përgjigjur

1. Drejtuesit e njësive ekonomike bujqësore janë të detyruar të japin informacion të plotë, korrekt e të vërtetë sipas pyetësorit të censit të hartuar nga INSTAT-i.

2. Në rast se informacioni i kërkuar në pyetësorin e censit nuk mund të sigurohet nga personat sipas pikës 1 të këtij neni, atëherë personi përgjegjës për dhënien e informacionit është një anëtar tjetër i NJEB-së, madhor dhe i autorizuar nga drejtuesi.

Neni 10

Organet zbatuese dhe mbështetëse

Censi i bujqësisë organizohet dhe realizohet nga INSTAT-i, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, me mbështetjen e Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë dhe komisioneve të censit në nivel bashkie. Detyrat dhe përgjegjësitë e këtyre organeve përcaktohen në kreun II të këtij ligji.

Neni 11

Dita e censit dhe periudha e mbledhjes së të dhënave

Dita e censit përcaktohet nga INSTAT-i. Periudha e mbledhjes së të dhënave në terren përcaktohet në planin vjetor për zbatimin e Programit të Statistikave Zyrtare, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për statistikave zyrtare.

Neni 12

Periudha e referencës

Informacioni i mbledhur do t'i referohet një viti të vetëm referues, duke iu referuar situatës gjatë një afati kohor ose date të caktuar, si më poshtë:

a) për variablat e tokës, përdorimi i tokës do t'i referohet vitit referues. Në rastin e kulturave të njëpasnjëshme nga e njëjta pjesë toke, përdorimi i tokës i referohet një kulture që është korrur gjatë vitit referues, pavarësisht se kur është mbjellë kultura në fjalë;

b) për variablat për praktikën e ujitjes dhe menaxhimit të tokës, periudha e referencës është një periudhë 12-mujore që përfundon brenda vitit



referues, me synimin për të mbuluar ciklet përkatëse të prodhimit;

c) për variablat për blegtorinë, strehimin e kafshëve dhe menaxhimin e plehut organik, INSTAT-i do të vendosë një ditë referimi të përbashkët brenda vitit referues. Variablat për menaxhimin e plehut organik do t'i referohen një periudhe 12-mujore, duke përfshirë atë datë.

Neni 13

Cilësia statistikore

1. INSTAT-i merr masat e nevojshme për të siguruar cilësinë e të dhënave dhe metadatave të transmetuara.

2. Për qëllimet e këtij ligji, kriteret e cilësisë statistikore janë në përputhje me parimet statistikore të përcaktuara në legjislacionin për statistikat zyrtare.

3. Për vlerësimin e cilësisë, INSTAT-i është i detyruar të prodhojë dhe të publikojë një raport cilësie, i cili përshkruan procesin statistikor për çdo vit referencë të mbuluar nga ky ligj, në përputhje me kërkesat dhe standardet e përcaktuara nga legjislacioni i Bashkimit Evropian dhe Eurostatit.

Neni 14

Mbrojtja e të dhënave dhe konfidencialiteti

1. Të dhënat e grumbulluara nga censi janë konfidenciale dhe mbrohen sipas legjislacionit në fuqi për statistikat zyrtare dhe legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

2. Çdo person ose autoritet publik, i cili nëpërmjet përfshirjes në proceset e censit merr ose ka dijeni për të dhëna personale, i nënshtrohet detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit mbi to, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Personat sipas pikës 2 të këtij neni janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin e të dhënave edhe pas përfshirjes në cens.

4. INSTAT-i merr të gjitha masat e duhura teknike, organizative dhe të sigurisë për të parandaluar hyrjen e paautorizuar në instalimet ku përpunohen ose ruhen të dhënat e censit, si dhe për t'i mbrojtur ato nga shkatërrimet e paligjshme, aksidentale, humbjet aksidentale apo nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.

5. INSTAT-i i trajton të dhënat e mbledhura, të përpunuara e të ruajtura të censit të bujqësisë si rreptësisht konfidenciale, duke mos lejuar individët dhe njësitë statistikore të identifikohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë.

6. Kur përpunimi i të dhënave të censit nga INSTAT-i kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të anonimizohen menjëherë në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme.

7. INSTAT-i i ruan të dhënat e mbledhura të censit sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare. Pas përfundimit të afatit të ruajtjes, të dhënat personale fshihen ose anonimizohen në përputhje me procedurat e miratuara.

Neni 15

Rezultatet e censit të bujqësisë

1. Rezultatet statistikore të censit të bujqësisë shpërndahen në përputhje me kushtet e mëposhtme:

a) INSTAT-i publikon rezultatet e censit mbi baza shkencore e profesionale;

b) rezultatet statistikore, të përcaktuara në shkronjën “a” të kësaj pike, publikohen në nivel kombëtar, vendor dhe në nivel tjetër gjeografik, duke siguruar që ato të paraqiten në një formë që pengon identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të individit apo njësisë ekonomike bujqësore;

c) në rezultatet e censit të bujqësisë përfshihen edhe të dhënat statistikore gjinore në fushën e bujqësisë;

ç) INSTAT-i publikon rezultatet e censit vetëm në një formë që pengon identifikimin e drejtpërdrejtë apo të tërthortë të individëve dhe njësisë të tjera statistikore;

d) për qëllime kërkimore-shkencore, e drejta e hyrjes në të dhënat konfidenciale jepet vetëm sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për statistikat zyrtare.

2. INSTAT-i ia dërgon rezultatet e censit Eurostatit brenda 12 muajve nga përfundimi i periudhës së referencës.



KREU II
PËRBËRJA, PËRGJEGJËSITË DHE
MARRËDHËNIET E ORGANEVE
TË NGARKUARA PËR CENSIN E
BUJQËSISË

Neni 16

**Ngritja dhe përbërja e Komisionit Qendror
të Censit të Bujqësisë**

1. Me qëllim mbështetjen e INSTAT-it në përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë, ngrihet Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë, i cili drejtohet nga zëvendëskryeministri.

2. Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë ka në përbërje:

- a) ministrin përgjegjës për bujqësinë dhe zhvillimin rural;
- b) ministrin përgjegjës për punët e brendshme;
- c) ministrin përgjegjës për drejtësinë;
- ç) ministrin përgjegjës për mbrojtjen;
- d) ministrin përgjegjës për mirëqenien sociale;
- dh) ministrin përgjegjës për turizmin, kulturën dhe sportin;
- e) ministrin përgjegjës për mjedisin;
- ë) ministrin përgjegjës për pushtetin vendor;
- f) drejtorin e përgjithshëm të ASHK-së;
- g) drejtorin e përgjithshëm të INSTAT-it;
- gj) dy përfaqësues të tjerë të nivelit të lartë të INSTAT-it, të caktuar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it;
- h) rektorin e Universitetit Bujqësor të Tiranës;
- i) Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Neni 17

**Përgjegjësitë e Komisionit Qendror të
Censit të Bujqësisë**

Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë ka këto përgjegjësi:

- a) harton dhe miraton rregulloren e funksionimit të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;
- b) ndjek përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë dhe mbështet INSTAT-in për të siguruar furnizimin me të dhëna nga institucionet publike, rrethet shkencore dhe shoqëria civile;
- c) lehtëson bashkërendimin e punës ndërmjet ministrive dhe institucioneve publike e shkencore për mbështetjen e censit;

ç) miraton projektkalendarin e veprimtarive për përgatitjen dhe zbatimin e censit të bujqësisë, i cili përgatitet nga INSTAT-i;

d) shqyrton çdo kërkesë të paraqitur nga individët apo organizatat, sipas nenit 26 të këtij ligji, dhe lëshon autorizim, në lidhje me miratimin për mbledhjen e informacionit nga publiku gjatë periudhës prej 4 javësh përpara ditës së censit dhe gjatë periudhës së mbledhjes së të dhënave të censit.

Neni 18

**Funksionimi i Komisionit Qendror të
Censit të Bujqësisë**

1. Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë zhvillon mbledhjen e tij të parë jo më vonë se 60 ditë nga hyrja në fuqi e këtij ligji dhe e ushtron veprimtarinë e tij deri në përfundimin e periudhës së mbledhjes së të dhënave në terren.

2. Komisioni mbledhet jo më pak se një herë në muaj.

3. Në mungesë të kryetarit të Komisionit, mbledhja kryesohet nga ministri përgjegjës për bujqësinë.

Neni 19

Përgjegjësitë e Institutit të Statistikave

1. Instituti i Statistikave ka këto përgjegjësi:

a) përcakton ditën e censit, harton programin e punës, përcakton metodologjinë, harton pyetësoin, përzgjedh mjetet teknike dhe programet kompjuterike të përshtatshme, nxjerr udhëzimet e nevojshme dhe kryen përgatitjen e zbatimit të censit në baza profesionale dhe shkencore;

b) menaxhon burimet njerëzore dhe financiare përkatëse dhe informon Komisionin Qendror të Censit të Bujqësisë dhe donatorët ndërkombëtarë për përdorimin e këtyre burimeve;

c) udhëzon komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie, të ngritura sipas parashikimeve të nenit 20 të këtij ligji, për detyrat që kanë për mbështetjen e censit;

ç) u propozon autoriteteve publike përkatëse hapat që duhen të ndërmarrin për censin e bujqësisë;

d) zhvillon fushatën për informimin e publikut;

dh) kryen procedurat e përzgjedhjes, të rekrutimit dhe trajnimit të personelit të terrenit me mbështetjen, sipas nevojës, e komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie;



e) siguron trajnime për personelin e censit të bujqësisë për respektimin e parimeve të barazisë gjinore;

ë) drejton punën për realizimin e censit të bujqësisë në të gjitha fazat, në bashkëpunim me institucionet dhe organet mbështetëse të censit të bujqësisë;

f) përpunon të dhënat e mbledhura nga censi i bujqësisë dhe ndërmerr masat e duhura për mbrojtjen e konfidencialitetit të tyre, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të këtij ligji;

g) kryen anketën e verifikimit pas-cens për vlerësimin e mbulimit të censit dhe cilësisë së të dhënave kryesore të mbledhura;

gj) publikon rezultatet e censit, në përputhje me nenin 15 të këtij ligji;

h) i raporton Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë ecurinë e aktiviteteve të censit;

i) mbulon detyrën e sekretariatit të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë dhe ka këto detyra:

i. njofton anëtarët e Komisionit për mbledhjen e radhës;

ii. mban procesverbalin e mbledhjes;

iii. përgatit dokumentacionin bazë të mbledhjes, të paktën 5 ditë përpara datës së mbledhjes.

2. Për kryerjen e suksesshme të censit të bujqësisë dhe për të siguruar zbatimin e parimeve statistikore sipas legjislacionit në fuqi për statistikën zyrtare, INSTAT-i ka të drejtë të ndërmarrë çdo aktivitet tjetër të paparashikuar në pikën 1 të këtij neni.

3. INSTAT-i, gjatë hartimit të pyetësorit dhe planifikimit të censit, organizon konsultime për përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha fazat e censit.

Neni 20

Ngritja dhe përbërja e komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie

1. Komisionet e censit të bujqësisë ngrihen në çdo bashki brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, me qëllim që të mbështesin INSTAT-in gjatë planifikimit, zbatimit dhe menaxhimit të punës në terren për censin e bujqësisë.

2. Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie ndjekin udhëzimet dhe instruksionet e INSTAT-it, japin informacion, ofrojnë lehtësira dhe asistencë për personelin e censit brenda territorit të bashkisë, si dhe marrin çdo masë tjetër të nevojshme për të siguruar kryerjen e suksesshme të procesit të

mbledhjes së të dhënave të censit brenda territorit përkatës.

3. Komisioni i censit të bujqësisë në nivel bashkie drejtohet nga kryetari i bashkisë përkatëse ose një person i autorizuar prej tij.

4. Komisioni i censit të bujqësisë në nivel bashkie përbëhet nga këta anëtarë:

a) administratorët e njësive administrative përkatëse brenda bashkisë;

b) përfaqësuesi i INSTAT-it, i cili caktohet nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it;

c) përfaqësuesi i Agjencisë Rajonale të Ekstensionit Bujqësor, i cili caktohet me urdhër të veçantë të ministrit përgjegjës për bujqësinë;

ç) përfaqësuesi i drejtorisë vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, i cili caktohet nga drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Shtetërore të Kadastrës;

d) një përfaqësues nga Policia e Shtetit, i cili përcaktohet nga drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit.

Neni 21

Detyrat dhe përgjegjësitë e komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie

1. Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie kanë detyrat dhe përgjegjësitë e mëposhtme:

a) mbështesin INSTAT-in në organizimin e punës së censit të bujqësisë në zonat e numërimit brenda juridiksionit përkatës të bashkisë;

b) ndihmojnë INSTAT-in në përgatitjen dhe shpërndarjen e materialeve që do të përdoren gjatë fushatës së informimit;

c) ndihmojnë INSTAT-in gjatë procesit të rekrutimit për punonjës terreni;

ç) i sigurojnë dhe vënë në dispozicion të personelit të censit ambiente të nevojshme për të mbështetur proceset e censit, sipas kërkesave të INSTAT-it dhe/ose Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë;

d) mbështesin INSTAT-in për zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të censit të bujqësisë;

dh) i raportojnë periodikisht INSTAT-it, sipas kërkesës së këtij të fundit, për ecurinë e përmbushjes së detyrave të parashikuara në këtë nen. Raportimi përmban vlerësime për përfshirjen gjinore në të gjitha fazat e procesit të censit.



2. Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie funksionojnë deri në një muaj pas përfundimit të procesit të mbledhjes së të dhënave.

Neni 22

Funksionimi dhe mbledhjet e komisionit të censit të bujqësisë në nivel bashkie

1. Në mbledhjen e komisionit të censit të bujqësisë në nivel bashkie marrin pjesë vetëm anëtarët e tij, me përjashtim të rasteve kur kryetari i komisionit fton sipas çështjeve që diskutohen:

a) specialistët e institucioneve në nivel qarku apo nivel vendor, të cilët nuk përfaqësohen në komisionin e censit;

b) ekspertë apo personel tjetër të INSTAT-it, të angazhuar për censin.

2. Komisionet e censit të bujqësisë në nivel bashkie mbledhen brenda 5 ditëve nga paraqitja e kërkesës me shkrim nga njëri prej anëtarëve të komisionit.

3. Mbledhjet e komisionit zhvillohen kur janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve të tij. Vendimet e komisionit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm dhe në rast barazie votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

4. Rregullat e detajuara për procedurat e thirrjes, organizimit, zhvillimit të mbledhjes e miratimit të vendimeve të komisioneve të censit të bujqësisë në nivel bashkie, si dhe masat për garantimin e barazisë gjinore në të gjitha fazat e zbatimit të censit përcaktohen në rregulloren për funksionimin e komisionit të censit të bujqësisë në nivel bashkie, të miratuar nga drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it.

Neni 23

Institucionet e tjera të përfshira në cens

Ministria që mbulon çështjet e bujqësisë dhe zhvillimit rural, ministria që mbulon çështjet e turizmit dhe mjedisit, ministria përgjegjëse për punët e brendshme dhe ministri përgjegjës për pushtetin vendor, në bashkëpunim me INSTAT-in, vënë në dispozicion të Komisionit Qendror të Censit të Bujqësisë të dhëna dhe informacione për lehtësimin e veprimtarive të censit, sipas kërkesës së këtij organi.

KREU III

PROCEDURAT E CENSIT TË BUJQËSISË

Neni 24

Fushata informuese

1. Qëllimet dhe procedurat e censit të bujqësisë, si dhe detyrimet ligjore lidhur me të bëhen publike nëpërmjet shkëmbimeve shkresore zyrtare, medias dhe një fushate të gjerë informimi, të drejtuar nga INSTAT-i.

2. Fushata informuese kryhet sipas një strategjie komunikimi, e përgatitur nga INSTAT-i jo më vonë se 4 muaj nga dita e censit të bujqësisë. Ajo synon informimin e të gjitha grupeve shoqërore dhe duhet të përmbajë gjuhë korrekte, sipas përcaktimit të nenit 5 të këtij ligji.

3. Fushata informuese fillon të paktën 4 javë para ditës së censit të bujqësisë dhe përfundon me nxjerrjen e rezultateve përfundimtare të tij.

4. Radiotelevizioni Publik Shqiptar i transmeton materialet informuese të përgatitura nga INSTAT-i pa pagesë.

Neni 25

Personeli i censit të bujqësisë

1. Në përbërje të personelit të censit të bujqësisë, janë:

a) personeli i terrenit, i cili autorizohet dhe pajiset nga INSTAT-i me një shenjë dalluese të zyrtarizuar dhe ka në përbërje:

i. anketuesit, të cilët shkojnë në çdo njësi ekonomike bujqësore brenda territorit të caktuar të mbledhjes së të dhënave për të plotësuar tërësisht dhe me saktësi pyetësin e censit;

ii. kontrollorët, të cilët kontrollojnë, mbështesin dhe raportojnë punën e anketuesve të varësisë;

iii. specialistët IT, të cilët mbështesin personelin e terrenit për sigurimin dhe mirëmbajtjen e çdo pajisjeje për mbledhjen e të dhënave;

iv. personelin ndihmës për gjeoinformacionin, i cili ndjek mbarëvajtjen e procesit të numërimit në terren nga ana gjeografike dhe mbështet anketuesit për zgjidhjen e problematikave që kanë të bëjnë me orientimin në terren dhe përditësimin e zonave të censit.

b) personeli tjetër, ku përfshihen:



i. personeli i organikës së INSTAT-it, i cili drejton dhe zbaton të gjitha proceset e censit nga ana administrative, teknike dhe operacionale;

ii. trajnerët të cilët trajnojnë personelin e terrenit për kryerjen e detyrave të tyre;

iii. operatorët të cilët hedhin të dhëna në sistemet e kompjuterizuara;

iv. statistikienët dhe personeli tjetër, të cilët përpunojnë të dhënat, analizojnë dhe publikojnë rezultatet statistikore të censit;

c) punonjës të institucioneve të varësisë së ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

2. INSTAT-i përcakton kriteret dhe ngre komisione *ad hoc* vlerësimi për përzgjedhjen dhe rekrutimin e personelit të censit.

3. Personeli i INSTAT-it, sipas nënndarjes “i”, të shkronjës “b”, të pikës 1 të këtij neni, si dhe personeli i ministrisë përgjegjëse për bujqësinë dhe zhvillimin rural, sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, i përfshirë gjatë periudhës së zbatimit të aktiviteteve të censit të bujqësisë përfitojnë një pagesë për punën shtesë të kryer prej tyre.

4. Personeli i censit të bujqësisë, sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1 të këtij neni, rekrutohet dhe kontraktohet nga INSTAT-i sipas dispozitave ligjore në fuqi.

5. Personeli i censit të bujqësisë, sipas shkronjës “c”, të pikës 1 të këtij neni, angazhohet në përpunje me kërkesat dhe udhëzimet e INSTAT-it për personelin e censit.

6. INSTAT-i merr masa për të siguruar përfaqësim të barabartë gjinor në proceset e rekrutimit dhe trajnimit të personelit të censit.

7. Kriteret e përfitimit, koha dhe pozicionet e punës që përfitojnë, masa e pagesës shtesë për personelin e parashikuar në pikën 3 të këtij neni përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

Neni 26

Ndalimi për mbledhjen e të dhënave të ngjashme

1. Gjatë periudhës prej katër javësh para ditës së censit të bujqësisë dhe gjatë të gjithë periudhës së mbledhjes së të dhënave për censin, është e ndaluar për të gjithë individët dhe organizatat, me përjashtim të INSTAT-it, të mbledhin të dhëna nga njësitë

ekonomike bujqësore brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Të gjitha subjektet të cilave, gjatë periudhës së përmendur në pikën 1 të këtij neni, u nevojitet mbledhja e të dhënave, e zhvillojnë këtë veprimtari vetëm me autorizim të veçantë, lëshuar nga Komisioni Qendror i Censit të Bujqësisë, në përputhje me këtë ligj.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 27

Kundërvajtjet dhe gjobat

1. Shkeljet e mëposhtme përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen përkatësisht, si më poshtë:

a) refuzimi për të dhënë informacionin e kërkuar ose dhënia e informacionit të rremë, sipas nenit 9 të këtij ligji, me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë;

b) mosrespektimi i rregullave të konfidencialitetit statistikor trajtohet dhe dënohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare;

c) mosrespektimi i rregullave të përcaktuara në nenin 26 të këtij ligji nga personi/personat përgjegjës me gjobë nga 30 000 (tridhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Për hetimin administrativ të kundërvajtjeve të parashikuara në këtë nen INSTAT-i ka të drejtë të konsultojë bazat e të dhënave shtetërore në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për statistikën zyrtare.

Neni 28

Verifikimi i kundërvajtjeve administrative

1. INSTAT-i është autoriteti përgjegjës për shqyrtimin, verifikimin dhe marrjen e vendimeve për kundërvajtjet administrative të konstatuara, në respektim të dispozitave të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative. Vendimi i njoftohet me shkrim shkelësit, brenda 10 ditëve kalendarike.

2. Gjobat e vendosura sipas përcaktimeve të nenit 27 të këtij ligji janë tituj ekzekutivë dhe ekzekutohen në përputhje me përcaktimet e



legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. INSTAT-i është përgjegjës për konstatimin e shkeljeve të detyrimit për ruajtjen e konfidencialitetit statistikor, në përputhje me nenin 14 të këtij ligji. Në rastet e shkeljes së të dhënave personale zbatohen dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Neni 29

Ankimi ndaj sanksionit për kundërvajtjen administrative

1. Ankimi për vendosjen e një gjobe, sipas përcaktimeve të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 27 të këtij ligji, paraqitet pranë drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it, brenda 30 ditëve nga data e marrjes dijeni të vendimit për vendosjen e gjobës.

2. Në rast se përpunimi i të dhënave personale kryhet në shkelje të nenit 14 të këtij ligji, ankimi paraqitet pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Kundër vendimit të drejtorit të përgjithshëm të INSTAT-it, sipas pikës 1 të këtij neni, mund të paraqitet ankimi në Gjykatën Administrative, brenda 45 ditëve nga data e shpalljes së këtij vendimi.

Neni 30

Financimi

1. Financimi i censit të bujqësisë sigurohet nga buxheti i shtetit përmes fondeve të veçanta të miratuara për këtë qëllim në buxhetin vjetor të INSTAT-it.

2. Përveç buxhetit të shtetit, censi i bujqësisë mund të mbështetet edhe nga:

a) fondet e Bashkimit Evropian dhe programet e tjera të ndihmës financiare nga institucione evropiane;

b) kontributet e donatorëve ndërkombëtarë dhe organizatave partnere në fushën e zhvillimit rural dhe statistikave;

c) burime të tjera financiare të ligjshme dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 31

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë aktin nënligjor në zbatim të pikës 7, të nenit 25 të tij.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i INSTAT-it që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të miratojë rregulloren për funksionimin e komisionit të censit të bujqësisë në nivel bashkie, në zbatim të pikës 4, të nenit 22 të tij.

KREU V

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 32

Shfuqizime

Ligji nr. 10 201, datë 17.12.2009, “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike bujqësore”, shfuqizohet.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 435, datë 28.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj

DEKRET

Nr. 435, datë 28.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 66/2026, “Për censin e bujqësisë”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 67/2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 27/2016, “PËR
MENAXHIMIN E KIMIKATEVE”,
I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 27/2016, “Për menaxhimin e kimikateve”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 6 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Ministria përgjegjëse për tregtinë është autoriteti kompetent për kontrollin në treg të kimikateve.”.

2. Pika 6 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 20 bëhen shtesa dhe ndryshimi i mëposhtëm:

1. Pas pikës 4 shtohet pika 4/1 me këtë përmbajtje:

“4/1. Lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC) miratohet me urdhër të ministrit. Lista përditësohet në përputhje me listën e substancave SVHC, të miratuar sipas aneksit XIV, të rregullores (KE) nr. 1907/2006 (REACH), i ndryshuar.”.

2. Në pikën 5 fjalët “lista e substancave me rrezikshmëri shumë të lartë (SVHC)” hiqen.

Neni 3

Në nenin 21 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

1. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Lista e substancave kandidate miratohet me urdhër të ministrit.”.

2. Pas pikës 2 shtohet pika 3 me këtë përmbajtje:

“3. Lista e substancave kandidate përditësohet bazuar në listën e rishikuar të substancave kandidate, në përputhje me listën e publikuar nga Agjencia Evropiane e Kimikateve.”.

Neni 4

Neni 28 shfuqizohet.

Neni 5

Në pikën 7, të nenit 29 fjalët “ministrinë përgjegjëse për industrinë” hiqen.

Neni 6

Në nenin 35 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.

2. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Strukturat përgjegjëse për inspektimin sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë paraqesin raportin vjetor të inspektimeve pranë Zyrës së Kimikateve brenda datës 1 mars të vitit pasardhës.”.

Neni 7

Paragrafi hyrës, i nenit 39 ndryshohet si më poshtë:

“Gjatë kryerjes së detyrave të referuara në nenin 35 të këtij ligji strukturat përgjegjëse për inspektimin, sipas fushave përkatëse të përgjegjësisë, kanë të drejtë që në bazë të një vendimi:”.

Neni 8

Pikat 35 dhe 36 të nenit 40 shfuqizohen.

Neni 9

Në nenin 43 bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

1. Paragrafi i parë numërohet me numrin 1.

2. Fjalët “20, pikat 5 dhe 6” zëvendësohen me fjalët “20, pika 6”.

3. Fjalët “21, pika 2” hiqen.

4. Pas pikës 1 shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:



“2. Ngarkohet ministri përgjegjës për mjedisin të miratojë aktet nënligjore në zbatim të pikës 4/1, të nenit 20 dhe të pikës 2, të nenit 21, të këtij ligji.”.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekreten nr. 433, datë 27.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 433, datë 27.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 67/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 27/2016, ‘Për menaxhimin e kimikateve’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**

LIGJ
Nr. 68/2026

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN
NR. 103/2016, “PËR AKUAKULTURËN”,
I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr. 103/2016 “Për akuakulturën”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Neni 29 riformulohet si më poshtë:

“Neni 29
Kultivimi i organizmave joautoktonë

Rregullat për kultivimin e specieve aliene dhe lokalisht të munguara përcaktohen me urdhër të përbashkët të ministrit përgjegjës për peshkimin dhe akuakulturën dhe ministrit përgjegjës për çështjet e mjedisit.”.

Neni 2
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 16.7.2026.

Shpallur me dekreten nr. 434, datë 27.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET
Nr. 434, datë 27.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI

Në mbështetje të nenit 84, pika 1, dhe nenit 93 të Kushtetutës,

DEKRETOJ:

Shpalljen e ligjit nr. 68/2026, “Për një ndryshim në ligjin nr. 103/2016, ‘Për akuakulturën’, i ndryshuar”.

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj**



LIGJ
Nr. 83/2026

“Neni 30/a

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË LIGJIN NR. 93/2015, “PËR
TURIZMIN”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78, 81, pika 1, dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 93/2015 “Për turizmin”, i ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 54 e nenit 4 ndryshohet, si më poshtë:

“54. Investitor në strukturë akomoduese me 4 ose 5 yje, status special” nënkupton subjektin, i cili financon dhe/ose merr përsipër ndërtimin e strukturave akomoduese me 4 ose 5 yje, status special, dhe që përmbush kriteret e përcaktuara në nenin 33/1 të këtij ligji.”.

Neni 2

Në fund të nenit 28 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Me propozim të ministrit përgjegjës për turizmin, Këshilli i Ministrave mund të vendosë ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pasurive shtetërore në zonat me përparësi zhvillimin e turizmit për realizimin e projekteve ose investimeve me interes publik ose me rëndësi kombëtare që kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit.”.

Neni 3

Pas nenit 30 shtohet neni 30/a me këtë përmbajtje:

1. Këshilli i Ministrave mund të urdhërojë pezullimin e punimeve të ndërtimit në zonat turistike gjatë sezonit turistik për të garantuar zhvillimin e qetë të tij. I njëjti rregull vlen edhe për aktivitetet e tjera të lidhura me punimet e ndërtimit në rast se ato zhvillohen në këtë brez dhe ndikojnë në sezonin turistik. Vendimi i Këshillit të Ministrave për pezullimin sipas këtij neni përmban:

i. zonat konkrete që i nënshtrohen pezullimit, të cilat përcaktohen për secilën bashki;

ii. llojet e punimeve dhe aktivitetëve që i nënshtrohen pezullimit;

iii. kohën e fillimit dhe të përfundimit të pezullimit sezonal, duke marrë në konsideratë të dhënat ose përvojën e viteve të mëparshme, apo pritshmërinë mbi fluksin e turistëve sipas muajve;

iv. mënyrën e zbatimit të pezullimit, i cili mund të zbatohet në mënyrë të përgjithshme gjatë periudhës së përcaktuar sipas nënparagrafit “iii” ose duke ndaluar punimet përgjatë orareve të caktuara.

2. Periudha e pezullimit sipas këtij neni mbahet parasysh në përcaktimin e afatit total të punimeve për secilën leje ndërtimi apo ushtrimi aktiviteti që jepet në favor të subjekteve.”.

Neni 4

Neni 43 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 43/1, “Kategorizimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë:

1. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:

“1/1. Çdo subjekt zhvillues, përpara miratimit të lejes të ndërtimit për strukturë akomoduese nga organi përgjegjës, duhet të pajiset me një certifikatë paraprake kategorizimi sipas kriterëve të përcaktuara në zbatim të pikës 6 të këtij neni.”.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Kategoritë e strukturave akomoduese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

3. Pika 4 ndryshohet si më poshtë:

“4. Çdo strukturë akomoduese gjatë ushtrimit të veprimtarisë ka detyrimin të kryejë regjistrimin elektronik të klientëve për qëllime të administrimit



të veprimtarisë turistike, hartimit të statistikave zyrtare dhe përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara me ligj, me të dhënat për numrin e vizitorëve, netët e qëndrimit, shtetësinë, rezidencën, gjininë dhe moshën. Përpunimi, ruajtja, transmetimi dhe mbrojtja e këtyre të dhënave kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.”.

4. Pika 5 ndryshohet si më poshtë:

“5. Çdo strukturë akomoduese, si dhe çdo subjekt që ofron shërbimin e ushqimit dhe/ose të pijeve brenda strukturës akomoduese ose në mënyrë të pavarur, detyrohet t’i mbledhë mbetjet e saj brenda ambienteve të saj dhe më pas t’i depozitojë ato për grumbullim vetëm në vendin e posaçëm të përcaktuar nga bashkia për këtë qëllim, në zonën turistike ose pranë saj. Vendi i posaçëm caktohet nga bashkia në zonën turistike ose pranë saj, në një pozicion dhe largësi të tillë që të shmanget vizibiliteti dhe kontakti i drejtpërdrejtë i turistëve dhe pushuesve me vendgrumbullimin e mbetjeve, por pa vështirësuar në mënyrë shpërpjesëtimore veprimtarinë e strukturave akomoduese dhe të subjekteve të tjera që veprojnë në zonën turistike. Çdo bashki miraton rregullat për mënyrën e zbatimit të detyrimeve sipas kësaj pike në zonat turistike në juridiksionin e saj.”.

Neni 6

Në nenin 45, “Klasifikimi i strukturave akomoduese”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Pika 1 shfuqizohet.

2. Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Çdo sipërmarrje turistike, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të paraqesë pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin kërkesën për pajisjen me certifikatë klasifikimi sipas kriterëve të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 7

Në nenin 64 pas pikës 3 shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

“3/1. Subjekti që ushtron veprimtarinë stacion plazhi duhet të garantojë aksesin e lirë, të pandërprerë dhe lëvizjen e lirë të publikut drejt bregut të detit përgjatë vijës bregdetare dhe ndërmjet hapësirave publike të plazhit. Ndalohet vendosja e gardheve, mureve, barrierave apo e çdo pengese

tjetër fizike, të përhershme ose të përkohshme, që kufizon ose pengon këtë akses dhe lëvizje.”.

Neni 8

Në nenin 71 pas shkronjës “s” shtohen shkronjat “sh” dhe “t” me këtë përmbajtje:

“sh) moszbatimi i kriterëve sipas përcaktimeve të nenit 30/1 dënohet me gjobë 2 000 000 lekë;

t) mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në nenin 64, pika 3/1, dënohet me gjobë 200 000 lekë.”.

Neni 9

Dispozitë kalimtare

Për lejet e ndërtimit ose të aktiviteteve të tjera të dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë dhe KKTU-të ose autoritetet e tjera kompetente për dhënien e lejeve të shfrytëzimit për aktivitetet e tjera të lidhura janë të detyruara që në rast pezullimi sipas nenit 30/a të këtij ligji, me kërkesë të subjekteve zhvilluese, miratojnë shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve/aktiviteteve, duke marrë në konsideratë kohëzgjatjen e pezullimit të miratuar.

Neni 10

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 23.7.2026.

Shpallur me dekretin nr. 440, datë 29.7.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.

DEKRET

Nr. 440, datë 29.7.2026

PËR SHPALLJE LIGJI DHE DHËNIEN E PËLQIMIT PËR HYRJEN NË FUQI MENJËHERË TË LIGJIT

Në mbështetje të nenit 84, pikat 1 dhe 4, dhe nenit 93 të Kushtetutës,



DEKRETOJ:

Neni 1

Shpalljen e ligjit nr. 83/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, ‘Për turizmin’, i ndryshuar”.

Neni 2

Dhënien e pëlqimit për hyrjen në fuqi menjëherë të ligjit nr. 83/2026, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 93/2015, ‘Për turizmin’, i ndryshuar”.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj

REZOLUTË

**PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR PËR
VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR
VITIN 2026**

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin kushtetues të Këshillit të Lartë Gjyqësor në garantimin e pavarësisë, përgjegjshmërisë, mirëfunksionimit dhe administrimit efektiv të pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke mbajtur parasysh kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor, në lidhje me emërimin, caktimin në pozicion, transferimin, ngritjen në detyrë, komandimin, riemërimin, vlerësimin etik dhe profesional, si dhe procedimin disiplinor dhe pezullimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve të sistemit gjyqësor;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit institucional ndërmjet Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Shkollës së Magistraturës, veçanërisht në drejtëm të formimit fillestar dhe vazhdues të gjyqtarëve, si dhe të procesit të emërimit të tyre pas përfundimit të Shkollës së Magistraturës;

Duke theksuar rolin e Këshillit të Lartë Gjyqësor në drejtimin, organizimin dhe mbikëqyrjen e administrimit gjyqësor nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave për administrimin e gjykatave, monitorimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe gjykatave, ndjekjen e kohëzgjatjes së çështjeve

gjyqësore, si dhe miratimin e standardeve dhe rregullave të brendshme për funksionimin e gjykatave;

Duke mbajtur në konsideratë nevojën për forcimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në funksion të garantimit të mbarëvajtjes dhe eficiencës së sistemit gjyqësor;

Duke mbajtur parasysh rëndësinë e informimit periodik të Kuvendit dhe publikut për gjendjen, performancën dhe sfidat e sistemit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë;

Duke theksuar rëndësinë e garantimit të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, reduktimit të numrit të çështjeve të prapambetura dhe përmirësimit të cilësisë së administrimit gjyqësor, në përputhje me Kushtetutën, Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe standardet e Komisionit Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ),

Bazuar në analizën e të dhënave të vitit 2025 të referuara në raportin e paraqitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, konstaton:

Zhvillimin e 69 mbledhjeve plenare dhe miratimin e 882 vendimeve gjatë vitit 2025 krahasuar me 65 mbledhje plenare dhe 764 vendime gjatë vitit 2024, duke reflektuar rritje të aktivitetit administrativ dhe vendimmarrës të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Miratimin e akteve nënligjore me karakter normativ për procedurat e ngritjes në detyrë dhe kriteret për emërimin në pozicionet drejtuese të gjykatave të shkallës së parë dhe të dytë, duke adresuar një nga boshllëqet kryesore të evidentuara më herët në administrimin e sistemit gjyqësor.

Vijimin e masave për forcimin e transparencës institucionale dhe komunikimit publik përmes trajtimit të kërkesave për të drejtën e informimit, publikimit të vazhdueshëm të të dhënave për karrierën e gjyqtarëve dhe vendimmarrjen e Këshillit, si dhe zbatimit të Planit të Komunikimit për Gjykatat.

Sigurimin e vazhdimësisë së funksionit të gjyqtarëve të medias dhe forcimin e komunikimit të gjykatave me publikun dhe median, në funksion të rritjes së besimit publik në sistemin gjyqësor dhe transparencës së veprimtarisë gjyqësore.

Vijimin e masave për përmirësimin e treguesve të transparencës institucionale dhe aksesit publik në informacion, duke u reflektuar në vlerësimin me 13



pikë në Indeksin e Transparencës Proaktive për vitin 2025 kundrejt 12 pikëve në vitin 2024.

Vijimin e procesit të standardizimit të praktikave administrative dhe organizative në sistemin gjyqësor, përmes konsultimit të projektakteve me gjykatat dhe përfshirjes së tyre në proceset e planifikimit dhe administrimit institucional.

Bashkëpunimin ndërinstitucional me institucionet e sistemit të drejtësisë, partnerët ndërkombëtarë, përfaqësuesit diplomatikë dhe ekspertët ndërkombëtarë, në funksion të forcimit të reformës në drejtësi dhe përmirësimit të standardeve të funksionimit të sistemit gjyqësor.

Angazhimin aktiv, në kuadër të procesit të integritetit evropian përmes raportimit të zhvillimeve dhe rezultateve të arritura, përditësimit të masave të kërkuara nga Bashkimi Evropian dhe kontributit në përmbushjen e rekomandimeve të kapitullit 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore” dhe kapitullit 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”.

Vijimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve përmes miratimit të 59 raporteve të vlerësimit gjatë vitit 2025, krahasuar me 34 raporte gjatë vitit 2024, si dhe 249 raporteve në total për periudhën 2020–2025, duke reflektuar rritje të ritmit të procedurave të vlerësimit dhe forcim gradual të mekanizmave të meritokracisë në sistemin gjyqësor.

Angazhimin për rritjen e kapaciteteve të strukturave përgjegjëse për vlerësimin profesional të gjyqtarëve përmes shtimit të burimeve njerëzore dhe organizative, në funksion të përshpejtimit të procedurave të karrierës dhe promovimit.

Angazhimin në plotësimin e vakancave në sistemin gjyqësor dhe përgatitjen e brezit të ri të magistratëve përmes emërimit të 42 gjyqtarëve të rinj krahasuar me 32 emërime gjatë vitit 2024, miratimit të kuotave për kandidatët për magistratë dhe ndihmës ligjorë, si dhe vijimit të procedurave të verifikimit për pranimin në Shkollën e Magistraturës.

Miratimin e 126 vendimeve, në kuadër të procedurave të ngritjes në detyrë dhe finalizimin e 12 procedurave të promovimit në gjykatat me ngarkesën më të lartë të çështjeve, veçanërisht në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm dhe Gjykatën Administrative të Apelit.

Vijimin e procedurave të promovimit dhe lëvizjes në karrierë në nivelet më të larta të sistemit gjyqësor, përfshirë Gjykatën e Lartë, Gjykatën

Administrative të Apelit dhe gjykatat e posaçme, në funksion të plotësimit gradual të vakancave dhe garantimit të funksionalitetit institucional.

Ndërmarrjen e masave organizative për garantimin e funksionalitetit të gjykatave përmes përdorimit të mekanizmave të delegimit, caktimit të përkohshëm dhe lëvizjeve paralele të gjyqtarëve, me fokus kryesisht gjykatat me ngarkesë të lartë dhe vakanca të konsiderueshme.

Miratimin e Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor në Shqipëri 2025–2027, si dokumenti i parë strategjik i fokusuar posaçërisht në rritjen e efikasitetit gjyqësor, reduktimin e *backlog*-ut, forcimin e kapaciteteve administrative dhe digjitalizimin e sistemit gjyqësor, në përputhje me standardet e CEPEJ-it dhe rekomandimet e Bashkimit Evropian.

Rritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve dhe stafit administrativ, si dhe angazhimin në analizimin e situatës së gjykatave dhe nevojave të sistemit gjyqësor në nivel kombëtar.

Bashkëpunimin e vazhdueshëm me gjykatat, në funksion të hartimit dhe zbatimit të Strategjisë për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura, si dhe përfshirjen e tyre në procesin e planifikimit strategjik të sistemit gjyqësor për periudhën 2025–2027.

Mbështetjen e Qendrës së Teknologjisë së Informacionit dhe ndërmarrjen e masave për standardizimin e infrastrukturës teknologjike në sistemin gjyqësor, përfshirë forcimin e kapaciteteve teknike dhe mbështetëse.

Implementimin e projekteve strategjike të digjitalizimit, përfshirë zhvillimin e sistemit *Enterprise Service Bus* (ESB), digjitalizimin e arkivave, zgjerimin e shërbimeve elektronike në portalin *e-Albania*, forcimin e sigurisë kibernetike dhe garantimin e funksionimit të platformës “*Promagistratë*”.

Vijimin e implementimit të projektit “*Juronix*” për Sistemin e Ri të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore, duke kaluar nga faza e planifikimit dhe sigurimit të financimit gjatë vitit 2024 në fazën e implementimit gjatë vitit 2025, si një nga investimet kryesore për transformimin digjital të sistemit gjyqësor shqiptar.

Pavarësisht progresit të evidentuar në drejtim të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, konstatohet se një pjesë e konsiderueshme e gjyqtarëve, subjekt vlerësimi, ende nuk kanë përfunduar procesin sipas afateve ligjore, çka vijon



të ndikojë në procedurat e karrierës, promovimit dhe lëvizjes në sistem.

Në të njëjtën kohë, konstatohet se, pavarësisht progresit të arritur gjatë vitit 2025, në drejtim të forcimit institucional të sistemit gjyqësor, mbeten sfida të rëndësishme që lidhen me reduktimin e *backlog*-ut, shkurtimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, balancimin e ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve, përsheptimin e procedurave të karrierës së magistratëve, konsolidimin e sistemeve elektronike të administrimit gjyqësor dhe rritjen e efikasitetit të përgjithshëm të sistemit. Adresimi i këtyre sfidave përbën një prioritet për garantimin e një sistemi gjyqësor më efektiv, më transparent dhe më të aksesueshëm për qytetarët.

Kuvendi rekomandon që Këshilli i Lartë Gjyqësor gjatë vitit 2026 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë zbatimin e Udhërrëfyesit për Efikasitetin e Pushtetit Gjyqësor 2025–2027, duke forcuar mekanizmat e monitorimit të brendshëm dhe duke paraqitur pranë Kuvendit brenda muajit dhjetor të vitit 2026 një informacion të detajuar për nivelin e realizimit të objektivave dhe ndikimin e masave të ndërmarra në rritjen e eficiencës së sistemit gjyqësor.

2. Të realizojë brenda muajit dhjetor të vitit 2026 një analizë të plotë për efektet e hartës së re gjyqësore në funksionimin e sistemit gjyqësor, duke vlerësuar ndikimin e saj në shpërndarjen territoriale të ngarkesës, aksesin në drejtësi, kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, *backlog*-un dhe eficiencën e gjykatave, si dhe të paraqesë në Kuvend rezultatet e kësaj analize, së bashku me masa konkrete për adresimin e problematikave të evidentuara.

3. Të vijojë zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura në Gjykata 2024–2027, duke forcuar mekanizmat e monitorimit dhe raportimit periodik për zbatimin e saj përmes përcaktimit të objektivave të matshëm për secilën gjykatë dhe krijimit të mekanizmave të hershëm për identifikimin e risqeve që ndikojnë në krijimin ose përkeqësimin e *backlog*-ut.

4. Të ndërmarë masa për garantimin e një shpërndarjeje më të balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet gjykatave dhe gjyqtarëve, duke zhvilluar një metodologji të ngarkesës së punës që përfshin kompleksitetin, natyrën dhe kohëzgjatjen e çështjeve.

5. Të analizojë në mënyrë periodike rastet e kthimit të çështjeve për rigjykim nga gjykatat më të larta, me synim evidentimin e problematikave sistemike në zbatimin e legjislacionit dhe praktikës gjyqësore. Në rastet kur konstatohen çështje që lidhen me njëtrajtshmërinë e zbatimit të ligjit, gjetjet i përcillen Gjykatës së Lartë për vlerësim në kuadër të kompetencave të saj për njësimin dhe zhvillimin e praktikës gjyqësore.

6. Të përmirësojë efektivitetin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve, duke adresuar vonesat në zhvillimin e procedurave dhe duke forcuar lidhjen ndërmjet rezultateve të vlerësimit, performancës dhe zhvillimit të karrierës.

7. Të forcojë bashkëpunimin me Shkollën e Magistraturës dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë për planifikimin e nevojave reale të sistemit për magistratë dhe ndihmës ligjorë, si dhe për harmonizimin e proceseve të formimit dhe zhvillimit profesional.

8. Të forcojë transparencën dhe efektivitetin e procedurave të komandimeve, emërimeve dhe lëvizjeve në karrierë, duke garantuar zbatimin e parimit të meritokracisë dhe duke analizuar ndikimin e delegimeve dhe transferimeve të përkohshme në funksionimin e sistemit gjyqësor.

9. Të përsheptojë finalizimin dhe funksionalizimin e plotë të sistemit elektronik të menaxhimit të çështjeve gjyqësore, duke siguruar përdorimin e tij në të gjitha gjykatat dhe ndërveprimin me sistemet e institucioneve të tjera.

10. Të përfundojë miratimin dhe zbatimin e plotë të udhëzuesit për statistikën gjyqësore, duke standardizuar metodologjinë e mbledhjes dhe publikimit të të dhënave sipas standardeve të CEPEJ-it dhe duke garantuar publikimin periodik të indikatorëve të performancës.

11. Të forcojë masat për rritjen e integritetit gjyqësor, duke përfshirë programe trajnimi për etikën, konfliktin e interesit dhe komunikimin publik, si dhe duke vijuar forcimin e standardeve të transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

12. Të vijojë forcimin e kapaciteteve të administratës gjyqësore përmes rritjes profesionale të stafit, përmirësimit të aftësive në përdorimin e sistemeve digjitale dhe rritjes së rolit mbështetës të administratës.

13. Të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe administrimit të veprimtarisë së gjykatave dhe të ushtrimit të detyrës nga magistratët në aspektet



organizative dhe administrative, duke vlerësuar nevojën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe praktikave administrative që lidhen me respektimin e orarit zyrtar, organizimin e punës, rritjen e efikasitetit të veprimtarisë gjyqësore dhe garantimin e aksesit të qytetarëve në shërbimet gjyqësore.

14. Të vijojë përmbylljen e kuadrit nënligjor të parashikuar në legjislacionin për organizimin dhe funksionimin e sistemit gjyqësor, duke raportuar çdo 6 muaj në Kuvend për statusin e akteve të pambyllura, arsyet e vonesave dhe masat e ndërmarra.

15. Të analizojë në mënyrë periodike funksionimin e kuadrit ligjor që ndikon në veprimtarinë e sistemit gjyqësor dhe, bazuar në problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të tij, të formulojë rekomandime dhe propozime për ndryshime ligjore ose nënligjore, me qëllim përmirësimin e procedurave, adresimin e boshllëqeve normative dhe rritjen e efektivitetit të funksionimit të sistemit të drejtësisë.

16. Të vijojë marrjen e masave për përmirësimin e infrastrukturës dhe forcimin e standardeve të sigurisë në gjykata, si dhe të nxisë miratimin dhe zbatimin e unifikuar të rregulloreve të brendshme dhe protokolleve të sigurisë në të gjitha gjykatat e vendit, duke forcuar bashkëpunimin institucional me Kuvendin, Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet përgjegjëse të ekzekutivit.

17. Të kryejë një analizë të plotë të ndikimit të hartës së re gjyqësore në qytetet ku nuk funksionon më gjykata, përfshirë kostot për qytetarët, nevojën për shërbime lehtësuese, zgjidhje digjitale ose masa të tjera kompensuese dhe t'i paraqesë Kuvendit gjetjet, rekomandimet dhe masat e nevojshme sipas rastit.

18. Në funksion të plotësimit të vakancave, të marrë masa për të shmangur përdorimin e transferimeve si alternativa ndaj procedurave të emërimeve. Gjithashtu, të plotësojë me përparësi pozicionet e drejtuesve të gjykatave në të gjitha nivelet, duke miratuar dhe publikuar një kalendar të procedurave, duke prioritarizuar gjykatat me vakanca të zgjatura ose ngarkesë të lartë.

19. Të marrë masa që vendimet për procedurat e transferimit të arsyetohen në mënyrë të plotë dhe të qartë, me tregues konkretë të ngarkesës së gjykatës, duke arsyetuar nevojën për të plotësuar trupat gjyqësorë, përmbushjen e kritereve ligjore, si dhe këto vendime të publikohen rregullisht në funksion

të pavarësisë së gjyqtarëve dhe transparencës ndaj qytetarëve.

20. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të konsolidojë llogaridhënien dhe integritetin e prokurorëve nëpërmjet verifikimit të plotë dhe sistematik të deklarimeve pasurore, në përputhje me standardet e vendosura nga procesi i rivlerësimit kalimtar.

21. Të ndërmarë masa për zbatimin efektiv, transparent dhe të auditueshëm të rregullave të shpërndarjes rastësore të çështjeve, duke garantuar automatizimin e plotë, regjistrimin dhe arsyetimin e çdo përjashtimi, raportimin periodik për ndërhyrjet manuale, auditimin e sistemit dhe lidhjen e tij me sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve.

22. Të forcojë mekanizmat e monitorimit të kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore, duke analizuar periodikisht problematikat sistematike, shkaqet e vonesave dhe masat e nevojshme për eliminimin e tyre, si dhe të publikimit në kohë dhe në mënyrë të standardizuar të vendimeve gjyqësore, në përputhje me KEDNJ-në dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së.

23. Të forcojë bashkëpunimin institucional me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe, kur është e nevojshme, me Këshillin e Lartë të Prokurorisë për shkëmbimin e të dhënave, identifikimin e problematikave sistematike, adresimin e risqeve të integritetit dhe forcimin e llogaridhënies në sistemin e drejtësisë.

24. Në konsideratë të normës shumë të ulët të veprimit institucional për çështjet disiplinore, të forcojë angazhimin për të adresuar me efektivitet këto çështje në funksion të llogaridhënies, si një përgjegjësi e përhershme e organeve të reja të sistemit të drejtësisë.

25. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, të promovojë gjykatat dhe aktorët përgjegjës, përdorimin e mekanizmave alternativë të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, përmes informimit të qytetarëve, trajnimit të administratës gjyqësore, orientimit procedural dhe evidentimit të ndikimit të këtyre mekanizmave në uljen e ngarkesës gjyqësore.

26. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies



dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

27. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe të publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke mbajtur parasysh rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në garantimin e pavarësisë, llogaridhënies, disiplinës, statusit dhe karrierës së prokurorëve të Republikës së Shqipërisë;

Duke nënvizuar rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në emërimin, vlerësimin, ngritjen në detyrë, transferimin dhe vendosjen e masave disiplinore për prokurorët e të gjitha niveleve;

Duke mbajtur parasysh rolin kyç të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për vlerësimin etik dhe profesional të prokurorit;

Duke mbajtur në konsideratë rolin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë në miratimin e standardeve të etikës së prokurorëve dhe të rregullave të sjelljes së prokurorëve, si dhe për mbikëqyrjen e respektimit të tyre;

Duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë me Shkollën e Magjistraturës për trajnimin vazhdues të prokurorëve dhe emërimin e prokurorëve pas diplomimit në Shkollën e Magjistraturës,

Në vlerësim të raportit të paraqitur nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për veprimtarinë e tij për vitin 2025, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij, konstaton:

Garantimin e funksionimit të sistemit të prokurorisë nëpërmjet administrimit të proceseve që lidhen me statusin, karrierën, llogaridhënien dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve, të materializuara gjatë vitit 2025 në miratimin e 384 akteve administrative me karakter individual, kolektiv dhe normativ.

Vijimin e proceseve të administrimit të karrierës së prokurorëve përmes emërimit të 26 prokurorëve të rinj, zhvillimit të procedurave të lëvizjeve paralele dhe përmbushjes së procedurave për emërimin e drejtuesve të prokurorisë të juridiksionit të përgjithshëm, Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit.

Përparimin e procesit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve përmes përfundimit të 40 raporteve të vlerësimit, duke reflektuar rritjen e kapaciteteve institucionale dhe adresimin gradual të rekomandimeve të Bashkimit Evropian. Megjithatë, evidentohet nevoja për përsheptimin e këtij ritmi dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të periodicitetit të vlerësimeve dhe lidhjes së tyre me zhvillimin e karrierës dhe performancën e sistemit.

Ndërmarrjen e masave konkrete për reduktimin e vakancave në sistemin e prokurorisë, duke ulur numrin e tyre nga 121 në 96 vende vakante. Megjithatë, analiza eidenton se niveli i vakancave vijon të mbetet i konsiderueshëm në disa prokurori dhe ritmi i plotësimit të tyre mbetet më i ulët se nevojat reale të sistemit, ndërsa mungon një analizë afatmesme për nevojat për burime njerëzore dhe kapacitetet e formimit të magistratëve.

Evidentimin e sfidave që lidhen me shpërndarjen e burimeve njerëzore dhe ndikimin e vakancave në ngarkesën e punës dhe funksionimin efektiv të prokurorisë, veçanërisht në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm.

Ushtrimin e kompetencave disiplinore në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, duke garantuar funksionimin e procedurave disiplinore, në përputhje me standardet e procesit të rregullt dhe të pavarur.

Vijimin e konsolidimit të kuadrit rregullator të institucionit përmes miratimit dhe përditësimit të akteve nënligjore që lidhen me vlerësimin etik dhe profesional, konfliktin e interesit, organizimin e brendshëm, mentorimin e kandidatëve për prokurorë, administrimin e dosjeve të personelit dhe çështje të tjera të administrimit të sistemit të prokurorisë. Megjithatë, procesi i përditësimit të



kuadrit rregullator mbetet dinamik dhe kërkon monitorim të vazhdueshëm në funksion të harmonizimit me zhvillimet ligjore dhe nevojat praktike të sistemit.

Miratimi i Planit Strategjik 2025–2029 dhe Planit të Veprimit përbën një zhvillim të rëndësishëm në drejtim të planifikimit institucional afatmesëm dhe afatgjatë të Këshillit. Megjithatë, evidentohet nevoja për forcimin e mekanizmave të monitorimit të zbatimit të objektivave strategjikë, matjes së rezultateve dhe lidhjes së tyre me planifikimin buxhetor dhe administrimin e burimeve njerëzore.

Angazhimin aktiv të Këshillit në përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga procesi i integritetit evropian, veçanërisht në kuadër të kapitullit 23 të negociatave me Bashkimin Evropian, duke adresuar rekomandimet e Komisionit Evropian dhe duke përmirësuar koordinimin institucional me organet e tjera të qeverisjes së sistemit të drejtësisë.

Përmirësimin e bashkëpunimit institucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe institucionet e tjera të sistemit të drejtësisë, në funksion të harmonizimit të praktikave, koordinimit të proceseve dhe rritjes së efektivitetit të administrimit të sistemit të drejtësisë.

Vijimin e proceseve të digjitalizimit dhe modernizimit të administrimit të sistemit të prokurorisë, Megjithatë evidentohet nevoja për përshejtimin e implementimit të projekteve teknologjike dhe forcimin e kapaciteteve administrative e teknike, në funksion të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe cilësisë së shërbimeve institucionale.

Nevojën për të theksuar se Këshilli funksionon si institucion kolegjal, i cili duhet të udhëhiqet ndër të tjera nga parimi i komunikimit dhe ndërveprimit me respekt reciprok ndërmjet anëtarëve të tij, sipas standardeve më të larta të etikës institucionale.

Kuvendi rekomandon që Këshilli i Lartë i Prokurorisë për vitin 2026, në përmbushje të detyrave të ngarkuara me ligj, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, të zhvillojë një analizë të plotë për organizimin dhe burimet njerëzore të sistemit të prokurorisë, duke përfshirë numrin e prokurorëve për çdo prokurori, vakancat e përhershme dhe të përkohshme, ngarkesën e punës, stokun e çështjeve, efektet e organizimit dhe rishpërndarjes aktuale të burimeve njerëzore në funksionimin e sistemit, nevojat për prokurorë dhe staf mbështetës sipas

prokurorive, si dhe perspektivën afatmesme të zhvillimit të tij, me qëllim krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të planifikimit strategjik të burimeve njerëzore dhe adresimin e problematikave të evidentuara. Në këtë kuadër, të paraqesë pranë Kuvendit, deri në fund të muajit shtator të vitit 2026, rezultatet e kësaj analize së bashku me masat konkrete të propozuara për përmirësimin e organizimit dhe rritjen e efikasitetit të sistemit të prokurorisë.

2. Të vijojë konsolidimin e sistemit të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, duke garantuar realizimin në kohë të procedurave të vlerësimit, standardizimin e praktikave, rritjen e cilësisë së raporteve analitike dhe zhvillimin e sistemeve elektronike mbështetëse të procesit, si dhe duke forcuar lidhjen ndërmjet rezultateve të vlerësimit, performancës dhe zhvillimit të karrierës.

3. Të forcojë transparencën dhe efektivitetin e procedurave të emërimit, ngritjes në detyrë, transferimit dhe komandimit të prokurorëve, duke garantuar zbatimin e parimit të meritokracisë dhe duke analizuar ndikimin e këtyre mekanizmave në funksionimin e sistemit të prokurorisë.

4. Të forcojë mekanizmat e monitorimit dhe administrimit të funksionimit të sistemit të prokurorisë dhe të ushtrimit të funksionit të prokurorëve në aspektet organizative dhe administrative, duke vlerësuar nevojën për përmirësimin e kuadrit rregullator dhe praktikave administrative që lidhen me respektimin e orarit zyrtar të punës, organizimin e veprimtarisë së prokurorive, administrimin e burimeve njerëzore dhe rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së sistemit të prokurorisë.

5. Të vijojë bashkëpunimin për forcimin e kapaciteteve administrative dhe organizative të sistemit të prokurorisë, zhvillimin profesional të stafit mbështetës, përmirësimin e aftësive në përdorimin e sistemeve digjitale, rritjen e rolit mbështetës të administratës dhe forcimin e mekanizmave të monitorimit të funksionimit administrativ të prokurorive.

6. Të bashkëpunojë në zhvillimin e mekanizmave të standardizuar për mbledhjen, administrimin dhe analizimin e të dhënave statistikore për funksionimin e sistemit të prokurorisë, duke raportuar tregues të matshëm për ngarkesën e punës, stokun e çështjeve, kohëzgjatjen e procedimeve, procedurat e karrierës dhe tregues të



tjerë të performancës institucionale, në përputhje me standardet evropiane dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.

7. Të përshpejtojë procesin e transformimit digjital të veprimtarisë së Këshillit dhe të sistemit të prokurorisë, duke vijuar projektet për administrimin elektronik të proceseve, digjitalizimin e arkivave, zhvillimin e sistemeve të integruara të informacionit dhe statistikave, si dhe ndërveprimin e tyre me sistemet e institucioneve të tjera të drejtësisë.

8. Të vijojë përmirësimin dhe përmbylljen e kuadrit rregullator të institucionit, duke përfunduar miratimin e akteve nënligjore të nevojshme, monitoruar periodikisht efektivitetin e zbatimit të tyre dhe raportuar në Kuvend për statusin e akteve të pambyllura, arsyet e vonesave dhe masat e ndërmarra.

9. Të bashkëpunojë për analizimin në mënyrë periodike të funksionimit të kuadrit ligjor dhe nënligjor, që ndikon në organizimin dhe funksionimin e sistemit të prokurorisë dhe, bazuar në problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të tij, të formulojë rekomandime dhe propozime për ndryshime ligjore ose nënligjore, me qëllim përmirësimin e procedurave, adresimin e boshllëqeve normative, harmonizimin e praktikave institucionale dhe rritjen e efektivitetit të funksionimit të sistemit të drejtësisë.

10. Në bashkëpunim me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe institucionet e tjera përgjegjëse, të zhvillojë analiza periodike për problematikat sistemike që evidentohen nga procedurat disiplinore, ankesat dhe mekanizmat e mbikëqyrjes së veprimtarisë së prokurorëve, me qëllim identifikimin e nevojave për përmirësimin e praktikave institucionale, zhvillimin profesional, forcimin e standardeve etike dhe, kur është e nevojshme, formulimin e propozimeve për përmirësime të kuadrit rregullator.

11. Të zhvillojë mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin e zbatimit të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe detyrimeve që burojnë nga procesi i negociatave për anëtarësim, duke raportuar periodikisht për masat e ndërmarra, rezultatet e arritura dhe sfidat e evidentuara në fushat që lidhen me kompetencat e Këshillit.

12. Të standardizojë raportimin për veprimtarinë e Komisionit të Përkohshëm të Shqyrtimit të Ankesave kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke publikuar dhe raportuar

periodikisht të dhëna statistikore për numrin e ankesave të paraqitura dhe të shqyrtuara, rezultatet e vendimmarrjes, kohëzgjatjen e procedurave dhe problematikat e evidentuara gjatë funksionimit të këtij mekanizmi.

13. Të raportojë periodikisht për çështjet ku Këshilli është palë, duke përfshirë tregues për tipologjinë e proceseve gjyqësore, rezultatet e tyre, ndikimin në praktikën institucionale dhe masat e ndërmarra për parandalimin e mosmarrëveshjeve gjyqësore të përsëritura dhe përputhshmërinë e vendimmarrjeve të Këshillit me parimin e sigurisë juridike.

14. Të forcojë transparencën dhe llogaridhënien institucionale, duke orientuar raportimin publik dhe parlamentar jo vetëm drejt pasqyrit të aktivitetit procedural të Këshillit, por edhe drejt matjes së rezultateve dhe ndikimit të vendimmarrjes së tij në funksionimin e sistemit të prokurorisë nëpërmjet treguesve të standardizuar të performancës dhe raportimit periodik të tyre.

15. Të zhvillojë dhe konsolidojë një sistem të integruar të monitorimit të performancës institucionale të Këshillit dhe të sistemit të prokurorisë, duke standardizuar metodologjinë e mbledhjes dhe analizës së të dhënave statistikore, treguesit e performancës dhe mekanizmat e raportimit publik dhe parlamentar, në funksion të matjes së rezultateve të vendimmarrjes së Këshillit, monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të Bashkimit Evropian dhe forcimit të llogaridhënies institucionale.

16. Të mbështesë masat për përmirësimin e infrastrukturës dhe forcimin e standardeve të sigurisë në institucionet e sistemit të prokurorisë, si dhe të nxisë miratimin dhe zbatimin e standardeve dhe protokolleve të unifikuara të sigurisë, duke forcuar bashkëpunimin institucional me Kuvendin, Ministrinë e Drejtësisë, Prokurorin e Përgjithshëm dhe institucionet përgjegjëse të ekzekutivit.

17. Në kuadër të vlerësimit etik dhe profesional të prokurorëve, të vlerësojë cilësinë e akteve, arsyetimin dhe respektimin e standardeve të procesit të rregullt dhe të afateve ligjore përkundrejt palëve në proces, në përputhje me jurisprudencën e Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe GJEDNJ-së.

18. Të zbatojë standarde të njëjta të promovimit të prokurorëve, duke shmangur promovimet në



grup, si dhe të përmirësojë dokumentimin e procedurave vendimmarrëse.

19. Të hartojë dhe publikojë udhëzime interpretuese, duke përfshirë praktika të unifikuara për elementet cilësore të procesit të vlerësimit, me qëllim rritjen e parashikueshmërisë, krahasueshmërisë, koherencës dhe gjurmueshmërisë së arsyetimit të vendimmarrjes.

20. Të arsyetojë në mënyrë të plotë vendimet lidhur me procedurat e emërimit, ngritjes në detyrë, transferimit dhe komandimit të prokurorëve, si dhe të mundësojë aksesin në kohë të publikut në to.

21. Të analizojë ankesat dhe procedimet disiplinore të papërfunduara ndaj prokurorëve, duke identifikuar shkaqet e vonesave dhe duke miratuar masa konkrete për reduktimin e tyre brenda muajit dhjetor të vitit 2026.

22. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të konsolidojë llogaridhënien dhe integritetin e prokurorëve nëpërmjet verifikimit të plotë dhe sistematik të deklarimeve pasurore, në përputhje me standardet e vendosura nga procesi i rivlerësimit kalimtar.

23. Të mbështesë Prokurorin e Përgjithshëm në përmirësimin dhe zbatimin e masave për të siguruar zbatimin efektiv të rregullave të shpërndarjes rastësore të çështjeve në prokurori, për realizimin e automatizimit të plotë, gjurmueshmërisë dhe mekanizmat e auditimit të procesit, për të garantuar integritetin dhe paanësinë e këtij procesi.

24. Në bashkëpunim me Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, të analizojë, në përputhje me rekomandimin e BE-së, nevojën për rishikim të rregullave dhe procedurave lidhur me procesin e emërimit të drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për të qartësuar dhe garantuar procese të hapura, konkurruese dhe pa vonesa.

25. Të forcojë bashkëpunimin me Shkollën e Magjistraturës dhe Prokurorin e Përgjithshëm për përmirësimin e kurrikulës së formimit fillestar dhe vazhdues të prokurorëve, duke realizuar një analizë të nevojave specifike të sistemit të prokurorisë, me fokus në hetimet financiare, krimin kibernetik, standardet e procesit të rregullt, etikën, komunikimin publik dhe menaxhimin e çështjeve.

26. Të bashkëpunojë me Prokurorin e Përgjithshëm për hartimin e metodologjisë dhe planit konkret të veprimit për reduktimin e çështjeve

të prapambetura në të gjitha nivelet e sistemit të prokurorisë brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2026.

27. Të nxisë prokuroritë përmes mekanizmave të Këshillit që të rrisin transparencën dhe komunikimin me publikun dhe viktimat e veprave penale, duke garantuar informimin e qartë dhe në kohë të qytetarëve për statusin e çështjeve, në përputhje me rregullat e ruajtjes së sekretit hetimor, mbrojtjen e të dhënave personale dhe me të drejtat e palëve në proces.

28. Në konsideratë të përfundimit të mandatit të Prokurorit të Përgjithshëm në detyrë në muajin dhjetor të vitit 2026, të garantojë standarde vlerësimi dhe përzgjedhjeje të kandidatëve me integritetin më të lartë, duke shmangur çdo lloj ndikimi në këtë proces me rëndësi për ruajtjen e pavarësisë dhe paanësisë së funksionimit të zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm dhe të prokurorëve të juridiksionit të përgjithshëm.

29. Të forcojë funksionin parandalues dhe orientues, lidhur me çështje të etikës profesionale nëpërmjet një sistemi periodik dhe të anonimizuar raportimi të Këshilltarit të Etikës për çështjet etike të përsëritura, këshillimet e ofruara, zbatimin e mekanizmave të konfliktit të interesit, masat parandaluese dhe nevojat për trajnim, duke garantuar në çdo rast konfidencialitetin e informacionit.

30. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

31. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës të hartojë dhe publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miratuar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke vlerësuar rolin e Kontrollit të Lartë të Shtetit si institucioni më i lartë shtetëror i auditimit të jashtëm në Republikën e Shqipërisë;

Duke vlerësuar rëndësinë e funksionimit të këtij institucioni mbi bazë të garantimit të parimeve të pavarësisë, integritetit, objektivitetit, përgjegjshmërisë, interesit të publikut, profesionalizmit, bashkëpunimit dhe transparencës;

Duke mbështetur dhe nxitur Kontrollin e Lartë të Shtetit për të punuar dhe kontribuar për një qeverisje të mirë nëpërmjet parandalimit dhe luftës pa kompromis kundër korrupsionit, rritjes së besimit të publikut dhe nxitjes së përdorimit me ekonomikitet, eficiencë dhe efikasitet të fondeve publike, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe praktikatat më të mira të BE-së e standardeve ndërkombëtare INTOSAI,

Vlerëson veprimtarinë e Kontrollit të Lartë të Shtetit gjatë vitit 2025, në këto drejtime:

Angazhimin institucional për kryerjen e auditimeve në pajtueshmëri me standardet dhe praktikatat ndërkombëtare të auditimit, duke bërë të mundur përfundimin dhe evadimin e 190 auditimeve të ushtruara në 271 subjekte në nivel vendor dhe qendror, me një rritje prej 16.3% krahasuar me vitin 2024, si dhe zgjerimin e mbulimit auditues në sektorë strategjikë, si: energjia, infrastruktura, administrimi fiskal, shëndetësia, arsimi, siguria kibernetike dhe menaxhimi i pronës publike.

Rritjen e rolit të auditimit financiar dhe auditimit të teknologjisë së informacionit, ku gjatë vitit 2025 janë realizuar 63 auditime financiare dhe 10 auditime IT, duke reflektuar një orientim më të madh drejt kontrollit të cilësisë së raportimit financiar dhe adresimit të risqeve që lidhen me transformimin digjital dhe sigurinë kibernetike të institucioneve publike.

Zgjerimin e aktivitetit auditues në drejtim të auditimeve të kombinuara, auditimeve tematike dhe auditimeve të performancës, duke realizuar 32 auditime të kombinuara, 13 auditime tematike dhe

13 auditime performance, të fokusuara në fusha me interes të lartë publik, si: cilësia e ujit të pijshëm, menaxhimi i mbetjeve, disponueshmëria e barnave, mirëqenia sociale, shërbimet publike dhe trajtimi i personave të dënuar.

Intensifikimin e monitorimit të zbatimit të rekomandimeve të lëna ndaj institucioneve publike, duke realizuar 15 auditime të posaçme për zbatimin e rekomandimeve dhe duke verifikuar zbatimin e 4348 rekomandimeve të adresuara më parë ose rreth 99.3% të totalit të tyre, nga të cilat rreth 52% rezultojnë të zbatuara plotësisht ose pjesërisht.

Adresimin e një numri total prej 4994 rekomandimesh për institucionet publike të audituara, nga të cilat 3268 masa organizative, 916 masa disiplinore, 722 masa për efekte financiare, 59 masa administrative dhe 29 rekomandime për përmirësime ligjore, duke kontribuar në përmirësimin e funksionimit administrativ, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe rritjen e përgjegjshmërisë institucionale.

Vijimin e punës për rritjen e dobisë së rezultateve të auditimit, duke evidentuar parregullsi dhe shkelje financiare me efekt negativ në buxhetin e shtetit, në vlerën totale prej rreth 26.2 miliardë lekë, përfshirë rreth 1.6 miliardë lekë dëm ekonomik dhe rreth 24.6 miliardë lekë efekte negative financiare të lidhura kryesisht me administrimin e të ardhurave publike, sektorin doganor, menaxhimin e shpenzimeve publike dhe përdorimin joefektiv të fondeve buxhetore.

Përmirësimin e kuadrit metodologjik dhe standardizimit të proceseve të auditimit, përfshirë rishikimin e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë dhe hartimin e aneksit të posaçëm për përlogaritjen e dëmit ekonomik, duke synuar unifikimin e praktikave të auditimit dhe forcimin e cilësisë së evidencës audituese në përputhje me standardet e INTOSAI-t.

Intensifikimin e bashkëpunimit me organet ligjzbatuese në luftën kundër korrupsionit dhe shkeljeve financiare, duke përcjellë 43 materiale për hetim të mëtejshëm dhe 8 kallëzime penale pranë organeve kompetente për raste të konstatuara gjatë auditimeve.

Administrimin e 189 letrave dhe ankesave të qytetarëve dhe subjekteve të interesuara, ku rreth 48% e tyre lidhen me çështje të vetëqeverisjes vendore dhe administrimit të pronës publike, duke



reflektuar vijimin e rolit të institucionit në adresimin e shqetësimeve me interes publik.

Intensifikimin e përpjekjeve për promovimin e transparencës dhe komunikimit publik përmes publikimit të raporteve audituese, dokumenteve statistikore dhe zhvillimit të komunikimit institucional në rrjetet sociale, si: *Facebook*, *Instagram* dhe *LinkedIn*, si dhe publikimit të 1115 artikujve dhe kronikave në median e shkruar dhe audiovizive.

Arritjen e rezultateve të rëndësishme në forcimin e kapaciteteve profesionale të stafit të institucionit, ku janë zhvilluar mbi 137 tema trajnimi, përfshirë trajnime të organizuara nga ASPA dhe partnerë ndërkombëtarë, duke realizuar mesatarisht 27.5 ditë trajnimi për çdo auditues dhe 21.3 ditë për stafin joauditues.

Forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar përmes nënshkrimit të memorandumëve të mirëkuptimit dhe realizimit të auditimeve të përbashkëta dhe paralele me institucione supreme të auditimit të :Kosovës, Maqedonisë së Veriut, Norvegjisë, Azerbajxhanit dhe organizata ndërkombëtare si UN Women, në fusha si: siguria e digave, fuqizimi i grave në vendimmarrje, auditimi i performancës dhe siguria kibernetike.

Kuvendi rekomandon që Kontrolli i Lartë i Shtetit për vitin 2026 të angazhohet në këto drejtime:

1. Të ndërtojë një model auditimi më të krahueshëm me institucionet supreme të auditimit të vendeve të Bashkimit Evropian, duke forcuar orientimin drejt auditimeve me ndikim strategjik, analizës së riskut, matjes së performancës së politikave publike dhe rritjes së impaktit të rekomandimeve në mirëqeverisjen dhe administrimin e financave publike.

2. Të forcojë më tej bashkëpunimin institucional me komisionin parlamentar përgjegjës për mbikëqyrjen institucionale dhe Nënkomisionin për Auditimin Publik përmes paraqitjes së raporteve periodike 4-mujore për problematikat sistematike të evidentuara gjatë auditimeve, institucionet me nivel të lartë risku financiar dhe administrativ, ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të auditimit, si dhe çështjet me interes të lartë për qytetarët, që lidhen me administrimin e fondeve publike, cilësinë e shërbimeve publike, transparencën, integritetin dhe mirëqeverisjen, me synim rritjen e efektivitetit të mbikëqyrjes parlamentare dhe forcimin e logaridhënies publike.

3. Të vijojë dhe të përshpejtojë përmirësimin e kuadrit metodologjik dhe nënligjor, duke përfunduar përditësimin e Rregullores së Procedurave të Auditimit dhe duke siguruar harmonizimin e plotë të saj me manualët dhe udhëzuesit ekzistues. Gjithashtu, rekomandohet zhvillimi i një metodologjie të plotë dhe të unifikuar për përllogaritjen e dëmit ekonomik, e cila të përfshijë ndarjen dhe pasqyrimin e tij sipas periudhës në të cilën është krijuar, si dhe të adresojë trajtimin e rasteve komplekse dhe klasifikimin e qartë të efekteve financiare. Paralelisht, KLSH-ja duhet të angazhohet në përmirësimin e manualeve ekzistuese, standardizimin e metodologjive në të gjitha fushat e auditimit dhe plotësimin e procedurave të detajuara operationale, në përputhje me rekomandimet e procesit të *peer review*, me qëllim sigurimin e një kuadri metodologjik të plotë, të qëndrueshëm dhe të zbatueshëm në praktikë.

4. Të rishikojë planifikimin e auditimeve të performancës, duke e orientuar fokusin drejt një mbulimi më të balancuar të Objektiveve të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht në fusha aktualisht të nënaudituar, si: zhvillimi ekonomik dhe tregu i punës (SDG 8), industria, inovacioni dhe infrastruktura (SDG 9), energjia dhe tranzicioni energjetik (SDG 7), si dhe qeverisja, transparenca dhe institucionet efektive (SDG 16) dhe bashkëpunimi ndërinstitutional (SDG 17). Gjithashtu, rekomandohet shmangia e mbivendosjeve tematike përmes një planifikimi më të koordinuar dhe të bazuar në analizën e riskut, me qëllim rritjen e vlerës së shtuar, efektivitetit dhe impaktit të auditimeve të performancës.

5. Të ndërtojë një program shumëvjeçar auditimi për kontratat koncesionare dhe partneritetet publike private, duke garantuar auditimin e tyre periodik gjatë të gjithë ciklit të jetës së kontratës dhe jo vetëm në faza të veçanta të zbatimit, me fokus të posaçëm në analizën e kostove reale të investimit, detyrimeve kontingjente, ndarjes së riskut, performancës së shërbimit dhe ndikimit fiskal për buxhetin e shtetit.

6. Të forcojë auditimin periodik të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të krijuara me ligj të veçantë, duke garantuar mbulim të rregullt auditues për vlerësimin e zbatimit të kuadrit ligjor, efektivitetit institucional, realizimit të objektivave funksionale, administrimit të burimeve njerëzore, nivelit të transparencës dhe zbatimit të



rekomandimeve të mëparshme, me qëllim forcimin e llogaridhënies ndaj publikut.

7. Të rrisë mbulimin dhe cilësinë e auditimeve të teknologjisë së informacionit dhe sigurisë kibernetike në institucionet publike, duke marrë në konsideratë rritjen e varësisë së administratës publike nga sistemet elektronike dhe risqet që lidhen me mbrojtjen e të dhënave, vazhdimësinë e shërbimeve publike dhe integritetin e sistemeve shtetërore.

8. Të përmirësojë transparencën dhe aksesueshmërinë publike të raporteve të auditimit, duke siguruar publikimin në kohë të raporteve, standardizimin e statistikave audituese dhe publikimin e informacionit të strukturuar për nivelin e zbatimit të rekomandimeve dhe problematikat sistemike të evidentuara gjatë auditimeve.

9. Të marrë masa për përmirësimin e transparencës proaktive, duke siguruar publikimin e plotë, të përditësuar dhe të strukturuar të informacionit, në përputhje me kërkesat e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, duke siguruar publikimin e plotë dhe të përditësuar të strukturës organizative dhe të stafit, përfshirë funksionet dhe nivelet përkatëse, në përputhje me organizimin aktual të institucionit. Gjithashtu, rekomandohet përditësimi i Rregullores së Organizimit të Punës në reflektim të ndryshimeve të fundit strukturore, si dhe publikimi i saj në mënyrë të plotë dhe të aksesueshme për publikun, me qëllim rritjen e qartësisë, transparencës dhe llogaridhënies institucionale.

10. Të intensifikojë përpjekjet për plotësimin e vendeve vakante dhe të përqendrohet në optimizimin e kapaciteteve profesionale të stafit përmes trajnimeve të specializuara dhe zhvillimit të njohurive inovative në fushën e auditimit, duke rritur kështu aftësitë dhe efektivitetin e punës audituese.

11. Të japë të dhëna statistikore në raportet vjetore për rezultatet e referimeve penale të KLSH-së në organet ligjzbatuese, si dhe për proceset gjyqësore ku institucioni është palë.

12. Të angazhojë kapacitetet e nevojshme institucionale për pasurimin e platformës *online* të monitorimit të Kuvendit, duke hedhur në mënyrë të plotë rekomandimet e auditimeve të KLSH-së, përfshirë edhe ato të mbartura gjatë periudhës së rikonfigurimit të platformës, me qëllim krijimin e një baze të konsoliduar të të dhënave, mundësimin e përditësimit në vijim të statusit të zbatimit të

rekomandimeve nga institucionet përgjegjëse dhe forcimin e efektivitetit të mekanizmit parlamentar të monitorimit, në përputhje me standardet e transparencës dhe llogaridhënies të rekomanduara nga SIGMA dhe Bashkimi Evropian.

13. Të ndërmarrë masat e nevojshme për rishikimin e metodologjisë dhe rregulloreve të brendshme të auditimit, duke parashikuar afate të qarta orientuese për përfundimin e fazave procedurale ndërmjet mbylljes së auditimit, shqyrtimit të komenteve të subjektit të audituar, miratimit dhe publikimit të raportit përfundimtar, në përputhje me praktikatat më të mira të Institucioneve Supreme të Auditimit dhe parimet e INTOSAI-t, me synim rritjen e efektivitetit dhe impaktit të rekomandimeve të auditimit.

14. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

15. Të zhvillojë një proces të brendshëm vlerësimi të mekanizmave që garantojnë integritetin, objektivitetin, paanshmërinë dhe gjurmueshmërinë e procesit auditues, duke shqyrtuar nevojën për përmirësime metodologjike, procedurale apo ligjore, në përputhje me standardet ISSAI dhe praktikatat më të mira të INTOSAI-t, me qëllim forcimin e besueshmërisë institucionale dhe rritjen e besimit të publikut në veprimtarinë e KLSH-së. Brenda 4 muajve nga miratimi i kësaj rezolute t'i përcjellë Kuvendit informacion të detajuar për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

16. Të parashikojë kryerjen periodike të vlerësimeve të jashtme '*peer review*' me pjesëmarrjen e institucioneve homologe ose ekspertëve ndërkombëtarë, për të vlerësuar cilësinë e sistemit të auditimit, proceset e sigurimit të cilësisë dhe përputhshmërinë me standardet ISSAI, duke bërë publike gjetjet dhe planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve që dalin nga ky proces.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

**REZOLUTË****PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË
PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM
PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET
PËR VITIN 2026****Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke njohur rëndësinë e rolit kushtetues dhe ligjor të Prokurorisë në ushtrimin e ndjekjes penale, përfaqësimin e akuzës në gjyq, ekzekutimin e vendimeve penale dhe kryerjen e detyrave të tjera të ngarkuara me ligj;

Duke marrë në konsideratë raportimin vjetor të Prokurorit të Përgjithshëm në Kuvend për gjendjen e kriminalitetit në vend, efektivitetin e ndjekjes penale, cilësinë e përfaqësimit të akuzës në gjyq dhe zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit;

Duke njohur rolin e Prokurorit të Përgjithshëm në nxjerrjen e udhëzimeve të përgjithshme për prokurorët e prokurorive me juridiksion të përgjithshëm dhe për oficerët e Policisë Gjyqësore, si dhe në mbikëqyrjen e zbatimit të tyre;

Duke vlerësuar rëndësinë e forcimit të hetimeve proaktive, hetimeve financiare, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale, si instrumente të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të luftës kundër kriminalitetit;

Duke marrë në konsideratë nevojën për zbatimin e parimit të proporcionalitetit në kërkimin e masave të sigurimit personal dhe përdorimin më të gjerë të masave alternative ndaj arrestit;

Duke marrë në konsideratë rekomandimet e Bashkimit Evropian, GRECO-s, MONEYVAL-it, CEPEJ-it dhe organizmave të tjerë ndërkombëtarë që lidhen me funksionimin e prokurorisë, cilësinë e drejtësisë, hetimet financiare, bashkëpunimin ndërkombëtar dhe respektimin e standardeve të procesit të rregullt ligjor,

Vlerëson veprimtarinë e Prokurorit të Përgjithshëm gjatë vitit 2025, në drejtim të:

Administrimit të 66 397 materialeve në shqyrtim, ndjekjes së 50 121 procedimeve penale, regjistrimit të 27 077 procedimeve të reja, përfaqësimit të akuzës në 10 423 procedime në shkallë të parë, dërgimit në gjykatë të 12 249 të pandehurve, çështjeve të filluara kryesisht dhe përdorimit të mjeteve të posaçme hetimore në 387 procedime penale, si dhe sekuestrimit të aseteve me vlerë rreth 4.057 miliardë

lekë dhe konfiskimit të aseteve me vlerë rreth 305 milionë lekë.

Miratimit të udhëzimeve të përgjithshme, urdhrave dhe akteve administrative, me qëllim unifikimin e praktikës së prokurorive me juridiksion të përgjithshëm, orientimin e politikës penale dhe përmirësimin e standardeve të ndjekjes penale.

Masave të ndërmarra për forcimin e hetimeve proaktive, rritjen e rolit aktiv të prokurorit në nisjen e procedimeve kryesisht, si dhe përdorimin më efektiv të mjeteve dhe teknikave të posaçme hetimore.

Angazhimit për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje, grave, të miturve dhe grupeve vulnerabël përmes zbatimit të udhëzimeve përkatëse, forcimit të politikës penale, trajnimeve dhe bashkëpunimit.

Angazhimit për konsolidimin e standardeve të drejtësisë penale për të mitur, përfshirë orientimin drejt masave alternative, drejtësisë restauruese, trajtimit të diferencuar të të miturve dhe përmirësimit të praktikës së prokurorive në çështjet me të mitur.

Miratimit dhe publikimit të strategjive institucionale për komunikimin publik, transparencën dhe planifikimin afatmesëm, të cilat parashikojnë publikimin periodik të statistikave, informimin e viktimave dhe qytetarëve, si dhe përcaktimin e objektivave, masave dhe treguesve të performancës për zhvillimin institucional.

Konsolidimit të bashkëpunimit ndërkombëtar, veçanërisht me EUROJUST-in, EPPO-n dhe autoritetet gjyqësore të shteteve anëtare të Bashkimit Evropian, përmes trajtimit të rasteve ndërkufitare, pjesëmarrjes në takime koordinimi dhe përdorimit të skuadrave të përbashkëta hetimore në luftën kundër krimit të organizuar.

Kuvendi rekomandon që Prokurori i Përgjithshëm për vitin 2026 të angazhohet edhe në këto drejtime:

1. Të zgjerojë përdorimin sistematik të hetimeve financiare paralele që në fazat e hershme të procedimit penal, veçanërisht për pastrimin e parave, korrupsionin, trafikun e narkotikëve dhe veprat me përfitim të lartë pasuror.

2. Të vijojë monitorimin e veprave penale që lidhen me sigurinë rrugore dhe në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse të evidentojë nëse problematikën vijnë nga mangësi të kuadrit ligjor, nga zbatimi administrativ i normave rrugore apo nga nevoja për forcim të ndjekjes penale.



3. Të rrisë përdorimin e masave alternative të sigurimit, përfshirë garancinë pasurore, detyrimin për paraqitje, ndalimin e daljes jashtë shtetit dhe masa të tjera proporcionale për autorë ose vepra me rrezikshmëri të ulët.

4. Të vijojë zbatimin e udhëzimeve të përgjithshme në përputhje edhe me vendimet e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut (GjEDNj) për përdorimin e arrestit në burg si masë e fundit, duke siguruar që kërkesat për masa sigurimi të jenë të individualizuara, të arsyetuara dhe të mbështetura në analizë konkrete të kushteve ligjore.

5. Të krijojë një mekanizëm të brendshëm monitorimi për standardet e procesit të rregullt ligjor, veçanërisht për kohëzgjatjen e procedimeve dhe çështjet që lidhen me nenin 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj) dhe sipas standardeve të Komisionit Evropian për Eficiencën e Drejtësisë (CEPEJ).

6. Të formalizojë mekanizmin e bashkëpunimit me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë përmes nënshkrimit të një marrëveshjeje, ngritjes së një grupi pune, miratimit të një plani masash dhe përcaktimit të një kalendarit periodik për shkëmbimin e të dhënave, adresimin e problematikave dhe forcimin e integritetit të prokurorëve.

7. Të përfundojë analizën e përbashkët të Prokurorit të Përgjithshëm, Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për krimet zgjedhore të vitit 2025, duke përfshirë problematikën e konstatuara dhe rekomandime për përmirësim, duke raportuar brenda muajit shtator të vitit 2026.

8. Në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, brenda muajit tetor të vitit 2026, të informojë Kuvendin për zbatimin e amnistisë penale, duke evidentuar problematikën praktike, paqartësitë ligjore dhe praktikën gjyqësore që mund të krijohen nga zbatimi i saj, me qëllim zgjidhjen e këtyre problematikave në amnistinë e ardhshme që do të miratojë Kuvendi i Shqipërisë.

9. Të paraqesë një vlerësim për funksionimin e Policisë Gjyqësore dhe strukturave hetimore në dispozicion të prokurorisë, duke evidentuar problematikën në ndarjen e detyrave, cilësinë e veprimeve hetimore, llogaridhënien, koordinimin me Policinë e Shtetit dhe nevojën për ndryshime

ligjore, duke raportuar brenda muajit nëntor të vitit 2026.

10. Të raportojë për masat e marra për mbrojtjen e viktimave, duke përfshirë numrin e viktimave të asistuara, masat mbrojtëse të kërkuara dhe të zbatuara, rastet e referuara te shërbimet sociale, mbështetjen psikologjike dhe funksionimin e koordinatorëve të viktimave.

11. Të raportojë për ndjekjen e rekomandimeve ndërkombëtare, veçanërisht të raporteve të Bashkimit Evropian, GRECO-s dhe MONEYVAL-it.

12. Të vijojë zhvillimin e *e-PRESTO*-s, si sistem gjithëpërfshirës jo vetëm për pastrimin e parave dhe hetimet pasurore, por për të gjithë regjistrat proceduralë dhe kategoritë kryesore të veprave penale.

13. Të paraqesë propozime konkrete për zgjidhjen ligjore dhe institucionale të problematikës së arkivave të prokurorisë, përfshirë kriteret për ruajtjen, përpunimin, digjitalizimin ose asgjësimin e dosjeve, me qëllim mbrojtjen e dokumentacionit, sigurinë juridike dhe shmangien e degradimit të materialit arkivor.

14. Të kërkojë dhe të ndjekë mbështetjen buxhetore për digjitalizimin e arkivave, modernizimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve dhe përdorimin e teknologjive të reja, përfshirë inteligjencën artificiale, në funksion të rritjes së eficiencës, transparencës dhe cilësisë së administrimit të procedimeve penale.

15. Të përditësojë materialet informuese për publikun dhe palët në procedurë penale, në formate të qarta, të aksesueshme dhe të përshtatura për kategori të ndryshme qytetarësh.

16. Të integrojë trajnimet e CEPOL-it, EUROJUST-it dhe partnerëve ndërkombëtarë në planin kombëtar të trajnimit të prokurorëve dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, me vlerësim të ndikimit të tyre në praktikën hetimore.

17. Të forcojë mekanizmat e mbështetjes profesionale dhe specializimit për prokurorët e rinj, veçanërisht në prokuroritë me ngarkesë të lartë, me qëllim rritjen e cilësisë dhe uniformitetit të hetimit.

18. Të vijojë forcimin e kapaciteteve institucionale për hetimin e veprave të reja penale që lidhen me zhvillimet teknologjike, krimin kibernetik dhe përdorimin e inteligjencës artificiale, duke raportuar mbi tendencat, nevojat për specializim dhe nevojën për ndërhyrje të mundshme ligjore.



19. Të forcojë zbatimin e masave kundër korrupsionit, veçanërisht në sektorë të përcaktuar si prioritarë në Strategjitë Kombëtare Antikorrupsion, rekomandimet vjetore të Këshillit të Ministrave dhe rekomandimet e progresraportit të Bashkimit Evropian, duke raportuar në raportin vjetor me të dhëna të ndara për kallëzimet, procedimet e regjistruara, dërgimet në gjykatë, vendimet e pushimit ose mosfillimit dhe problematikat kryesore të konstatuara.

20. Në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse, të marrë masa për të forcuar ecurinë e proceseve të sekuestrimit dhe konfiskimit përfundimtar të aseteve, duke reflektuar në raportin vjetor, statistika të detajuara për kërkesat për sekuestro, vendimet gjyqësore, konfiskimet përfundimtare, vlerën e aseteve, fazën procedurale dhe pengesat praktike ose ligjore të hasura, në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

21. Të forcojë vijueshmërinë e hetimit proaktiv kundër rrjeteve të trafikut të qenieve njerëzore, me fokus të posaçëm te gratë dhe vajzat, në përputhje me rekomandimet e BE-së.

22. Të forcojë cilësinë e hetimeve dhe përfaqësimit të akuzës, duke synuar rritjen e rasteve që përfundojnë me vendime të formës së prerë, kryesisht në çështjet lidhur me pastrimin e parave, korrupsionin, trafikun e narkotikëve dhe veprat me përfitim të lartë pasuror, si dhe të marrë masa për zhvillimin e kapaciteteve dhe burimeve njerëzore për të realizuar hetime financiare dhe komplekse.

23. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe drejtuesit e prokurorive të përfundojë hartimin e metodologjisë dhe planit konkret të veprimit për reduktimin e çështjeve të prapambetura në të gjitha nivelet e sistemit të prokurorisë, brenda muajit dhjetor të vitit 2026.

24. Të forcojë monitorimin e zbatimit të standardeve të procesit të rregullt ligjor, veçanërisht lidhur me kohëzgjatjen e procedimeve, cilësinë e akteve procedurale, arsyetimin e vendimmarrjes dhe respektimin e të drejtave të palëve, në përputhje me Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, jurisprudencën e GjEDNJ-së dhe me standardet e CEPEJ-it.

25. Të forcojë dhe institucionalizojë bashkëpunimin me Autoritetin e Mediave Audiovizive, Autoritetin e Komunikimeve Elektronike dhe Postare, Policinë e Shtetit, Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorinë e

Përgjithshme të Doganave, Drejtorinë e të Drejtës së Autorit dhe Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut përmes nënshkrimit të një memorandum bashkëpunimi, me qëllim rritjen e koordinimit për parandalimin, hetimin dhe ndjekjen penale të veprimtarive të lidhura me piraterinë digjitale, mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale dhe forcimin e sigurisë në hapësirën digjitale, si dhe të informojë Kuvendin për masat e ndërmarra për zbatimin e këtij rekomandimi.

26. Të forcojë masat për të vijuar ndjekjen e referimeve penale ndaj magistratëve të dyshuar për vepra penale të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Të përgatisë një raport të detajuar për zbatimin e këtij rekomandimi me të dhëna konkrete për çështjet e kallëzuara, çështjet e nisura kryesisht, çështjet e dërguara në gjykatë dhe vendimet gjyqësore, brenda muajit dhjetor të vitit 2026.

27. Të monitorojë zbatimin efektiv të masave dhe garancive në mbrojtje të gazetarëve dhe punonjësve të medias nëpërmjet pikave të caktuara të kontaktit pranë zyrave të prokurorive dhe të Policisë së Shtetit.

28. Të miratojë dhe publikojë protokolle ose udhëzime të standardizuara për metodologjinë e hetimit, veçanërisht për marrjen e provave dhe masat e sigurimit, në përputhje me vendimet njësuere të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese dhe vendimet e GjEDNJ-së.

29. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

30. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe të publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

Faqe | 16749



REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË STRUKTURËS SË POSAÇME KUNDËR KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026**Kuvendi i Shqipërisë,**

Duke konsideruar tejet të rëndësishëm misionin kushtetues të Prokurorisë së Posaçme në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar;

Duke njohur, respektuar dhe mbështetur pavarësinë ligjore dhe institucionale të institucionit të SPAK-ut (Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit);

Duke vlerësuar rolin e saj të rëndësishëm në ushtrimin e ndjekjes penale, hetimin dhe përfaqësimin e akuzës në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Gjykatës së Lartë;

Duke vlerësuar angazhimin dhe rezultatet e arritura nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit gjatë vitit 2025, në përmbushje të përgjegjësisë së tyre kushtetuese dhe ligjore dhe në zbatim të rekomandimeve të Kuvendit të Shqipërisë;

Duke marrë në konsideratë rritjen e besimit të publikut dhe të partnerëve ndërkombëtarë, si dhe vlerësimet pozitive të shprehura për veprimtarinë e këtij institucioni nga BE-ja edhe në kuadrin e anëtarësimit të vendit në BE,

Në vlerësim të raportit të paraqitur për veprimtarinë e Strukturës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për vitin 2025, në përmbushje të rekomandimeve të dhëna dhe debatit të zhvilluar rreth tij konstaton:

Bashkëpunimi ndërkombëtar: Gjatë vitit 2025 është konsoliduar më tej bashkëpunimi ndërkombëtar me partnerë si Eurojust, Europol, Interpol, autoritetet e SHBA-së dhe strukturat homologe rajonale dhe ndërkontinentale. Ky bashkëpunim është reflektuar në rritjen me 35.7% të kërkesave për ndihmë juridike ndërkombëtare, nga 70% në vitin 2024 në 95% në vitin 2025, ndërkohë që 63 prej tyre ose 66.3% janë ekzekutuar brenda

vitit raportues, duke treguar përmirësim të efektivitetit në ndërveprimin ndërkufitar.

Kuadri strategjik dhe zhvillimi institucional: Në planin strategjik ka vijuar zbatimi i prioriteteve përmes miratimit të dokumenteve, si Strategjia për Uljen e Numrit të Çështjeve të Prapambetura dhe Strategjia e Komunikimit 2025–2028, si dhe akteve nënligjore që rregullojnë procese të rëndësishme institucionale, përfshirë përzgjedhjen e drejtorit të BKH-së. Njëkohësisht, janë hartuar një sërë instrumentesh të reja që pritet të finalizohen gjatë vitit 2026, duke përfshirë udhëzime për qarkullimin e dosjeve, komunikimin në krizë, financimin e terrorizmit dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke reflektuar përpjekje për standardizim dhe rritje të kapaciteteve administrative.

Volumi i hetimeve dhe performanca procedurale: Në vitin 2025 janë trajtuar gjithsej 871 procedime penale, nga të cilat 294 janë procedime të reja, 577 të mbartura nga viti 2024 dhe 39 janë bashkuar gjatë procesit. Krahasuar me vitin 2024, kur ishin trajtuar 793 procedime, evidentohet një rritje e volumit të hetimeve me rreth 4.9%. Numri i çështjeve të përfunduara ka mbetur i qëndrueshëm në 216, ndërsa raporti midis procedimeve të reja dhe atyre të përfunduara është përmirësuar me rreth 6.67%. Megjithëse numri i çështjeve të dërguara në gjykatë ka rënë me 19.5%, numri i personave të përfshirë në këto çështje është rritur me 13.5%, duke reflektuar një orientim drejt hetimeve më komplekse dhe me përfshirje më të gjerë.

Konsolidimi i juridiksionit dhe qasja proaktive: Gjatë vitit 2025 rreth 29% e çështjeve të përfunduara janë transferuar në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm, duke shënuar një rënie të ndjeshme krahasuar me periudhën 2021–2024 dhe duke reflektuar konsolidimin e kompetencave. Njëkohësisht, është rritur ndjeshëm qasja proaktive, pasi 109 nga 294 procedime të reja ose rreth 37% janë nisur kryesisht krahasuar me vetëm 19.8% në vitin 2024. Ky zhvillim është mbështetur nga aksesit në 22 databaza shtetërore, përfshirë 3 të reja të cilat kanë përmirësuar ndjeshëm eficiencën hetimore.

Lufta kundër krimit të organizuar: Në luftën kundër krimit të organizuar është vijuar përmirësimi i performancës, ku numri i çështjeve të përfunduara është rritur me 3.4%, nga 58 në vitin 2024 në 60 në vitin 2025. Gjithashtu, është evidentuar një rritje prej 11.5% e personave në hetim dhe 36.6% e personave të dërguar në gjykatë, duke reflektuar një fokus më



të madh në struktura kriminale më të gjera. Nga ana tjetër, çështjet e dërguara në gjykatë kanë rënë me 14.3%, ndërsa pezullimet janë rritur ndjeshëm me 93.7%, çka tregon kompleksitetin në rritje të hetimeve dhe sfidat procedurale që shoqërojnë këto çështje.

Lufta kundër korrupsionit: Në këtë fushë është shënuar rritje e aktivitetit me një shtim prej 17.7% të çështjeve të reja dhe 12.2% të çështjeve të përfunduara. Gjatë vitit 2025 janë dërguar në gjykatë 24 procedime me 147 të pandehur për korrupsion jo të nivelit të lartë dhe 10 procedime me 13 të pandehur për korrupsion të nivelit të lartë. Për sa u përket zyrtarëve të lartë, janë regjistruar 6 procedime të reja me 16 persona nën hetim, ndërsa nga 30 zyrtarë dhe ish-zyrtarë në hetim, 18 prej tyre ose mbi 50% janë dërguar në gjykatë dhe 10 janë dënua me vendim të formës së prerë.

Besimi publik dhe burimet e kallëzimeve: Të dhënat tregojnë një nivel të konsiderueshëm të besimit publik, ku rreth 33.5% e procedimeve janë nisur mbi bazën e kallëzimeve të qytetarëve. Njëkohësisht, referimet nga Policia e Shtetit janë rritur me rreth 70% dhe nga institucionet publike me rreth 15%, ndërsa kallëzimet nga subjektet politike dhe personat juridikë kanë pësuar rënie përkatësisht me 50% dhe 75%.

Politika penale dhe masat e sigurimit: Është ndjekur një politikë penale më e moderuar, duke reduktuar përdorimin e masës “arrest me burg” me rreth 53.4% dhe duke u orientuar drejt masave alternative. Në vitin 2025 të paraburgosurit përbëjnë rreth 12% të totalit, ndërsa të dënuarit rreth 11%. Për veprat e korrupsionit arresti me burg përbën vetëm 3.45% të personave në hetim kundrejt 5% në vitin 2024, ndërsa për krimin e organizuar kjo masë është ulur nga rreth 31% në 21.4%.

Efektiviteti në gjykim: Efektiviteti në gjykim ka mbetur i qëndrueshëm, me një rritje prej 5.5% të vendimeve të GJKKO-së krahasuar me vitin 2024. Vendimet e fajësisë përbëjnë rreth 87% të totalit, ndërsa ato të pafajësisë rreth 13%. Gjithashtu, numri i rekurseve në Gjykatën e Lartë është ulur ndjeshëm me rreth 63%, ndërsa janë dhënë 59 vendime nga Gjykata e Lartë dhe 1 nga Gjykata Kushtetuese.

Kapacitetet teknike dhe ekspertiza: Gjatë periudhës 2022–2025, Sektori i Ekspertizës ka shënuar një rritje me rreth 31% të akteve të ekspertimit, duke reflektuar zgjerimin e kapaciteteve teknike. Telefonat celularë përbëjnë rreth 70–75% të

provave të analizuara, ndërsa analizat mbi pajisjet kompjuterike janë rritur me rreth 62%, duke treguar rritjen e rëndësisë së provave digjitale.

Digjitalizimi dhe menaxhimi i çështjeve: Është konsoliduar Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve, duke përmirësuar ndjeshëm efikasitetin e proceseve hetimore dhe raportimin statistikor. Modulet kryesore janë funksionale, ndërsa për vitin 2026 parashikohet zgjerimi i mëtejshëm i sistemit për ndërveprim të plotë me proceset procedurale.

Burimet njerëzore dhe zhvillimi profesional: Në vitin 2025 struktura ka funksionuar me 124 punonjës, përfshirë 20 prokurorë, 12 hetues financiarë dhe 92 punonjës administrativë. Janë ndërmarrë hapa për përf forcimin e kapaciteteve përmes rekrutimit të 4 hetuesve financiarë dhe zhvillimit të rreth 58 temave trajnuese për stafin.

Raportimi dhe koordinimi institucional: Është zhvilluar një volum i lartë raportimi në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, përfshirë kontributin në proceset e MONEYVAL-it, FATF-së dhe raportimet për BE-në. Nga 914 kërkesa të ardhura nga institucionet shtetërore rreth 97% kanë marrë përgjigje.

Integriteti dhe kontrolli i brendshëm: Gjatë vitit 2025 janë verifikuar 49 kandidatë për personel administrativ dhe 7 kandidatë për drejtues të BKH-së, ndërsa vijnë verifikimet për 46 të tjerë. Në total, 151 zyrtarë kanë qenë subjekt i deklarimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit, duke reflektuar zbatimin e standardeve ligjore.

Transparenca dhe komunikimi publik: Është forcuar transparenca përmes publikimit të 114 njoftimeve për shtyp dhe trajtimit të 170 kërkesave për informacion. Numri i vizitorëve unikë në faqen zyrtare është rritur me 32.3%, nga 82,766 në 109,496, ndërsa shikimet janë rritur me 28.7%, nga 437,882 në 563,453.

Zhvillimet në BKH: Gjatë vitit 2025 janë shënuar përparime në forcimin e kapaciteteve, përfshirë përzgjedhjen e drejtuesit të ri, rritjen e aksesit në databaza me 22 kombëtare dhe 3 të huaja, si dhe pjesëmarrjen në platformën EMPACT. Gjithashtu, janë ndërmarrë procedura për rekrutimin e 10 oficerëve të policisë gjyqësore dhe forcimin e strukturave të reja operative.

Kuvendi rekomandon që Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar për vitin 2026 të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:



1. Rritjen e efektivitetit në finalizimin e çështjeve të hetuara përmes orientimit të burimeve njerëzore dhe procedurale drejt reduktimit të stokut të çështjeve të mbartura, me fokus të veçantë te procedimet e regjistruara në vitet e mëparshme dhe te çështjet me kohëzgjatje të lartë hetimi.

2. Forcimin e kapaciteteve për hetime financiare dhe pasurore paralele, në mënyrë që hetimi i korrupsionit dhe krimit të organizuar të shoqërohet në mënyrë sistematike me identifikimin, gjurmimin, sekuestrimin dhe konfiskimin përfundimtar të produkteve të veprës penale.

3. Reduktimin e hendekut ndërmjet sekuestrimeve dhe konfiskimeve përmes ndjekjes më të plotë gjyqësore të masave pasurore, rritjes së cilësisë së provueshmërisë financiare dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për administrimin, gjurmimin dhe rikuperimin e pasurive kriminale.

4. Rritjen e fokusit në konfiskimin e pasurive në çështjet e korrupsionit, veçanërisht në nivelet e larta të administratës publike, me qëllim që ndjekja penale të mos kufizohet vetëm në përgjegjësinë individuale, por të prodhojë edhe goditje reale të përfitimit ekonomik të paligjshëm.

5. Përmirësimin e raportit ndërmjet volumit të hetimeve dhe rezultateve përfundimtare në gjykim përmes rritjes së cilësisë së dosjeve të dërguara për gjykim dhe forcimit të standardeve të provueshmërisë, me qëllim shmangien e kthimit të akteve për plotësim hetimesh apo refuzimit të marrëveshjeve procedurale.

6. Vijimin e konsolidimit të rezultateve në hetimin dhe ndjekjen penale të çështjeve të korrupsionit dhe krimit të organizuar, me synim rritjen e numrit të procedimeve që përfundojnë me vendime gjyqësore të formës së prerë, me fokus të posaçëm te korrupsioni i nivelit të lartë, pastrimi i parave, trafikimi i narkotikëve dhe veprat penale të kryera në kuadër të grupeve të strukturuar kriminale. Në këtë kuadër, të intensifikojë goditjen e të gjitha hallkave të veprimtarisë kriminale, përfshirë organizatorët, drejtuesit, financuesit, bashkëpunëtorët dhe përfituesit e saj, si dhe të forcojë hetimet financiare dhe pasurore, me synim konfiskimin e produkteve dhe përfitimeve të veprës penale dhe dobësimin e kapaciteteve financiare, logjistike dhe operative të organizatave kriminale.

7. Përmirësimin e cilësisë dhe koherencës së të dhënave statistikore institucionale, në mënyrë që

raportimi për masat e sigurimit, personat nën hetim, çështjet e përfunduara, sekuestrimet, konfiskimet dhe vendimet përfundimtare të jetë i unifikuar, i plotë dhe i krahasueshëm ndër vite.

8. Rishikimin e praktikës së përdorimit të masave të sigurimit personal, me qëllim garantimin e respektimit të parimit të proporcionalitetit, shmangien e zgjatjes së panevojshme të paraburgimit dhe rritjen e përdorimit të masave alternative, në përputhje me standardet evropiane të të drejtave të njeriut.

9. Analizimin çdo 4 muaj të kohëzgjatjes së paraburgimit dhe raportit të tij me dënimet përfundimtare, me qëllim evidentimin e rasteve kur koha e qëndrimit në paraburgim afrohet ose mbulon në mënyrë substanciale dënimin përfundimtar, si dhe marrjen e masave për shmangien e kësaj praktike.

10. Forcimin e monitorimit të praktikës ndëshkimore në gjykim, përfshirë analizimin çdo 6 muaj të masës së dënimeve të dhëna, përdorimit të dënimeve alternative, rasteve të pafajësisë dhe raportit ndërmjet kërkesave të prokurorisë dhe vendimmarrjes përfundimtare të gjykatave.

11. Zhvillimin e analizave periodike për efektivitetin e ndjekjes penale në çështjet ku përfshihen zyrtarë dhe ish-zyrtarë të lartë, përfshirë jo vetëm numrin e procedimeve dhe personave të dërguar në gjykatë, por edhe shkallën e konfiskimit të pasurive, masën e dënimeve dhe kohëzgjatjen e procedimeve.

12. Rritjen e referimeve proaktive nga institucionet publike dhe agjencitë ligjzbatuese përmes mekanizmave më efektivë të bashkëpunimit ndërinstitucional, shkëmbimit në kohë të informacionit dhe rritjes së përgjegjshmërisë së strukturave publike për referimin e rasteve të dyshuara të korrupsionit dhe kriminalitetit të organizuar.

13. Forcimin e kapaciteteve të brendshme analitike dhe hetimore përmes plotësimit të vakancave, përsheptimit të rekrutimit të hetuesve financiarë, hetuesve të BKH-së dhe oficerëve të Policisë Gjyqësore, si dhe shpërndarjes më të balancuar të ngarkesës së punës ndërmjet strukturave përkatëse.

14. Vijimin e zbatimit të Strategjisë për Reduktimin e Çështjeve të Mbartura 2025–2027, duke e shoqëruar atë me tregues të matshëm të performancës, raportim periodik për ecurinë e saj



dhe monitorim të rregullt të rezultateve konkrete në uljen e *backlog*-ut.

15. Thellimin e përdorimit sistematik të hetimeve financiare në trajtimin e krimit të rëndë dhe të organizuar, përfshirë trafikimin e narkotikëve, terrorizmin, pastrimin e parave dhe korrupsionin, në përputhje me rekomandimet e Komisionit Evropian, MONEYVAL-it dhe partnerëve ndërkombëtarë.

16. Rritjen e efikasitetit të bashkëpunimit ndërkombëtar përmes forcimit të mëtejshëm të hetimeve të përbashkëta, kërkesave për ndihmë juridike, gjurmimit ndërkufitar të pasurive dhe bashkëpunimit operacional me Eurojust-in, Europol-in, OLAF-in dhe autoritetet homologe të vendeve partnere.

17. Përmirësimin e transparencës institucionale dhe llogaridhënies publike përmes publikimit të plotë të kategorive të informacionit të parashikuara në Programin e Transparencës, përfshirë raportet e monitorimit dhe auditimit, strukturën e pagave dhe të dhënat për prokurimet publike.

18. Vijimin e konsolidimit të Sistemit Elektronik të Menaxhimit të Çështjeve, në mënyrë që ai të përdoret plotësisht jo vetëm për administrimin procedural të dosjeve, por edhe për raportim statistik në kohë reale, analizë të performancës dhe identifikim më të shpejtë të problematikave strukturore.

19. Forcimin e masave për mbrojtjen e pavarësisë funksionale të institucionit dhe të personelit të tij përmes rritjes së garancive të sigurisë, reagimit institucional ndaj çdo forme presioni të jashtëm dhe koordinimit të ngushtë me institucionet përgjegjëse për sigurinë e prokurorëve, hetuesve dhe stafit mbështetës.

20. Paraqitjen pranë Kuvendit brenda muajit dhjetor të vitit 2026 të një analize të detajuar për periudhën 2022–2025 për funksionimin e mekanizmave të bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Posaçme dhe prokurorive të juridiksionit të përgjithshëm, duke përfshirë natyrën dhe arsyet e transferimit të çështjeve ndërmjet tyre, problematikat e evidentuara në zbatimin e kompetencës lëndore, si dhe propozime konkrete për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe procedural.

21. Forcimin e komponentin analitik të raportimit vjetor, duke paraqitur, krahas të dhënave statistikore, tregues të matshëm për cilësinë dhe efektivitetin e veprimtarisë hetimore, përfshirë

kohëzgjatjen mesatare të hetimeve sipas kategorive të çështjeve, analizën e shkaqeve të pafajësive dhe ndryshimeve të vendimmarrjes në shkallët e gjykimit, raportin ndërmjet pasurive të sekuestruara dhe atyre të konfiskuara, arsyet e transferimit ose kthimit të çështjeve për kompetencë, si dhe analizën e faktorëve që kanë ndikuar në procedimet që nuk kanë prodhuar rezultatet e pritshme, me qëllim identifikimin e masave konkrete për përmirësimin e performancës institucionale.

22. Përfundimin e analizës së përbashkët me Prokurorin e Përgjithshëm dhe Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krimet zgjedhore të vitit 2025, duke përfshirë problematikat e konstatuara dhe rekomandime të mundshme.

23. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë të Prokurorisë të analizojë në përputhje me rekomandimin e BE-së, nevojën për rishikim të rregullave dhe procedurave lidhur me procesin e emërimit të Drejtorit të Byrosë Kombëtare të Hetimit, për të qartësuar dhe garantuar procese të hapura, konkurruese dhe pa vonesa.

24. Forcimin e transparencës, duke marrë masa për t'i bërë të verifikueshme procedurat e marrjes në pyetje nëpërmjet përdorimit të ambienteve të posaçme.

25. Përmirësimin e teknikave të hetimit financiar, duke përfshirë edhe ato që lidhen me identifikimin, analizën dhe ruajtjen e provës elektronike lidhur me kriptovalutat dhe asetet virtuale.

26. Forcimin e qasjes strategjike dhe sistematike për identifikimin dhe konfiskimin e aseteve me origjinë kriminale jashtë kufijve, si dhe të marrë masa për zbatimin e vazhdueshëm të rregullave për konfiskimin dhe ngrirjen e aseteve për të shmangur humbjen e vlerës së tyre ekonomike.

27. Përfundimin dhe miratimin e analizës strategjike për grupet e krimit të organizuar që janë aktive brenda dhe jashtë vendit, si dhe raportimin në Kuvend të gjetjeve kryesore dhe masat konkrete të thellimit të luftës kundër tyre.

28. Përfundimin e analizës për masat e sigurimit, të ndërmarra gjatë periudhës 2021–2025, duke evidentuar në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara dhe masat konkrete të propozuara në përputhje me standardet e KiE, BE-së, GJEDNJ-së, Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë.

29. Miratimin dhe publikimin e protokolleve ose udhëzimeve të standardizuara për metodologjinë e hetimit, veçanërisht për marrjen e provave dhe



masat e sigurimit, në përputhje me vendimet njësuere të Gjykatës së Lartë, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, si dhe vendimet e GJEDNJ-së.

30. Forcimin e hetimit proaktiv dhe të plotë, veçanërisht për çështjet me interes të lartë publik, në përputhje me vendimmarrjen e GJEDNJ-së dhe Gjykatës së Lartë, për standardet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

31. Bashkëpunimin me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të katërt të vitit 2026.

32. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe të publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AVOKATIT TË POPULLIT PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke njohur rolin kyç të parimit të barazisë para ligjit në një shoqëri demokratike, ku të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi duhet të respektohen;

Në mbështetje të mandatit kushtetues të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, si dhe të interesave të ligjshëm të njeriut nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike;

Duke marrë në konsideratë angazhimin e Avokatit të Popullit për të kryer funksionin e tij në përputhje me legjislacionin kombëtar dhe atë

ndërkombëtar, veçanërisht Parimet e Parisit dhe të Komisionit të Venecias,

Vlerëson veprimtarinë e Avokatit të Popullit për vitin 2025, në drejtim të:

Ushttrimin efektiv të funksionit kushtetues për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës publike, reflektuar në një volum të lartë trajtimi të çështjeve individuale me 1593 ankesa të regjistruara dhe 1911 raste hetimi.

Ushttrimin aktiv të kompetencës hetimore me nismë, shprehur në 214 raste hetimi në nivel kombëtar.

Funksionimin efektiv të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës me 78 inspektime, 83 rekomandime dhe realizim të plotë të objektivave të planifikuar.

Ushttrimin aktiv të kompetencës për dhënien e rekomandimeve organeve të administratës publike përmes adresimit të 309 rekomandimeve formale gjatë vitit 2025.

Trajtimin të çështjeve të pronësisë me theks te mangësitë institucionale dhe procedurale që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve publike, si dhe adresimit të rekomandimeve konkrete ndaj institucioneve përgjegjëse.

Hapave të ndërmarrë për digjitalizimin e shërbimeve përmes përgatitjes së një platforme elektronike për menaxhimin e rasteve.

Zgjerimit të pranisë institucionale në territor dhe rritjes së ndjeshme të aksesit të qytetarëve.

Vendosjes së standardit të ri të transparencës pas ndryshimeve ligjore në hartimin e raportit vjetor, përfshirë publikimin paraprak të tij dhe konsultimin me shoqërinë civile dhe grupet e interesit.

Angazhimit në monitorimin e institucioneve të kufizimit të lirisë, evidentimin e problematikave dhe dhënien e rekomandimeve konkrete institucioneve përgjegjëse.

Kuvendi rekomandon që Avokati i Popullit për vitin 2026, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të rritet cilësia dhe të konkretizohen propozimet për ndryshime të nevojshme përmes rekomandimeve të strukturuar ligjore, si dhe të krijohet një mekanizëm i brendshëm për monitorimin e ndikimit të rekomandimeve pas miratimit të tyre.

2. Të hartohet dhe të paraqitet në Kuvend një metodologji e standardizuar për matjen e ndikimit të ndërhyrjeve korrigjuese të institucionit të Avokatit të



Popullit për zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut në vend, e cila të adresojë edhe zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit, duke përfshirë indikatorë të qartë të nivelit të zbatimit dhe verifikim në terren për rastet prioritare. Të dhënat të jenë të publikuara në faqen zyrtare të institucionit, ku të jepet informacion për një periudhë të paktën 3-vjeçare. Metodologjia të përfshijë raportim periodik të detyrueshëm nga institucioni përpara komisioneve përgjegjëse në Kuvend për rekomandimet e pashqyrtuara, të pazbatuara ose që nuk kanë marrë përgjigje.

3. Të angazhohet për finalizimin e Planit Strategjik 2026–2030 dhe planit të veprimit, duke përcaktuar objektiva të matshëm dhe indikatorë performance.

4. Të zgjerohet dhe formalizohet puna në terren përmes vijimit të inspektimeve periodike, ditëve të hapura, monitorimeve, takimeve komunitare, me fokus te grupet vulnerabël, duke realizuar një program të strukturuar vjetor me planifikim territorial dhe indikatorë ndikimi për secilin prej seksioneve të institucionit.

5. Të përgatitet një raport të veçantë për nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga Komiteti i Parandalimit të Torturës (CPT) në raportin periodik të vitit 2024, me fokus në evidentimin e masave të marra apo mangësive që duhen adresuar për garantimin efektiv të zbatimit të Konventës për Parandalimin e Torturës dhe Dënimeve ose Trajtimeve Çnjerëzore ose Poshtëruese.

6. Të vijojë punën për monitorimin dhe raportimin e fenomenit të dhunës dhe vrasjes së grave, duke evidentuar në vijimësi nevojat për ndërhyrje me qëllim përmirësimin e reagimit institucional.

7. Të raportojë në mënyrë periodike dhe analitike gjatë vitit në Kuvend për rekomandimet me nivel të ulët zbatimi, duke identifikuar fushat problematike dhe institucionet përgjegjëse me performancën më të dobët në zbatim.

8. Të marrë masa për forcimin e angazhimit për çështjet që kanë të bëjnë me sistemin penitenciar në përputhje me standardet e BE-së.

9. Të vijojë angazhimin për realizimin me sukses të procesit të riakreditimit të institucionit me status “A” në përputhje me Parimet e Parisit, duke identifikuar dhe paraqitur në Kuvend nevojat për përmbushjen e standardeve të kërkuara, me qëllim sigurimin e mbështetjes së nevojshme institucionale,

si dhe të raportojë periodikisht për ecurinë e këtij procesi.

10. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo 4 muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

11. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës së Kuvendit, në funksion të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të tretë të këtij viti.

12. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës të hartojë dhe të publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar rolin kushtetues të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si autoriteti shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe fillimin e procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe për inspektimin institucional të gjykatave dhe zyrave të prokurorisë;

Duke mbajtur parasysh kontributin e institucionit në konsolidimin e mekanizmave të inspektimit, procedimit disiplinor dhe llogaridhënies në sistemin e drejtësisë, si pjesë e procesit të



reformës në drejtësi dhe forcimit të shtetit të së drejtës;

Duke nënvizuar rolin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në hetimin e shkeljeve të dyshuara nëpërmjet shqyrtimit të ankesave të paraqitura nga personat fizikë ose juridikë, si dhe kryesisht mbi bazën e të dhënave publike dhe atyre të siguruara gjatë inspektimeve institucionale dhe tematike;

Duke vlerësuar progresin e institucionit në zhvillimin e kapaciteteve monitoruese, analitike, statistikore dhe teknologjike, si dhe në forcimin e transparencës, komunikimit institucional dhe orientimin e veprimtarisë drejt identifikimit të problematikave sistemike dhe analizës së riskut;

Duke çmuar rëndësinë e bashkëpunimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorin e Përgjithshëm, Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet e tjera relevante në funksion të koordinimit institucional, shkëmbimit të informacionit dhe përmbushjes së detyrave funksionale;

Duke vlerësuar kontributin e institucionit në përmbushjen e standardeve të sundimit të ligjit, forcimin e përgjegjshmërisë institucionale dhe avancimin e prioriteteve të procesit të integritetit evropian,

Vlerëson veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë vitit 2025, në këto drejtime:

Trajtimin e 1792 ankesave të reja, 1480 ankesave të mbartura, 3272 ankesave objekt shqyrtimi, 1635 ankesave të trajtuara dhe 1637 ankesave të mbartura për vitin 2026; si dhe dhënien e 12 vendimeve për fillimin e hetimit ndaj 13 magistratëve, 23 hetime të përfunduara ndaj 25 magistratëve, 8 kërkesa për procedim disiplinor, 7 inspektime tematike dhe 75 rekomandime.

Konsolidimin gradual të funksioneve kushtetuese dhe institucionale të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke forcuar komponentin monitorues, diagnostikues dhe analitik të veprimtarisë së institucionit, në funksion të rritjes së standardeve të përgjegjshmërisë dhe besimit publik në sistemin e drejtësisë.

Rritjen e aktivitetit institucional dhe volumit të punës, duke evidentuar njëkohësisht çështjet e prapambetura dhe kohëzgjatjen e trajtimit të ankesave si sfida kryesore.

Orientimin e veprimtarisë së institucionit drejt një qasjeje më strategjike, të bazuar në analizën e riskut, monitorimin e performancës dhe evidentimin e problematikave sistemike, duke kontribuar në rritjen e efektivitetit institucional dhe përmirësimin e mekanizmave të mbikëqyrjes dhe llogaridhënies.

Përpjekjet për forcimin e mekanizmave të monitorimit të performancës institucionale dhe vlerësimit të efektivitetit të rekomandimeve dhe masave të ndërmarra, me synim garantimin e rezultateve të qëndrueshme dhe të matshme në funksionimin e sistemit të drejtësisë.

Zhvillimin e kapaciteteve njerëzore, administrative, teknologjike dhe analitike të institucionit, si një parakusht për ushtrimin efektiv dhe në kohë të funksioneve kushtetuese dhe ligjore të tij, veçanërisht lidhur me sfidën strukturore të plotësimit të vakancave dhe ndikimit në veprimtarinë e institucionit.

Forcimin e mekanizmave të transparencës, raportimit institucional dhe komunikimit me publikun, duke kontribuar në rritjen e besimit të qytetarëve te mekanizmat e përgjegjshmërisë dhe integritetit në sistemin e drejtësisë.

Zhvillimin e instrumenteve të matjes së impaktit institucional të rekomandimeve dhe masave disiplinore, monitorimit të performancës, analizës statistikore, gjurmueshmërisë së rekomandimeve, analizës së riskut, administrimit elektronik të proceseve institucionale dhe bashkëpunimit ndërinstitutional.

Kontributin e institucionit në konsolidimin e reformës në drejtësi, forcimin e mekanizmave të përgjegjshmërisë dhe avancimin e standardeve të sundimit të ligjit, në përputhje me interesin publik dhe prioritetet e procesit të integritetit evropian.

Kuvendi i Shqipërisë rekomandon që Inspektori i Lartë i Drejtësisë për vitin 2026, të angazhohet veçanërisht edhe në këto drejtime:

1. Të vijojë zhvillimin e kapaciteteve institucionale, administrative, teknike dhe njerëzore, në funksion të ushtrimit efektiv, cilësor dhe në kohë të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të institucionit.

2. Të zhvillojë më tej sistemin e matjes së performancës institucionale nëpërmjet përcaktimit dhe publikimit të treguesve objektivë të performancës, përfshirë kohën mesatare të shqyrtimit të ankesave, normën e përfundimit të



procedimeve, nivelin e reduktimit të stokut të çështjeve të trashëguara dhe efektivitetin e rekomandimeve e masave të ndërmarra.

3. Të konsolidojë metodologjitë e inspektimit, të bazuara në analizën e riskut dhe priorizimin institucional, me synim identifikimin e hershëm të problematikave sistemike, përmirësimin e cilësisë së mbikëqyrjes dhe rritjen e efektivitetit të procedimeve disiplinore.

4. Të vijojë zhvillimin dhe funksionalizimin e sistemeve elektronike të administrimit të ankesave dhe proceseve institucionale, duke mundësuar gjurmueshmërinë në kohë reale të procedimeve dhe rritjen e ndërveprimit elektronik me institucionet e sistemit të drejtësisë, në funksion të rritjes së efikasitetit, transparencës dhe sigurisë juridike.

5. Të forcojë kapacitetet analitike dhe statistikore të institucionit, si dhe të publikojë periodikisht raporte analitike për trendet e ankesave, problematikat me karakter sistematik, praktikën disiplinore dhe ndikimin e masave të ndërmarra, me qëllim mbështetjen e funksionit parandalues dhe promovimin e një praktike të qëndrueshme.

6. Të vijojë forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Prokurorinë e Përgjithshme, Shkollën e Magjistraturës dhe institucionet e tjera relevante, në funksion të identifikimit të problematikave sistemike, shkëmbimit të praktikave më të mira dhe koordinimit të masave parandaluese. Gjithashtu, të finalizojë protokollin e bashkëpunimit ndërinstitucional me Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Prokurorinë e Përgjithshme, lidhur me aksesin në sistemet elektronike të gjykatave dhe prokurorive.

7. Të zhvillojë më tej analizën e praktikës disiplinore, me synim garantimin e një praktike të qëndrueshme, të unifikuar dhe të parashikueshme në përputhje me parimin e sigurisë juridike dhe standardet e shtetit të së drejtës.

8. Të vijojë zhvillimin e veprimtarisë ndërgjegjësuere dhe komunikimit institucional me publikun, si dhe të rrisë transparencën institucionale nëpërmjet publikimit periodik të statistikave të detajuara dhe vendimeve të përmbledhura, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale.

9. Të vijojë harmonizimin e praktikës institucionale me standardet dhe rekomandimet e

Bashkimit Evropian dhe organizmave ndërkombëtarë në fushën e pavarësisë, përgjegjshmërisë, integritetit dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.

10. Në raportin vjetor të paraqitur Kuvendit, krahas të dhënave statistikore, të përfshijë analiza për problematikat strukturore, tendencat e veprimtarisë, efektivitetin e masave të ndërmarra, si dhe, kur është e nevojshme, propozime konkrete për përmirësime ligjore, institucionale ose administrative në funksion të forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit.

11. Të ndërmarrë një rol më aktiv, përshirë nëpërmjet iniciativës për çështjet me natyrë disiplinore, bazuar në të dhëna dhe fakte publike. Për kërkesat për procedim disiplinor të raportojë periodikisht për vendimmarrjen e Këshillave dhe problematikat e evidentuara.

12. Të hartojë një matricë të standardizuar me të dhëna për rekomandimet e dhëna, institucionin përgjegjës, afatet, statusin dhe evidencën e zbatimit, si dhe rezultatin e arritur.

13. Në përputhje me rekomandimet e BE-së, të trajtojë me prioritet rastet që lidhen me korrupsionin në sistemin gjyqësor dhe të prokurorisë, duke hartuar një plan koordinimi me institucionet përgjegjëse për ndjekjen e tyre.

14. Të përfshijë në inspektimet prioritare performancën e prokurorëve, lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Kuvendit, marrëdhënien profesionale me drejtuesit e prokurorive, si dhe me cilësinë e akteve hetimore të prodhuara nga OPGJ-të në funksion të procedimit penal.

15. Të ndërmarrë masa për reduktimin e kohëzgjatjes së verifikimit dhe shqyrtimit të ankesave, duke shmangur vonesat e paarsyeshme që ulin ndjeshëm efektivitetin e mekanizmit të verifikimit, si dhe të raportojë periodikisht për afatet e shqyrtimit, stokun e ankesave të mbartura dhe shkaqet e vonesave në trajtimin e tyre, duke vendosur standarde të brendshme për respektimin e afateve të arsyeshme dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të tyre.

16. Të adresojë me efektivitet hendeun mes numrit shumë të lartë të ankesave të qytetarëve përkundrejt numrit shumë të ulët të procedimeve disiplinore, për të përmbushur cilësisht standardet e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor dhe të prokurorisë.



17. Të marrë masa për të përmirësuar cilësinë dhe arsyetimin e përgjigjeve institucionale ndaj ankesave, duke shmangur komunikimet formale ose adresime jo të plota të pretendimeve të ngritura, me qëllim rritjen e besimit të publikut në veprimtarinë e institucionit.

18. Të miratojë dhe zbatojë një metodologji të unifikuar për mbledhjen, përpunimin dhe raportimin e të dhënave statistikore, në funksion të forcimit të kapaciteteve analitike dhe statistikore të institucionit.

19. Të formulojë dhe të paraqesë propozime për ndërhyrje të nevojshme ligjore, lidhur me përmbushjen e detyrimit për të plotësuar vakancat në institucion.

20. Të forcojë dialogun dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, lidhur me inspektimet tematike, si dhe në funksion të adresimit të rekomandimeve dhe të sfidave sistematike. Të forcojë dhe institucionalizojë dialogun dhe konsultimet me Dhomën Kombëtare të Avokatisë dhe organizatat e shoqërisë civile që veprojnë në fushën e drejtësisë dhe të të drejtave të njeriut, në funksion të përmirësimit të veprimit institucional.

21. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për shkëmbimin e informacionit për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare, brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

22. Brenda 30 ditëve nga miratimi i rezolutës, të hartojë dhe të publikojë një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve, i cili të përcaktojë masat konkrete, afatet e realizimit, strukturat përgjegjëse, treguesit bazë dhe objektivat e synuar, si dhe të raportojë periodikisht për nivelin e përmbushjes së tyre.

Miraturar në datën 23.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 6, datë 17.7.2026

PËR MIRATIMIN E PROCEDURËS PËR MBLEDHJEN DHE PËRDORIMIN E TË ARDHURAVE DYTËSORE QË KRIJOHEN NGA PAGESA E SUBJEKTEVE TË INTERESUARA PËR PROMOVIMIN E AKTIVITETEVE DHE PËR SHËRBIMET TURISTIKE NË HAPËSIRAT E MENAXHUARA NGA AGJENCIA KOMBËTARE E TURIZMIT

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe pikës 15, të nenit 14, të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, ministri i Turizmit, Kulturës dhe Sportit dhe ministri i Financave,

UDHËZOJNË:

1. Ky udhëzim ka për objekt miratimin e procedurës për mbledhjen dhe përdorimin e të ardhurave dytësore që krijohen nga pagesa e subjekteve të interesuara për promovimin e aktiviteteve dhe për shërbimet turistike në hapësirat e menaxhuara nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, me qëllim garantimin e ligjshmërisë, transparencës dhe përdorimit të drejtë të tyre.

2. Në këtë udhëzim termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**AKT**” është Agjencia Kombëtare e Turizmit;

b) “**Subjekte të interesuara**” janë subjektet publike ose private që përfitojnë shërbime promovuese ose informuese nga Agjencia Kombëtare e Turizmit kundrejt pagesës;

c) “**Të ardhura dytësore**” janë të ardhurat që krijohen nga ofrimi kundrejt pagesës i shërbimeve promovuese dhe informuese, si dhe nga përdorimi i hapësirave, mjeteve dhe platformave në administrim të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

3. Agjencia Kombëtare e Turizmit ofron kundrejt pagesës shërbime promovuese dhe informuese, përfshirë, por pa u kufizuar në:

a) shërbime promovuese digjitale përmes faqeve zyrtare, aplikacioneve dhe platformave elektronike;

b) shërbime promovuese në panairë, evente, konferenca dhe veprimtari të tjera kombëtare ose ndërkombëtare;



c) shpërndarjen e materialeve promovuese dhe informuese në formë të shtypur ose elektronike;

ç) forma të tjera shërbimesh që lidhen drejtpërdrejt me funksionet ligjore të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

4. Ofrimi i shërbimeve promovuese nga Agjencia Kombëtare e Turizmit realizohet në përputhje me funksionet e saj ligjore, mbi bazën e parimeve të eficiencës, transparencës dhe mbulimit të kostos, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

5. Pagesat për shërbimet e ofruara kryhen nëpërmjet faturimit elektronik ose formave të tjera të arkëtimit, në përputhje me legjislacionin financiar dhe tatimor në fuqi.

6. Të ardhurat dytësore administrohen nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, në përputhje me rregullat e administrimit financiar publik dhe legjislacionin buxhetor në fuqi.

7. Të ardhurat dytësore ndahen ndërmjet Agjencisë Kombëtare të Turizmit dhe buxhetit të shtetit, si më poshtë:

a) 90 % e të ardhurave mbeten në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

b) 10 % e të ardhurave derdhen në buxhetin e shtetit, në përputhje me legjislacionin financiar dhe buxhetor në fuqi.

8. Pjesa e të ardhurave që mbetet në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Turizmit përdoret, brenda limiteve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit, vetëm për:

a) zhvillimin dhe mirëmbajtjen e mjeteve dhe platformave promovuese;

b) realizimin e aktiviteteve të promovimit kombëtar dhe ndërkombëtar të turizmit;

c) mbulimin e shpenzimeve të domosdoshme për ushtrimin e funksioneve ligjore të Agjencisë Kombëtare të Turizmit.

9. Përdorimi i të ardhurave dytësore kryhet brenda limiteve të miratuara në ligjin vjetor të buxhetit.

10. Agjencia Kombëtare e Turizmit siguron transparencë përmes publikimit të tarifave, shërbimeve dhe informacionit mbi përdorimin e të ardhurave në faqen e saj zyrtare.

11. Agjencia Kombëtare e Turizmit raporton pranë ministrisë përgjegjëse për turizmin, mbi nivelin e të ardhurave dytësore të mbledhura dhe mënyrën e përdorimit të tyre.

12. Raportimi mbi të ardhurat dytësore dhe përdorimi i tyre kryhet mbi bazë mujore, në

përputhje me procedurat e administrimit financiar publik dhe detyrimin për rakordimin periodik të të ardhurave dhe shpenzimeve me degën e thesarit.

13. Raporti përfshin të dhëna të detajuara mbi burimet e të ardhurave, nivelin e arkëtimeve, si dhe shpenzimet e kryera, në përputhje me legjislacionin financiar dhe buxhetor në fuqi.

14. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Turizmit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I TURIZMIT, KULTURËS
DHE SPORTIT
Blendi Gonxhja

MINISTËR I FINANCEVE
Petrit Malaj

URDHËR

Nr. 147, datë 30.6.2026

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR ADRESIMIN E VARFËRISË ENERGJETIKE DHE MBROJTJEN E KLIENTËVE NË NEVOJË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË SHQIPËRI, 2026–2030

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 59/2026, “Për sektorin e energjisë elektrike,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për adresimin e varfërisë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë të energjisë elektrike në Shqipëri, 2026–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Enea Karakaçi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR
ADRESIMIN E VARFËRISË ENERGJETIKE
DHE MBROJTJEN E KLIENTËVE NË
NEVOJË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NË
SHQIPËRI, 2026–2030
(përfshirë Metodologjinë për Identifikimin dhe
Monitorimin e Varfërisë Energjetike –
shtojca 2)

Tiranë, 2026

PËRMBAJTJA

Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive

1. Objektivi dhe fushëveprimi

1.1 Objektivi

1.2 Fushëveprimi

1.3 Dallimi ndërmjet varfërisë energjetike dhe statusit të klientit në nevojë

2. Konteksti i politikave

2.1 Baza ligjore dhe e politikave ekzistuese

2.2 Kuadri i klientit në nevojë sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike

2.3 Roli i Ligjit për Ndihmën Sociale

2.4 Praktika ekzistuese e kompensimit

2.5 Mbrojtja rregullatore nga shkëputja

2.6 Varfëria energjetike si çështje më e gjerë e politikave

2.7 Lidhja me kuadrin më të gjerë të reformës

2.8 Qëllimi i këtij Plan në kontekstin aktual

2.9 Përputhshmëria me kuadrin e politikave të BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë

3. Veprimet

3.1 Veprimi 1. Krijimi dhe operacionalizimi i metodologjisë kombëtare, vlerësimit bazë dhe kuadrit të monitorimit për varfërinë energjetike

3.2 Veprimi 2. Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave të kërkuar sipas nenit 95 për operacionalizimin e statusit të klientit në nevojë

3.3 Veprimi 3. Operacionalizimi i regjistrit të klientit në nevojë dhe shkëmbimi ndërveprues i të dhënave

3.4 Veprimi 4. Konsolidimi dhe përmirësimi i mbështetjes për përballueshmërinë e familjeve l dhe klientëve në nevojë

3.5 Veprimi 5. Aktivizimi dhe forcimi i mbrojtjes ndaj shkëputjes dhe praktikave të padrejta të furnizimit

3.6 Veprimi 6. Ulja e faktorëve strukturorë të varfërisë energjetike përmes masave të orientuara të eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave

3.7 Veprimi 7. Krijimi i qeverisjes, koordinimit, komunikimit publik dhe vlerësimit

4. Instrumentet mundësuese

4.1 Qëllimi

4.2 Baza kryesore ligjore

4.3 Instrumenti kryesor zbatues sipas nenit 95

4.4 Instrumentet rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë

4.5 Instrumentet ekzistuese të kompensimit

4.6 Instrumentet për mbështetjen e përballueshmërisë dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura

4.7 Instrumentet për masat strukturore që adresojnë varfërinë energjetike

4.8 Instrumentet e mbrojtjes dhe qeverisjes së të dhënave

4.9 Instrumentet administrative dhe teknike

4.10 Roli funksional i instrumenteve mundësuese në këtë Plan

5. Zbatimi dhe koordinimi

5.1 Qëllimi

5.2 Koordinimi kombëtar

5.3 Përgjegjësitë institucionale

5.4 Arkitektura e dyfishtë e zbatimit

5.5 Qasja e zbatimit

5.6 Zbatimi administrativ

5.7 Komunikimi publik dhe aksesit i familjeve

5.8 Monitorimi dhe raportimi

5.9 Rishikimi vjetor dhe përshtatja

Shtojca 1. Matrica e rezultateve dhe zbatimit

Shtojca 2. Metodologjia për Identifikimin dhe Monitorimin e Varfërisë Energjetike

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky Plan Kombëtar Veprimi përcakton qasjen e integruar të Shqipërisë për adresimin e vulnerabilitetit energjetik të familjeve, përmes dy kuadrove të veçantë por të lidhur me njëri-tjetrin. I pari është kuadri i varfërisë energjetike, i cili shërben për të identifikuar, matur, monitoruar dhe vlerësuar familjet e prekura ose në rrezik, nga mungesa e aksesit në shërbimet thelbësore të energjisë në banesë dhe për të orientuar hartimin e politikave, synimin, raportimin dhe vlerësimin. I dyti është



kuadri i klientit në nevojë, i cili shërben si mekanizëm ligjor dhe operacional për njohjen e konsumatorëve familjarë të pranueshëm dhe dhënien e të drejtave, masave mbrojtëse dhe masave të mbështetjes specifike të parashikuara në sektorin e energjisë elektrike sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Ky Plan kombinon kështu krijimin e metodologjisë kombëtare dhe kuadrit të monitorimit për varfërinë energjetike me operacionalizimin e statusit të klientit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike, ndërkohë që siguron edhe bazën për masa më të gjera që synojnë uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

Zbatimi i këtij Plani do të kryhet nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, si institucioni përgjegjës për kuadrin e varfërisë energjetike dhe masat më të gjera të eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave, në bashkërendim edhe me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, si institucioni përgjegjës për sistemin e mbrojtjes sociale dhe kuadrin e klientit në nevojë, secila duke vepruar brenda mandatit të saj ligjor dhe duke qenë bashkërisht përgjegjëse, nën autoritetin e Këshillit të Ministrave, për koordinimin e përgjithshëm të këtij Plani.

Plani fillon me krijimin dhe miratimin e metodologjisë kombëtare për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike. Ky është veprimi i parë i Planit dhe siguron bazën për vlerësimin bazë, monitorimin e rregullt, synimin e politikave dhe raportimin e kërkuar sipas kuadrit më të gjerë të reformës. Metodologjia, e përcaktuar plotësisht në shtojcën 2, përcakton kriteret e vlerësimit dhe njësinë e vlerësimit, krijon Regjistrin Kombëtar të Varfërisë Energjetike si shtyllën kurrizore të sistemit informativ ndërveprues të kuadrit, dhe përcakton qasjen operationale, të bazuar në të ardhura dhe kosto (Të Ardhura të Ulëta dhe Kosto të Larta), përmes së cilës identifikohen familjet me varfëri energjetike për qëllime monitorimi, raportimi dhe synimi të politikave.

Plani parashikon, gjithashtu, miratimin dhe operacionalizimin e kuadrit nënligjor të kërkuar sipas nenit 95 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, në mënyrë që statusi i klientit në nevojë të bëhet plotësisht funksional në praktikë. Kjo përfshin përcaktimin e kriterëve dhe procedurave, krijimin e regjistrit operacional dhe sistemit të shkëmbimit të të dhënave, dhe aktivizimin e masave mbrojtëse

përkatese, përfshirë mbrojtjen nga shkëputja dhe aksesin në masat e mbështetjes së zbatueshme.

Plani siguron më tej bazën për kombinimin e masave të menjëhershme mbrojtëse me veprime strukturore afatgjata, duke përfshirë një paketë të orientuar masash të eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave, rinovimin e zarfit mbështjellës të ndërtesës, konvertimin e sistemeve të ngrohjes larg përdorimit joeficient të lëndëve djegëse të ngurta, zëvendësimin e pajisjeve, masa me kosto të ulët dhe këshillim energjetik, si dhe mbështetje për burime të vogla të energjisë së rinovueshme për familjet e prekura nga varfëria energjetike.

Në hartimin e metodologjisë, arkitekturës institucionale dhe masave të eficiencës së energjisë, të përcaktuara në këtë Plan, Shqipëria është bazuar në udhëzimet përkufizuese dhe të treguesve të lëshuar nga Komisioni Evropian dhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë për palët kontraktuese, si dhe në katalogun e masave afatshkurtra dhe afatgjata të rekomanduara në nivel evropian dhe rajonal, në mënyrë që kuadri kombëtar të mbetet i krahasueshëm me, dhe i aftë të krahasohet me, praktikatat e tjera në rajon dhe në Bashkimin Evropian.

1. OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI

1.1 Objektivi

Objektivi i këtij Plani Kombëtar Veprimi është ulja e varfërisë energjetike dhe forcimi i mbrojtjes së konsumatorëve familjarë l të energjisë elektrike në Shqipëri, përmes:

- krijimit të një sistemi kombëtar për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike; dhe

- krijimit të një kuadri operacional për njohjen dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë mbështetjen financiare, mbrojtjen nga shkëputja dhe aksesin në shërbimin universal sipas kushteve të rregulluara.

1.2 Fushëveprimi

Ky Plan zbatohet për konsumatorët familjarë të energjisë elektrike dhe fokusohet në dy grupe:

- familjet e prekura nga varfëria energjetike, të kuptuara si familje që nuk kanë ose janë në rrezik të mos kenë akses në shërbimet thelbësore të energjisë në banesë; dhe

- klientët familjarë të njohur si klientë në nevojë për qëllime të mbrojtjes në sektorin e energjisë elektrike, përfshirë regjistrimin, mbështetjen dhe të



drejtat e parashikuara sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Plani përfshin:

- instrumentet ligjore dhe rregullatore;
- procedurat e identifikimit dhe regjistrimit;
- masat e mbrojtjes financiare të financuara nga buxheti i shtetit;
- shkëmbimin e të dhënave dhe masat mbrojtëse të të dhënave;
- masat e eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave; dhe
- sistemin për monitorimin, raportimin dhe vlerësimin.

1.3 Dallimi ndërmjet varfërisë energjetike dhe statusit të klientit në nevojë

Kjo paketë politikash krijon një kuadër me dy shtigje për adresimin e vulnerabilitetit energjetik të familjeve në Shqipëri. Varfëria energjetike shërben si kuadri kombëtar i politikave për identifikimin, matjen, monitorimin dhe vlerësimin e familjeve që nuk kanë ose janë në rrezik të mos kenë akses në shërbimet thelbësore të energjisë në banesë, për qëllime të hartimit të politikave, synimit, raportimit dhe vlerësimit. Statusi i klientit në nevojë shërben si statusi ligjor në sektorin e energjisë elektrike, përmes të cilit konsumatorët familjarë të pranueshëm njihen, regjistrohen dhe u jepen të drejtat, masat mbrojtëse dhe masat e mbështetjes specifike të parashikuara sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, përfshirë mbrojtjen nga shkëputja sipas rregullave të zbatueshme, aksesin në shërbimin universal sipas kushteve të rregulluara, dhe mbështetjen financiare kur është e zbatueshme. Identifikimi dhe verifikimi i familjeve të pranueshme për statusin e klientit në nevojë do të kryhet përmes sistemit të mbrojtjes sociale, i mbështetur nga shkëmbimi administrativ i të dhënave me institucionet e sektorit të energjisë elektrike, ndërsa masat më të gjera për uljen e varfërisë energjetike, përfshirë ndërhyrjet e eficiencës së energjisë dhe ato të lidhura me strehimin, do të orientohen nga metodologjia kombëtare për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike. Dy kuadrot janë të lidhura dhe forcojnë njëri-tjetrin, por nuk janë të njëjta dhe do të zbatohen përmes instrumenteve të veçanta ligjore dhe institucionale.

Për qëllimet e këtij Plani, varfëria energjetike trajtohet si një kusht më i gjerë i familjes, që identifikohet dhe vlerësohet përmes metodologjisë kombëtare të krijuar nga ky Plan për qëllime

monitorimi, synimi dhe vlerësimi. Ajo përdoret për të kuptuar shkallën, shtrirjen, faktorët shkaktarë dhe grupet prioritare të vulnerabilitetit energjetik të familjeve, dhe për të orientuar ndërhyrjen më të gjerë të politikave, përfshirë masat strukturore që synojnë uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

Statusi i klientit në nevojë, përkundrazi, trajtohet si një status ligjor në sektorin e energjisë elektrike. Ai jepet në bazë të kriterëve dhe procedurave të përcaktuara nga Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike dhe legjislacioni nënligjor zbatues, dhe lidhet me masa specifike mbrojtëse dhe mbështetëse në sektorin e energjisë elektrike.

Dy kuadrot janë, pra, të lidhura por të dallueshëm. Kuadri i varfërisë energjetike shërben për të identifikuar nevojat, tendencat dhe fushat për veprim më të gjerë të politikave. Kuadri i klientit në nevojë shërben për të administruar statusin ligjor dhe për të dhënë të drejtat dhe masat mbrojtëse specifike në sektorin e energjisë elektrike. Jo çdo familje e prekur nga varfëria energjetike do të kualifikohet domosdoshmërisht si klient në nevojë, dhe mbrojtja si klient në nevojë nuk e shteron vetvetiu përgjigjen më të gjerë të politikave të kërkuara për adresimin e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

2. KONTEKSTI I POLITIKAVE

2.1 Baza ligjore dhe e politikave ekzistuese

Shqipëria ka krijuar tashmë bazën kryesore ligjore dhe institucionale për mbrojtjen e konsumatorëve familjarë l të energjisë elektrike dhe për adresimin e varfërisë energjetike. Kjo bazë formohet nga Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike, Ligji për Ndhimën Sociale, vendimet ekzistuese të kompensimit për kategoritë në nevojë, kuadri rregullator për shërbimin universal dhe kushtet e shkëputjes, dhe kuadri ligjor, dhe i politikave të lidhura me performancën energjetike dhe rinovimin e ndërtesave.

Në përputhje me këtë, ky Plan Veprimi adreson njëkohësisht kuadrin më të gjerë për identifikimin, monitorimin dhe uljen e varfërisë energjetike, dhe kuadrin specifik ligjor dhe operacional për mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike. Legjislacioni nënligjor i miratuar sipas nenit 95 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike do të rregullojë kuadrin e klientit në nevojë dhe nuk do të zëvendësojë kuadrin më të gjerë kombëtar të

krijuar nga ky Plan për identifikimin dhe adresimin e varfërisë energjetike.

2.2 Kuadri i klientit në nevojë sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike

Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike siguron bazën qendrore ligjore për kuadrin e klientit në nevojë. Ai përcakton statusin e klientit në nevojë dhe kërkon miratimin e legjislacionit nënligjor mbi kriteret, procedurat dhe trajtimin. Ai, gjithashtu, parashikon krijimin dhe mbajtjen e regjistrit përkatës, kërkon transmetimin e informacionit tek operatori i shpërndarjes dhe furnizuesi, e lidh këtë status me shërbimin universal, dhe parashikon mbrojtje nga shkëputja sipas kushteve rregullatore specifike.

Ligji krijon kështu, tashmë, arkitekturën thelbësore ligjore për mbrojtjen e klientit në nevojë. Çka mbetet e nevojshme është të plotësohet kuadri zbatues i kërkuar për ta bërë këtë status plotësisht operacional në praktikë.

2.3 Roli i Ligjit për Ndihmën Sociale

Ligji për Ndihmën Sociale siguron bazën kryesore administrative dhe institucionale për identifikimin dhe mbështetjen e familjeve me të ardhura të ulëta. Ai mbetet pika kryesore e hyrjes për lidhjen e vulnerabilitetit më të gjerë social me mbrojtjen në sektorin e energjisë elektrike dhe për lidhjen e kuadrit të klientit në nevojë me sistemin ekzistues të mbështetjes sociale.

Zbatimi i kuadrit të klientit në nevojë duhet, pra, të jetë i lidhur ngushtë me sistemin e ndihmës sociale, si për qëllimin e identifikimit të familjeve të pranueshme, ashtu edhe për sigurimin e zbatueshmërisë administrative dhe koherencës ndërinstitucionale.

2.4 Praktika ekzistuese e kompensimit

Shqipëria ka tashmë përvojë me kompensimin e energjisë elektrike përmes vendimeve ekzistuese të Këshillit të Ministrave që mbështesin kategori të tilla, si:

- familjet në ndihmë ekonomike;
- pensionistë të caktuar;
- punonjës me pagë të ulët të buxhetit;
- personat e verbër; dhe
- personat paraplegjikë dhe tetraplegjikë.

Këto masa sigurojnë një platformë ekzistuese mbështetjeje dhe tregojnë se mekanizmat e kompensimit për grupet I janë tashmë pjesë e praktikës administrative. Në të njëjtën kohë, këto masa nuk zëvendësojnë regjimin më të gjerë ligjor të

parashikuar sipas Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike për klientët në nevojë. Ato mbeten skema kompensimi të bazuara në kategori dhe nuk krijojnë vetvetiu trajtimin e plotë ligjor dhe operacional të kërkuar sipas neneve 95 dhe 96.

2.5 Mbrojtja rregullatore nga shkëputja

Enti Rregullator i Energjisë ka krijuar tashmë një kuadër të veçantë mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit me energji elektrike për klientët në nevojë. Kjo krijon një bazë të rëndësishme rregullatore për mbrojtjen nga shkëputja. Megjithatë, zbatimi i plotë dhe i njëtrajtshëm i këtij regjimi varet nga përfundimi i kuadrit nënligjor të kërkuar për operacionalizimin e statusit të klientit në nevojë, përfshirë kriteret, procedurat dhe rregullat e regjistrit që mundësojnë zbatimin e këtyre masave mbrojtëse në mënyrë të njëtrajtshme dhe të verifikueshme.

2.6 Varfëria energjetike si çështje më e gjerë e politikave

Konteksti aktual i politikave kërkon, gjithashtu, një trajtim më të strukturuar dhe më të gjerë të varfërisë energjetike. Varfëria energjetike nuk mund të adresohet vetëm përmes kompensimit të faturave ose njohjes ligjore të klientëve në nevojë. Ajo kërkon, gjithashtu:

- një metodologji për identifikimin dhe monitorimin;
- një vlerësim bazë dhe raportim të rregullt;
- masa strukturore që adresojnë faktorët themelorë të problemit; dhe
- koordinim ndërmjet sektorëve përgjegjës për mbrojtjen sociale, rregullimin e energjisë, eficiencën e energjisë, strehimin dhe komunikimin publik.

Për këtë arsye, Plani adreson njëkohësisht nevojën e menjëhershme për operacionalizimin e kuadrit të klientit në nevojë dhe nevojën më të gjerë për ndërtimin e një kuadri kombëtar për uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

2.7 Lidhja me kuadrin më të gjerë të reformës

Krijimi i metodologjisë kombëtare për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike nuk është vetëm veprimi i parë i këtij Plani, por, gjithashtu, pjesë e kuadrit më të gjerë të reformës brenda të cilit Shqipëria kërkohet të forcojë qasjen e saj ndaj varfërisë energjetike. Operacionalizimi i statusit të klientit në nevojë dhe zhvillimi i masave afatgjata strukturore duhet, pra, të kuptohen si pjesë e një procesi të vetëm e koherent



reforme, që kombinon mbrojtjen ligjore, mbështetjen sociale, zbatimin rregullator dhe zbutjen strukturore.

2.8 Qëllimi i këtij Plani në kontekstin aktual

Në këtë kontekst, ky Plan shërben për dy funksione:

- plotëson dhe operacionalizon kuadrin ligjor për njohjen dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë në sektorin e energjisë elektrike; dhe

- krijon kuadrin më të gjerë për identifikimin, monitorimin dhe uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

2.9 Përputhshmëria me kuadrin e politikave të BE-së dhe të Komunitetit të Energjisë

Si Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë, detyrimet e Shqipërisë në këtë fushë rrjedhin nga *aquis*-i i tregut të energjisë të BE-së, i përshtatur për Komunitetin e Energjisë, në veçanti Direktiva (BE) 2019/944 për rregullat e përbashkëta të tregut të brendshëm të energjisë elektrike dhe Rregullorja (BE) 2018/1999 për qeverisjen e bashkimit energjetik, të cilat kërkojnë nga palët kontraktuese të përcaktojnë konsumatorët 1, t'i mbrojnë ata nga shqëputja në periudha kritike dhe të vlerësojnë e ulin numrin e familjeve në varfëri energjetike.

Në hartimin e këtij Plani, Shqipëria ka marrë në konsideratë, gjithashtu, udhëzimet rekomanduese të lëshuara në nivel evropian dhe rajonal, përfshirë Rekomandimin e Komisionit (BE) 2023/2407, datë 20 tetor 2023, mbi varfërinë energjetike, dhe Udhëzimet e Politikave të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë për Identifikimin dhe Adresimin e Varfërisë Energjetike në palët kontraktuese të Komunitetit të Energjisë (PG 02/2022). Studimi i vitit 2022 i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë konstatoi se 37% e familjeve shqiptare nuk ishin në gjendje të mbanin banesën e tyre të ngrohur mjaftueshëm – një nga përqindjet më të larta ndër palët kontraktuese – ndërsa skemat ekzistuese të kompensimit arrinin rreth 213.000 familje ose rreth 29% e të gjitha familjeve, me një alokim buxhetor vjetor të vlerësuar rreth 22,2 milionë euro (rreth 104 euro për familje të mbështetur). Këto të dhëna, së bashku me të dhënat në nivel familjeje që do të gjenerohen sipas veprimit 1 dhe shtojcës 2 të këtij Plani, formojnë pjesë të bazës faktike për synimin dhe buxhetimin e masave të përcaktuara më poshtë.

Ky Plan merr në konsideratë, gjithashtu, drejtimin e nismave më të fundit evropiane, përfshirë Planin e Veprimit për Energji të Përballueshme (shkurt 2025) dhe Paketën e Energjisë për Qytetarët (mars 2026), të dyja prej të cilave forcojnë prioritetin e dhënë mbrojtjes së familjeve 1 dhe uljes së varfërisë energjetike si pjesë e tranzicionit më të gjerë energjetik, si dhe kërkesat e prioritarizimit të varfërisë energjetike të prezantuara nga Direktiva e rishikuar mbi Performancën Energjetike të Ndërtesave (neni 22, mbi planet kombëtare të rinovimit të ndërtesave) dhe Direktiva e rishikuar mbi Eficiencën e Energjisë (neni 24, mbi prioritarizimin e familjeve 1 dhe me varfëri energjetike në skemat e detyrimit të eficiencës së energjisë), të dyja të pasqyruara në strukturën e ligjit nr. 37/2025 “Për performancën energjetike të ndërtesave”. Ndërkohë që këto instrumente nuk janë, si të tilla, detyruese për Shqipërinë jashtë *acquis*-it të përshtatur të Komunitetit të Energjisë, ato përbëjnë kuadrin krahasues përkatës ndaj të cilit janë krahasuar metodologjia, treguesit dhe masat e eficiencës së energjisë të këtij Plani.

3. VEPRIMET

3.1 Veprimi 1. Krijimi dhe operacionalizimi i metodologjisë kombëtare, vlerësimit bazë dhe kuadrit të monitorimit për varfërinë energjetike

Ky veprim është pjesë e kuadrit më të gjerë të varfërisë energjetike dhe nuk krijon vetvetiu të drejtë ligjore ose status klienti në nevojë.

Rezultati

Deri në fund të vitit 2026, Shqipëria do të krijojë metodologjinë kombëtare për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike, do të miratojë aktin zbatues të kërkuar sipas nenit 22(7), të ligjit nr. 37/2025, do të përgatisë vlerësimin kombëtar bazë, dhe do të vendosë kuadrin e monitorimit dhe raportimit.

Produktet kryesore

- Metodologjia e përcaktuar në shtojcën 2 do të përbëjë bazën për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike sipas këtij Plani.

- Akti zbatues i miratuar në mbështetje të nenit 22(7), të ligjit nr. 37/2025, do të përcaktojë treguesit, pragjet, burimet e të dhënave, metodat e llogaritjes, formatin e raportimit dhe shpeshhtësinë e raportimit të kërkuar për zbatimin operacional të metodologjisë.

- Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike do të krijohet si shtylla kurizore e sistemit informativ



ndërveprues të metodologjisë, me zhvillimin teknik të besuar Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe qeverisjen e besuar Grupit Ndërinstitucional të Përhershëm të Punës, në përputhje me nenet 8–10, të shtojcës 2.

- Familjet do të klasifikohen duke përdorur treguesin e të Ardhurave të Ulëta dhe Kostos së Lartë (LIHC) të përcaktuar në nenin 11, të shtojcës 2, të krahasuar, për qëllime krahasueshmërie, me treguesit kryesorë të rekomanduar nga Komisioni Evropian dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (barra energjetike, M/2, 2M, dhe përqindja e popullsisë që nuk është në gjendje të mbajë banesën e ngrohur mjaftueshëm).

- Një vlerësim kombëtar bazë i varfërisë energjetike do të përgatitet në bazë të metodologjisë dhe aktit zbatues të miratuar.

- Do të krijohet një cikël i rregullt monitorimi dhe raportimi, përfshirë Raportin Vjetor të Riskut të Varfërisë Energjetike të parashikuar në nenin 16, të shtojcës 2, për të mbështetur synimin e politikave, vlerësimin dhe rishikimin periodik.

3.2 Veprimi 2. Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave, të kërkuar sipas nenit 95 për operacionalizimin e statusit të klientit në nevojë

Ky veprim është pjesë e kuadrit të klientit në nevojë dhe është instrumenti qendror ligjor për operacionalizimin e mbrojtjes në sektorin e energjisë elektrike.

Rezultati

Deri në fund të vitit 2026, miratohet vendimi i Këshillit të Ministrave, i kërkuar sipas nenit 95 të ligjit nr. 43/2015, duke përcaktuar kriteret dhe procedurat për njohjen e klientëve në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre.

Produktet kryesore

- Vendimi do të marrë formën e projektvendimit “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike dhe mënyrën e trajtimit të tyre”, aktualisht në fazën e përgatitjes ndërinstitucionale të përbashkët nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, ministria përgjegjëse për energjinë, dhe ministria përgjegjëse për financat, për t’u paraqitur në Këshillin e Ministrave brenda afatit të përcaktuar në këtë veprim.

- Vendimi do të përcaktojë kriteret e pranueshmërisë, përfshirë kriteret e lidhura me të

ardhurat, karakteristikat teknike të lidhjes, parametrat sezonalë të konsumit kur janë të zbatueshëm, dhe formën e mbështetjes së financuar nga buxheti i shtetit.

- Vendimi do të përcaktojë procedurat e aplikimit, verifikimit, njohjes, rishikimit, pezullimit dhe çregjistrimit, së bashku me përgjegjësitë institucionale dhe procedurat e ankimimit.

- Vendimi do të parashikojë në mënyrë të shprehur trajtimin e klientëve shumë të varur nga energjia elektrike (varësi kritike) dhe afatet operationale që rregullojnë rrjedhën e informacionit drejt operatorit të shpërndarjes dhe furnizuesve.

3.3 Veprimi 3. Operacionalizimi i regjistrimit të klientit në nevojë dhe shkëmbimi ndërveprues i të dhënave

Rezultati

Deri në fund të vitit 2027, Shqipëria operon një Regjistrë të Klientit në Nevojë, të sigurt dhe me qëllim të kufizuar, pranë autoritetit kompetent të mirëqenies sociale, me shkëmbim të rregullt dhe të besueshëm të të dhënave drejt operatorit të shpërndarjes dhe furnizuesve përkatës.

Produktet kryesore

- Regjistri i klientit në nevojë do të hartohet dhe vendoset në mënyrë të ndërveprueshme me sistemet ekzistuese të ndihmës sociale, duke ruajtur njëkohësisht kufizimin e qëllimit dhe minimizimin e të dhënave.

- Do të krijohen protokolle të standardizuara të shkëmbimit të të dhënave ndërmjet strukturave të mbrojtjes sociale, operatorit të shpërndarjes dhe furnizuesve, përfshirë përditësime të rregullta, përditësime të bazuara në ngjarje për raste kritike, dhe procedura për korrigjimin e gabimeve.

- Regjistri do të qeveriset nga rregulla të qarta privatësie, sigurie, aksesit, ruajtjeje dhe auditimi, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

3.4 Veprimi 4. Konsolidimi dhe përmirësimi i mbështetjes për përbalueshmërinë e familjeve 1 dhe klientëve në nevojë

Rezultati

Deri në vitin 2028, Shqipëria operon një paketë koherente dhe të orientuar të mbështetjes për përbalueshmërinë, që mbron klientët e njohur në nevojë dhe mbështet familjet e prekura nga varfëria energjetike përmes instrumenteve të përshtatshme dhe mirë të synuara.

*Produktet kryesore*

- Skemat ekzistuese të kompensimit të faturës së energjisë elektrike do të rishikohen dhe harmonizohen brenda një logjike kombëtare më koherente synimi, të lidhur me kuadrin e klientit në nevojë dhe me kuadrin më të gjerë të politikave për varfërinë energjetike.

- Do të prezantohet një qasje e strukturuar për parandalimin dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura për klientët në nevojë, përfshirë identifikimin e hershëm, plane pagese të përshtatura, dhe lidhjen me mekanizmat e ankimimit dhe mbrojtjes.

- Kuadri i politikave do të ruajë mundësinë e masave të synuara mbështetëse për familjet e prekura nga varfëria energjetike por që nuk përfshihen në kuadrin ligjor të klientit në nevojë, kur kjo justifikohet nga vlerësimi bazë, rezultatet e monitorimit, hapësira fiskale, dhe hartimi i instrumenteve specifike mbështetëse. Masa të tilla do të zhvillohen në një mënyrë që nuk e transformon kuadrin më të gjerë të varfërisë energjetike në një status ligjor ose regjistror paralel.

3.5 Veprimi 5. Aktivizimi dhe forcimi i mbrojtjes ndaj shkëputjes dhe praktikave të padrejta të furnizimit

Rezultati

Deri në fund të vitit 2027, klientët familjarë të njohur si klientë në nevojë janë efektivisht të mbrojtur nga shkëputja, në përputhje me kuadrin rregullator dhe Ligjin për Sektorin e Energjisë Elektrike.

Produktet kryesore

- Pas miratimit të vendimit sipas nenit 95, regjimi rregullator mbi kushtet e shkëputjes për klientët në nevojë do të bëhet plotësisht operacional dhe i harmonizuar me kuadrin e njohjes dhe regjistrin.

- Kushtet kontraktore dhe operacionale përkatëse sipas shërbimit universal do të përditësohen, kur është e nevojshme, për të siguruar që masat mbrojtëse zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme nga furnizuesit dhe operatori i shpërndarjes.

- Do të krijohet një sistem pajtueshmërie dhe monitorimi i udhëhequr nga rregullatori, për të ndjekur njoftimet, shkëputjet, rilidhjet, planet e pagesës, ankimimet, dhe shkeljet e rregullave të zbatueshme.

3.6 Veprimi 6. Ulja e faktorëve strukturorë të varfërisë energjetike përmes masave të orientuara të eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave

Këto masa orientohen nga kuadri i varfërisë energjetike dhe nuk kufizohen vetëm te familjet e njohura si klientë në nevojë, megjithëse familje të tilla mund të trajtohen si grup prioritar kur është e përshtatshme.

Rezultati

Deri në vitin 2030, Shqipëria ul në mënyrë të matshme përhapjen dhe ashpërsinë e varfërisë energjetike, duke prioritetizuar ndërhyrjet e orientuara të eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave për familjet me varfëri energjetike dhe me të ardhura të ulëta, në përputhje me kërkesat e synimit familjar të neneve 6(13) dhe 31, të ligjit nr. 37/2025 dhe me prioritetin e dhënë familjeve 1 dhe me varfëri energjetike sipas Direktivës së rishikuar mbi Eficiencën e Energjisë dhe Direktivës së rishikuar mbi Performancën Energjetike të Ndërtesave.

Produktet kryesore

- Synimi i varfërisë energjetike do të integrohet në Planin Kombëtar të Rinovimit të Ndërtesave, të miratuar sipas nenit 5, të ligjit nr. 37/2025 dhe në planifikimin dhe zbatimin e rinovimit të ndërtesave në përgjithësi, me prioritet për familjet e klasifikuara si të prekura nga varfëria energjetike, sipas shtojcës 2 dhe për grupe të tjera me të ardhura të ulëta të identifikuar për mbështetje strukturore.

- Do të zbatohet një portofol ndërhyrjesh, i strukturuar sipas llojeve të mëposhtme të masave, në përputhje me katalogun e rekomanduar nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (udhëzimet e Politikave PG 02/2022):

- rinovimi i zarfit mbështjellës të ndërtesës (izolimi i mureve, çatisë dhe dyshemesë, dhe zëvendësimi i dritareve dhe dyerve), i zbatuar si masa të veçanta ose si paketa të integruara rinovimi të thellë;

- përmirësimi i sistemeve të ngrohjes, përfshirë zëvendësimin e burimeve individuale joeficiente dhe të pasigurta të ngrohjes – në veçanti sobat e vjetra me dru – me alternativa me eficiencë më të lartë ose të centralizuara, dhe konvertimin e karburantit drejt opsioneve më të pastra dhe më të përbalueshme, të zbatuar si masë prioritare, duke pasur në konsideratë mbështetjen e vazhdueshme të shumë familjeve me varfëri energjetike të lëndët djegëse të ngurta;



- zëvendësimi i pajisjeve joeficiente shtëpiake sipas një skeme “të vjetër-për-të-re”, e kushtëzuar nga dorëzimi i pajisjes së zëvendësuar;

- masa me kosto të ulët të eficientës së energjisë dhe këshillim energjetik – izolimi i rrjedhjeve të ajrit, ndriçim LED, auditime të thjeshta energjetike dhe këshillim i dedikuar për familjet në nevojë, dhe familjet me varfëri energjetike – të ofruara përmes mekanizmit të këshillimit dhe asistencës, të krijuar sipas nenit 31, të ligjit nr. 37/2025, përfshirë, kur është e mundur, një model të dritares së vetme që integron këshillimin teknik me informacionin mbi financimin dhe skemat e mbështetjes së disponueshme; dhe

- mbështetje për instalimin e burimeve të vogla të energjisë së rinovueshme (pale fotovoltaike dhe kolektorë diellorë termikë) për familjet me varfëri energjetike, kur është e përshtatshme, në kombinim me masat e mësipërme.

- Financimi për ndërhyrjet e mësipërme do të bazohet në ciklin trevjeçar të planifikimit të mbështetur nga Raporti Vjetor i Riskut të Varfërisë Energjetike i përgatitur sipas nenit 16, të shtojcës 2, dhe do t’u jepet prioritet familjeve dhe kategorive të banesave të identifikuar përmes Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike.

- Do të krijohen mekanizma matjeje dhe verifikimi për të vlerësuar ndikimin e ndërhyrjeve në konsumin e energjisë, përballueshmërinë, komoditetin, cilësinë e ajrit të brendshëm, dhe uljen afatgjatë të varfërisë energjetike, duke u bazuar në treguesit e përcaktuar në shtojcën 2.

3.7 Veprimi 7. Krijimi i qeverisjes, koordinimit, komunikimit publik dhe vlerësimit

Rezultati

Deri në fund të vitit 2026, Shqipëria ka një sistem operacional qeverisjeje dhe koordinimi për varfërinë energjetike dhe mbrojtjen e klientëve në nevojë të energjisë elektrike, përfshirë komunikimin publik dhe vlerësimin vjetor.

Produktet kryesore

- Do të krijohet një strukturë kombëtare drejtuese dhe një strukturë teknike pune, me mandate të qarta për hartimin ligjor, funksionimin e regjistrit, monitorimin, komunikimin dhe zbatimin e programeve.

- Do të miratohet një strategji komunikimi dhe ndërgjegjësimi për të informuar familjet mbi statusin e klientit në nevojë, të drejtat e ankimimit, masat

mbështetëse, dhe mundësitë e eficientës së energjisë.

- Do të përgatitet një raport vjetor zbatimi, që konsolidon tendencat e varfërisë energjetike, statistikave të regjistrit, treguesit të shkëputjeve dhe ankimimeve, dhe produktet e rezultatit të masave mbështetëse.

4. INSTRUMENTET ZBATUESE

4.1 Qëllimi

Ky seksion identifikon instrumentet ligjore, rregullatore, administrative dhe teknike të nevojshme për të bërë operacionale veprimet sipas këtij Plani. Ai lidh objektivat e politikave dhe veprimet e Planit me vendimet, rregullat, procedurat dhe sistemet e nevojshme për zbatim.

4.2 Baza kryesore ligjore

Ligji për Sektorin e Energjisë Elektrike mbetet baza kryesore ligjore për kuadrin e klientit në nevojë. Ai:

- krijon konceptin e klientit në nevojë;
- kërkon një vendim të Këshillit të Ministrave mbi kriteret dhe trajtimin;
- parashikon krijimin dhe mbajtjen e regjistrit të klientit në nevojë; dhe
- lidh statusin e klientit në nevojë me shërbimin universal dhe me mbrojtjen nga shkëputja.

Ligji nr. 37/2025, “Për performancën energjetike të ndërtesave”, siguron bazën kryesore ligjore për kuadrin e varfërisë energjetike, përfshirë përkufizimin e varfërisë energjetike (neni 4), kërkesën për miratimin e rregullave për monitorimin dhe raportimin (neni 22(7)), kërkesën që masat e performancës energjetike të shoqërohen me mbështetje financiare dhe teknike për familjet e prekura (neni 6(13)), Planin Kombëtar të Rinovimit të Ndërtesave (neni 5), dhe mekanizmin e këshillimit dhe asistencës për familjet dhe familjet me varfëri energjetike (neni 31). Ligji nr. 57/2019, “Për ndihmën sociale” siguron bazën administrative në të cilën të dy kuadrot identifikojnë dhe verifikojnë familjet në nevojë.

4.3 Instrumenti kryesor zbatues sipas nenit 95

Vendimi i Këshillit të Ministrave, i kërkuar sipas nenit 95 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, është instrumenti kryesor mundësues i kuadrit të klientit në nevojë sipas këtij Plani. Ai është akti që operacionalizon statusin e klientit në nevojë, duke përcaktuar:

- kriteret e pranueshmërisë;



- procedurat për njohjen, rishikimin, pezullimin dhe çregjistrimin;
- përgjegjësitë institucionale për administrimin dhe verifikimin;
- formën e mbështetjes që do të financohet nga buxheti i shtetit; dhe
- bazën operationale për regjistrimin, shkëmbimin e të dhënave dhe zbatimin e masave mbrojtëse.

Projekti i këtij vendimi “Për miratimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë në sektorin e energjisë elektrike dhe mënyrën e trajtimit të tyre”, është aktualisht në fazën e përgatitjes ndërinstitucionale, e udhëhequr nga ministria përgjegjëse për energjinë e cila do të vijojë bashkërendimin me ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, dhe ministrinë përgjegjëse për financat, për t’u paraqitur në Këshillin e Ministrave brenda afatit të përcaktuar në veprimin 2 të këtij Plani. Pa këtë instrument, statusi ligjor i klientit në nevojë nuk mund të funksionojë plotësisht në praktikë.

4.4 Instrumentet rregullatore të Entit Rregullator të Energjisë

Kuadri rregullator i Entit Rregullator të Energjisë është instrumenti kryesor mundësues për zbatimin praktik të masave mbrojtëse në sektorin e energjisë elektrike. Kjo përfshin në veçanti:

- rregullat mbi kushtet specifike për ndërprerjen e furnizimit për klientët në nevojë; dhe
- kushtet kontraktore dhe të shërbimit të lidhura me furnizimin sipas shërbimit universal.

Këto instrumente rregullatore duhet të harmonizohen me vendimin zbatues sipas nenit 95, në mënyrë që masat mbrojtëse të mund të zbatohen në bazë të statusit të verifikuar dhe procedurave operationale të njëtrajtshme.

4.5 Instrumentet ekzistuese të kompensimit

Vendimet ekzistuese të Këshillit të Ministrave që ofrojnë kompensim për energjinë elektrike për kategori specifike familjesh, klientët në nevojë mbeten të rëndësishme si baza aktuale praktike për mbështetjen e faturës së energjisë. Ato përbëjnë pjesë të arkitekturës ekzistuese të mbështetjes dhe sigurojnë një pikënisje administrative dhe fiskale për reformën më të gjerë.

Në të njëjtën kohë, këto instrumente nuk zëvendësojnë kuadrin ligjor dhe operacional të kërkuar për statusin e klientit në nevojë. Ato duhet,

pra, të rishikohen dhe harmonizohen me kuadrin më të gjerë të krijuar nga ky Plan.

4.6 Instrumentet për mbështetjen e përballueshmërisë dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura

Mund të kërkojnë instrumente shtesë zbatuese, për:

- konsolidimin e skemave ekzistuese të kompensimit;
- vendosjen e rregullave më të qarta për mbështetjen e përballueshmërisë;
- prezantimin e procedurave për parandalimin dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura;
- përcaktimin e ndërveprimit ndërmjet masave mbështetëse dhe planeve të pagesës; dhe
- sigurimin e koherencës ndërmjet mbështetjes sociale, praktikës së furnizuesve, dhe masave mbrojtëse rregullatore.

Këto instrumente do të zhvillohen në një mënyrë, në përputhje me kuadrin e klientit në nevojë dhe me objektivin më të gjerë të politikave, për uljen e varfërisë energjetike.

4.7 Instrumentet për masat strukturore që adresojnë varfërinë energjetike

Kuadri ligjor dhe i politikave i lidhur me performancën energjetike, rinovimin e ndërtesave dhe eficiencën e energjisë siguron bazën mundësuese për masat strukturore që synojnë uljen e faktorëve të varfërisë energjetike me kalimin e kohës. Instrumentet kryesore të tilla janë Plani Kombëtar i Rinovimit të Ndërtesave, i miratuar sipas nenit 5, të ligjit nr. 37/2025, mekanizmi i këshillimit dhe asistencës, i krijuar sipas nenit 31 të atij ligji, dhe skemat e detyrimit të eficiencës së energjisë dhe Fondi Kombëtar i Eficiencës së Energjisë, të cilat, në përputhje me prioritetin e dhënë klientëve në nevojë dhe me varfërinë energjetike sipas Direktivës së rishikuar mbi Eficiencën e Energjisë, do të orientojnë një pjesë të masave dhe financimit si prioritet drejt familjeve të identifikuara sipas shtojcës 2 të këtij Plani.

Këto instrumente mbështesin:

- synimin e familjeve me varfëri energjetike për masa strukturore, përfshirë katalogun e masave të zarfit mbështjellës, sistemeve të ngrohjes, zëvendësimit të pajisjeve, masave me kosto të ulët dhe energjisë së rinovueshme të përcaktuar në veprimin 6;
- zbatimin e ndërhyrjeve të eficiencës së energjisë në ndërtesa dhe familje;



- integrimin e konsideratave të varfërisë energjetike në planifikimin e rinovimit; dhe
- raportimin mbi efektin e këtyre masave në kushtet energjetike të familjeve.

4.8 Instrumentet e mbrojtjes dhe qeverisjes së të dhënave

Kuadri ligjor për mbrojtjen e të dhënave personale siguron bazën ligjore dhe kufijtë, për:

- krijimin dhe funksionimin e Regjistrit të Klientit në Nevojë dhe të Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike;

- shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve dhe operatorëve të sektorit të energjisë elektrike;

- mbrojtjen e të dhënave personale;
- ruajtjen dhe fshirjen e të dhënave; dhe
- kushtet sipas të cilave të dhënat mund të përdoren për monitorim ose vlerësim.

Të gjitha rregullimet e regjistrit dhe shkëmbimit të të dhënave sipas këtij Plani do të jenë në përputhje me këto kërkesa.

4.9 Instrumentet administrative dhe teknike

Përveç akteve ligjore dhe rregullatore, zbatimi i këtij Plani kërkon instrumente administrative dhe teknike, përfshirë:

- procedurat operacionale të regjistrit;
- formularët standardë dhe protokollet e verifikimit;
- rregullimet e shkëmbimit të të dhënave;
- procedurat e bashkëpunimit institucional;
- modelet e raportimit; dhe
- specifikimet teknike për funksionimin e sistemeve të regjistrit dhe monitorimit.

Këto instrumente sigurojnë që kuadri ligjor dhe i politikave të mund të zbatohet në mënyrë të njëtrajtshme në administrimin e përditshëm.

4.10 Roli funksional i instrumenteve mundësuese në këtë Plan

Të marra së bashku, instrumentet mundësuese të identifikuar në këtë seksion shërbejnë për katër funksione:

- krijojnë bazën ligjore për veprim;
- bëjnë operacional kuadrin e klientit në nevojë;
- mbështesin zbatimin e masave më të gjera që adresojnë varfërinë energjetike; dhe
- sigurojnë që masat mbrojtëse, masat mbështetëse dhe sistemet e monitorimit të mund të zbatohen në një mënyrë koherente, ligjore dhe administrativisht të zbatueshme.

5. ZBATIMI DHE KOORDINIMI

5.1 Qëllimi

Ky seksion përcakton rregullimet institucionale dhe qasjen e zbatimit për të vënë në jetë veprimet dhe instrumentet mundësuese sipas këtij Plani. Ai përcakton rolet përkatëse të institucioneve përgjegjëse, marrëdhënien operacionale ndërmjet dy kuadrove të krijuar nga Plani, dhe rregullimet për zbatimin, koordinimin, monitorimin dhe raportimin.

5.2 Koordinimi kombëtar

Koordinimi i përgjithshëm i këtij Plani do të udhëhiqet bashkërisht nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – respektivisht institucionet përgjegjëse për politikën e energjisë dhe për mbrojtjen sociale – nën autoritetin e Këshillit të Ministrave.

Ky koordinim i përbashkët do të sigurojë:

- harmonizimin ndërmjet kuadrit të varfërisë energjetike dhe kuadrit të klientit në nevojë;
- renditjen dhe koordinimin e masave ligjore, rregullatore dhe administrative;
- koordinimin ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore;
- koherencën ndërmjet hartimit të politikave dhe zbatimit operacional; dhe
- rishikimin e rregullt të progresit të zbatimit.

5.3 Përgjegjësitë institucionale

Institucionet përgjegjëse për mbrojtjen sociale do të jenë përgjegjëse, për:

- administrimin e procesit të njohjes së klientit në nevojë;
- mbajtjen e Regjistrit të Klientit në Nevojë;
- verifikimin e pranueshmërisë, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm;
- koordinimin me strukturat vendore të shërbimit social; dhe
- mbështetjen e zbatimit të masave të mbrojtjes sociale të lidhura me këtë Plan.

Institucionet përgjegjëse për politikën e energjisë do të jenë përgjegjëse, për:

- koordinimin e zbatimit të kuadrit më të gjerë të varfërisë energjetike;
- udhëheqjen e zhvillimit dhe integritetit të masave strukturore, përfshirë masat e eficiencës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave;
- sigurimin e harmonizimit ndërmjet këtij Plani dhe kuadrit më të gjerë të reformës energjetike; dhe



- mbështetjen e përgatitjes së masave zbatuese të kërkuara sipas këtij Plani.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) do të jetë përgjegjëse, për:

- ndërtimin, hostimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës teknike të Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike, përfshirë integrimin e tij me platformën shtetërore të ndërveprueshmërisë;

- garantimin e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara brenda Regjistrit, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për energjinë dhe ministrinë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale; dhe

- mbështetjen e ndërveprueshmërisë teknike të Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike me Regjistrin e Klientit në Nevojë dhe sisteme të tjera përkatëse shtetërore informacioni, brenda kufijve të përcaktuar në nenin 8, të shtojcës 2 dhe kuadrin ligjor të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave.

Enti Rregullator i Energjisë do të jetë përgjegjës, për:

- miratimin, rishikimin dhe zbatimin e kuadrin rregullator të lidhur me masat mbrojtëse për klientët;

- mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së furnizuesve dhe operatorit të shpërndarjes;

- monitorimin e zbatimit të masave mbrojtëse ndaj shkëputjes dhe detyrimeve të tjera përkatëse; dhe

- sigurimin e koherencës rregullatore me kuadrin ligjor të krijuar nga ky Plan.

Operatori i shpërndarjes dhe furnizuesit do të jenë përgjegjës, për:

- zbatimin e pasojave operacionale të statusit të klientit në nevojë;

- marrjen dhe përdorimin e informacionit të bazuar në regjistër, në përputhje me ligjin;

- zbatimin e masave mbrojtëse të zbatueshme, përfshirë ato të lidhura me shkëputjen, rregullimet e pagesës, dhe kushtet e furnizimit;

- mbështetjen e shkëmbimit të të dhënave dhe raportimit operacional; dhe

- pajtueshmërinë me rregullat rregullatore dhe administrative të miratuara sipas këtij Plani.

Autoriteti kombëtar statistikor dhe autoritetet e tjera kompetente do të jenë përgjegjëse, për:

- mbështetjen e prodhimit të vlerësimit bazë të varfërisë energjetike dhe produkteve periodike të monitorimit;

- sigurimin e koherencës metodologjike në raportimin statistikor; dhe

- kontribuimin në kuadrin e monitorimit dhe vlerësimit të krijuar sipas këtij Plani.

Bashkitë dhe strukturat vendore të shërbimit social do të mbështesin:

- ndërgjegjësimin dhe komunikimin me familjet;

- pritjen dhe asistencën për aplikimet kur është e zbatueshme;

- mbështetjen e verifikimit në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm;

- përditësimin e të dhënave mbi cilësinë e banesave dhe familjeve të identifikuara në nivel vendor brenda Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike, në përputhje me nenin 10 të shtojcës 2; dhe

- koordinimin me institucionet qendrore në dhënien praktike të masave.

5.4 Arkitektura e dyfishtë e zbatimit

Zbatimi i këtij Plani do të bazohet në dy sisteme operacionale të veçanta por të lidhura me njëra-tjetrën.

I pari është Regjistri i Klientit në Nevojë. Ky është sistemi ligjor dhe administrativ përmes të cilit njihet, regjistrohet, transmetohet dhe zbatohet statusi i klientit në nevojë për qëllimet e mbrojtjes dhe mbështetjes në sektorin e energjisë elektrike.

I dyti është sistemi i monitorimit të varfërisë energjetike, i mbështetur në Regjistrin Kombëtar të Varfërisë Energjetike të krijuar sipas nenit 8, të shtojcës 2. Ky është sistemi statistikor dhe i politikave përmes të cilit identifikohet, matet, monitorohet dhe vlerësohet varfëria energjetike për qëllime synimi, hartimi të politikave, ndërhyrjeje strukturore dhe vlerësimi.

Dy sistemet do të mbeten funksionalisht të dallueshme.

- Regjistri i Klientit në Nevojë do të përdoret ekskluzivisht për njohjen ligjore, administrimin e statusit, dhe zbatimin e të drejtave dhe masave mbrojtëse në sektorin e energjisë elektrike.

- Sistemi i monitorimit të varfërisë energjetike do të përdoret për qëllime analitike, politikash, synimi dhe vlerësimi.

Çdo ndërveprim ndërmjet dy sistemeve do të kufizohet në atë që është e nevojshme për planifikim, koordinim ose vlerësim, dhe do të jetë subjekt i masave mbrojtëse ligjore dhe të mbrojtjes së të dhënave të zbatueshme.



5.5 Qasja e zbatimit

Zbatimi i këtij Plani do të vazhdojë përmes shtigjeve paralele dhe të koordinuara të zbatimit, në vend të fazave strikte të ndara.

Shtegu i parë lidhet me krijimin e kuadrit të varfërisë energjetike. Kjo përfshin miratimin e metodologjisë kombëtare, krijimin e Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike, përgatitjen e vlerësimit bazë, krijimin e ciklit të monitorimit, dhe prodhimin e kuadrit të raportimit të kërkuar për identifikimin, ndjekjen dhe vlerësimin e varfërisë energjetike.

Shtegu i dytë lidhet me operacionalizimin e kuadrit të klientit në nevojë. Kjo përfshin miratimin e vendimit të Këshillit të Ministrave të kërkuar sipas nenit 95 të Ligjit për Sektorin e Energjisë Elektrike, krijimin e Regjistrit të Klientit në Nevojë, zhvillimin e procedurave të nevojshme të shkëmbimit të të dhënave, dhe harmonizimin e procedurave përkatëse rregullatore dhe të furnizuesve.

Shtegu i tretë lidhet me konsolidimin dhe dhënien e masave mbrojtëse dhe mbështetëse. Kjo përfshin rishikimin dhe harmonizimin e masave ekzistuese të kompensimit, zbatimin e masave mbrojtëse për klientët, përfshirë mbrojtjen nga shkëputja, prezantimin e procedurave të njëtrajtshme të menaxhimit të detyrimeve të prapambetura, dhe dhënien e rregullimeve përkatëse mbështetëse.

Shtegu i katërt lidhet me masat strukturore për uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës. Kjo përfshin integrimin e konsideratave të varfërisë energjetike në masat e eficientës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave, zhvillimin e ndërhyrjeve të synuara për familjet e prekura nga varfëria energjetike, dhe monitorimin e efektit të tyre në kushtet energjetike të familjeve.

Këto shtigje do të zbatohen në mënyrë të koordinuar. Renditja e tyre do të pasqyrojë varësitë ligjore, gatishmërinë institucionale, dhe nevojën për të siguruar koherencë ndërmjet kuadrit të varfërisë energjetike dhe kuadrit të klientit në nevojë.

5.6 Zbatimi administrativ

Zbatimi administrativ sipas këtij Plani do të kërkojë procedura operationale të qarta dhe të njëtrajtshme ndërmjet institucioneve. Këto do të përfshijnë:

- procedura standarde për aplikimin, njohjen, rishikimin, pezullimin dhe çregjistrimin e statusit të klientit në nevojë;

- procedura standarde për transmetimin dhe verifikimin e të dhënave;

- procedura standarde për zbatimin e masave mbështetëse dhe mbrojtëse nga furnizuesit dhe operatori i shpërndarjes;

- procedura standarde për trajtimin e ankimeve, rregullimet e pagesës, dhe masat mbrojtëse operationale të lidhura; dhe

- procedura standarde për raportimin, ndjekjen, dhe veprimin korrigjues.

Këto procedura do të dokumentohen dhe, kur është e nevojshme, do të miratohen përmes akteve përkatëse administrative ose teknike.

5.7 Komunikimi publik dhe akses i familjeve

Zbatimi i këtij Plani do të mbështetet nga një qasje e strukturuar komunikimi dhe ndërgjegjësimi, në mënyrë që familjet të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të kenë akses në masat përkatëse.

Kjo do të përfshijë:

- informacion mbi statusin e klientit në nevojë dhe kushtet për njohjen;

- informacion mbi të drejtat, masat mbrojtëse, dhe mekanizmat e ankimit;

- informacion mbi ekzistencën dhe qëllimin e monitorimit të varfërisë energjetike;

- informacion mbi masat e mbështetjes së disponueshme, përfshirë masat strukturore kur janë të zbatueshme; dhe

- asistencë praktike përmes kanaleve vendore dhe institucionale kur është e nevojshme.

Komunikimi do të hartohet në mënyrë që dallimi ndërmjet kuadrit të varfërisë energjetike dhe kuadrit të klientit në nevojë të mbetet i qartë për familjet dhe institucionet zbatuese.

5.8 Monitorimi dhe raportimi

Zbatimi sipas këtij Plani do të monitorohet përmes një kuadri të strukturuar raportimi.

Monitorimi do të funksionojë në tre nivele.

Niveli i parë do të mbulojë pajtueshmërinë operationale dhe do të fokusohet, në:

- funksionalitetin e regjistrit;

- shpejtësinë dhe saktësinë e shkëmbimit të të dhënave;

- pajtueshmërinë e furnizuesve dhe operatorit të shpërndarjes;

- zbatimin e masave mbrojtëse, përfshirë ato të lidhura me shkëputjen; dhe

- funksionimin e ankimeve dhe rregullimeve të pagesës.



Niveli i dytë do të mbulojë performancën e programit dhe do të fokusohet, në:

- mbulimin e masave mbështetëse;
- përshtatshmërinë e mbështetjes;
- tendencat e detyrimeve të prapambetura;
- eficiencën operacionale; dhe
- koherencën e zbatimit ndërmjet institucioneve.

Niveli i tretë do të mbulojë rezultatet e politikave dhe sociale dhe do të fokusohet, në:

- tendencat e varfërisë energjetike, duke u bazuar në Raportin Vjetor të Riskut të Varfërisë Energjetike të përgatitur sipas nenit 16, të shtojcës 2;
- grupet prioritare dhe faktorët strukturorë;
- shtrirjen dhe efektin e masave strukturore; dhe
- shkallën në të cilën masat sipas këtij Planit kontribuojnë në uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

5.9 Rishikimi vjetor dhe përshtatja

Zbatimi i këtij Planit do të jetë subjekt i rishikimit vjetor. Raporti vjetor i zbatimit, do të:

- vlerësojë progresin kundrejt veprimeve dhe afateve të Planit;
- identifikojë boshllëqet dhe pengesat e zbatimit;
- rishikojë funksionimin e kuadrit të klientit në nevojë;
- rishikojë zhvillimet dhe tendencat e varfërisë energjetike; dhe
- propozojë përshtatje në masat e zbatimit, renditjen ose instrumentet mbështetëse, kur është e nevojshme.

Ky proces rishikimi do të mbështesë përmirësimin e vazhdueshëm të zbatimit, duke ruajtur njëkohësisht strukturën dhe objektivat e përgjithshme të Planit.

SHTOJCA 1

MATRICA E REZULTATEVE DHE ZBATIMIT

Kjo shtojcë konsolidon, për çdo veprim të përcaktuar në seksionin 3, rezultatit kryesor, institucionet drejtuese, instrumentet kryesore mundësuese, afatin kohor indikativ dhe treguesit kyç kundrejt të cilëve do të monitorohet zbatimi.

Veprimi	Rezultati kryesor	Institucionet drejtuese	Instrumentet kryesore mundësuese	Afati	Treguesit kyç
Veprimi 1. Krijimi dhe operacionalizimi i metodologjisë kombëtare, vlerësimit bazë dhe kuadrit të monitorimit për varfërinë energjetike	Metodologjia kombëtare e krijuar, Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike operacional, akti zbatues i miratuar, vlerësimi bazë i përgatitur, dhe kuadri i monitorimit në funksion	MIE, në bashkërendim me INSTAT-in, MSHMS-në, dhe AKSHI-n	Metodologjia e shtojcës 2; Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike (nenet 8–10); metodologjia e përcaktimit LIHC (neni 11); akti zbatues sipas nenit 22(7) të ligjit nr. 37/2025; rregullimet administrative të raportimit	Deri në fund të 2026-ës-ës	Metodologjia e krijuar; Regjistri operacional me 5 modulet e të dhënave të plotësuar; pragjet LIHC të publikuara; akti zbatues i miratuar; vlerësimi bazë i përgatitur dhe publikuar; Raporti Vjetor i Riskut të Varfërisë Energjetike i lëshuar deri më 30 prill
Veprimi 2. Miratimi i vendimit të Këshillit të Ministrave të kërkuar sipas nenit 95 për operacionalizimin e statusit të klientit në nevojë	Kuadri ligjor i kriterëve, procedurave dhe trajtimit për statusin e klientit në nevojë i miratuar	MSHMS-ja, MIE, dhe Ministria e Financave	Projektvendimi mbi kriteret dhe procedurat për statusin e klientit në nevojë (vendimi zbatues i nenit 95)	Deri në fund të 2026-ës-ës	Vendimi i miratuar; kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara; procedurat për njohjen, rishikimin, pezullimin dhe çregjistrimin të krijuara; kuadri i trajtimit i përcaktuar
Veprimi 3. Operacionalizimi i regjistrit të klientit në nevojë dhe shkëmbimi	Regjistri i Klientit në Nevojë i krijuar dhe funksional, me shkëmbim të rregullt të të	MSHMS, në bashkërendim me operatorin e shpërndarjes dhe furnizuesit	Vendimi zbatues i nenit 95; procedurat operacionale të regjistrit; protokollet e shkëmbimit të të	Deri në fund të 2027-ës	Regjistri operacional; shkëmbimi i të dhënave funksionale; cikli i përditësimit të krijuar; gjurma e auditimit funksional; gabimet



Veprimi	Rezultati kryesor	Institucionet drejtuese	Instrumentet kryesore mundësuese	Afati	Treguesit kyç
ndërveprues i të dhënave	dhënave drejt operatorëve të sektorit të energjisë elektrike		dhënave; masat mbrojtëse të të dhënave		operacionale dhe koha e korigjimit të monitoruar
Veprimi 4. Konsolidimi dhe përmirësimi i mbështetjes për përballueshmërinë e klientëve në nevojë	Paketë koherente mbështetjeje për përballueshmërinë në funksion për klientët e njohur në nevojë dhe familjet e tjera të prekura nga varfëria energjetike	MSHMS-ja, Ministria e Financave, dhe MIE	Vendimet ekzistuese të kompensimit; instrumentet e rishikuara të mbështetjes; procedurat administrative për mbështetjen dhe menaxhimin e detyrimeve të prapambetura	2027–2028	Skemat ekzistuese të rishikuara; paketa e mbështetjes e harmonizuar me Planin; numri i familjeve të mbështetura, i monitoruar; përshtatshmëria e mbështetjes e vlerësuar; tendencat e detyrimeve të prapambetura të ndjekura
Veprimi 5. Aktivizimi dhe forcimi i mbrojtjes ndaj shpërbërjes dhe praktikave të padrejta të furnizimit	Masat mbrojtëse për klientët, plotësisht të zbatuara në praktikë për klientët e njohur në nevojë	ERE, operatori i shpërndarjes, dhe furnizuesit	Rregullat rregullatore mbi ndërprerjen e furnizimit; kushtet e shërbimit universal; vendimi zbatues i nenit 95; procedurat operacionale të furnizuesve dhe operatorit të shpërndarjes	Deri në fund të 2026-ës	Rregullat mbrojtëse të harmonizuara dhe zbatuara; njoftimet, shpërbërjet, rilidhjet dhe ankimitet, të monitoruara; shkeljet e pajtueshmërisë të identifikuar dhe adresuara
Veprimi 6. Ulja e faktorëve strukturorë të varfërisë energjetike përmes masave të orientuara të eficientës së energjisë dhe rinovimit të ndërtesave	Masa mbështetëse strukturore të zbatuara për familjet e prekura nga varfëria energjetike	MIE, në bashkërendim me institucionet përgjegjëse për eficientën e energjisë, zbatimin e lidhur me strehimin, dhe dhënien në nivel vendor	Plani Kombëtar i Rinovimit të Ndërtesave; mekanizmi i këshillimit dhe asistencës (neni 31, i ligjit nr. 37/2025); skemat e detyrimit të eficientës së energjisë dhe Fondi Kombëtar i Eficientës së Energjisë; rregullimet e financimit; synimi i bazuar në shtojcën 2 dhe Regjistrin Kombëtar të Varfërisë Energjetike	2028–2030	Numri i familjeve që përfitojnë nga masat e zarfit mbështetëse, sistemeve të ngrohjes, zëvendësimit të pajisjeve dhe burimeve të rinovueshme; lloji i ndërhyrjeve të dhëna; efektet në kushtet energjetike të familjeve të monitoruara; kursimet e energjisë dhe ndikimi në përballueshmëri të vlerësuar
Veprimi 7. Krijimi i qeverisjes, koordinimit, komunikimit publik dhe vlerësimit	Sistemi i qeverisjes dhe koordinimit, i krijuar dhe funksional në të gjithë Planin	MIE dhe MSHMS-ja, me pjesëmarrjen e ERE-s, INSTAT-t, AKSHI-t, dhe institucioneve të tjera përkatëse	Rregullimet e qeverisjes; kuadri i raportimit; masat e komunikimit dhe ndërgjegjësimin; procedurat e koordinimit institucional	Deri në fund të 2026-ës dhe në vazhdimësi	Struktura e koordinimit, e krijuar; raporti vjetor i zbatimit, i prodhuar; masat e komunikimit të dhëna; progresi i zbatimit, i rishikuar rregullisht



SHTOJCA 2

METODOLOGJIA PËR IDENTIFIKIMIN
DHE MONITORIMIN E VARFËRISË
ENERGJETIKE

Kjo shtojcë përcakton kuadrin metodologjik kombëtar për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të nenit 22(7), të ligjit nr. 37/2025, “Për performancën energjetike të ndërtesave”. Ajo përcakton njësinë e vlerësimit dhe kriteret e vlerësimit (nenet 4–7), arkitekturën institucionale për mbledhjen e të dhënave përmes Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike (nenet 8–10), përcaktimin operacional të varfërisë energjetike përmes treguesit të të Ardhurave të Ulëta dhe Kostos së Lartë (LIHC) (neni 11), burimet e të dhënave, përgjegjësitë institucionale, monitorimin dhe raportimin (nenet 12–16), dhe përdorimin e rezultateve për qëllime politikash dhe zbatimin (nenet 17–18).

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i kësaj metodologjie është të përcaktojë kuadrin për identifikimin dhe monitorimin e familjeve të prekura nga ose në rrezik të varfërisë energjetike në Republikën e Shqipërisë, të vendosë bazën për monitorimin dhe raportimin, dhe të mbështesë synimin e politikave, hartimin, koordinimin dhe vlerësimin e masave që trajtojnë varfërinë energjetike, përfshirë masat strukturore dhe koordinimin më të gjerë të masave mbrojtëse të zbatueshme për klientët në nevojë, në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm.

Neni 2
Baza ligjore

Kjo metodologji mbështetet në aktet ligjore të mëposhtme:

- Ligji nr. 37/2025, “Për performancën energjetike të ndërtesave”, në veçanti: neni 4, i cili përcakton varfërinë energjetike; neni 22(7), i cili kërkon miratimin, me vendim të Këshillit të Ministrave, të rregullave për monitorimin dhe raportimin mbi varfërinë energjetike, duke përfshirë treguesit, burimet e të dhënave dhe shpeshësinë e

raportimit; neni 6(13), i cili parashikon që kërkesat për performancën energjetike të shoqërohen me masa financiare, asistencë teknike dhe masa që trajtojnë pengesat, me vëmendje të veçantë për familjet e prekura nga varfëria energjetike; neni 5, mbi Planin Kombëtar të Rinovimit të Ndërtesave; dhe neni 31, i cili parashikon këshillim dhe asistencë për performancën energjetike të ndërtesave, me shërbime të dedikuara për familjet në nevojë dhe familjet e prekura nga varfëria energjetike.

- Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, në veçanti neni 95, i cili përcakton kuadrin për njohjen dhe trajtimin e klientëve në nevojë dhe kërkon që Këshilli i Ministrave të përcaktojë kriteret dhe procedurat e zbatueshme.

- Ligji nr. 57/2019, “Për ndihmën sociale”, i cili krijon sistemin për identifikimin dhe verifikimin e familjeve në nevojë përmes sistemit të ndihmës sociale dhe siguron bazën administrative për synimin social.

Neni 3
Përkufizime

Për qëllimet e kësaj metodologjie:

- “**Varfëria energjetike**” ka kuptimin e përcaktuar në nenin 4, të ligjit nr. 37/2025.

- “**Klientë në nevojë**” do të kenë kuptimin e përcaktuar në nenin 95, të ligjit nr. 43/2015 dhe aktet zbatuese të miratuara në zbatim të tij.

- “**Familje**” do të thotë një njësi banimi e vlerësuar si një njësi e vetme për qëllimet e gjendjes socio-ekonomike, konsumit të energjisë dhe karakteristikave të banesës, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

- “**Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike**” do të thotë platforma ndërinstitucionale e informacionit e krijuar sipas nenit 8 të kësaj metodologjie.

- “**Kostoja e Nevojshme e Energjisë**”, “**Të Ardhurat Neto pas Kostove të Energjisë**”, dhe treguesi i “**të Ardhurave të Ulëta dhe Kostos së Lartë**” do të kenë kuptimet e përcaktuara në nenin 11 të kësaj metodologjie.

Neni 4
Njësia e vlerësimit

Identifikimi i varfërisë energjetike do të kryhet në nivelin e familjes.



Përdorimi i familjes si njësi e vlerësimit pasqyron përkufizimin ligjor të varfërisë energjetike sipas ligjit nr. 37/2025, i cili ndërthur të ardhurat, shpenzimet për energji dhe karakteristikat e banesës, të cilat të gjitha vlerësohen në nivel familjeje. Ai është, gjithashtu, në përputhje me kuadrin e përcaktuar sipas ligjit nr. 57/2019, i cili identifikon dhe verifikon familjet në nevojë përmes sistemit të mbrojtjes sociale, si dhe me zbatimin e statusit të klientit sipas ligjit nr. 43/2015, i cili lidhet me konsumin e energjisë elektrike të familjes.

Rrjedhimisht, familja do të përbëjë njësinë e vlerësimit për qëllimet e identifikimit, monitorimit dhe raportimit mbi varfërinë energjetike.

Neni 5

Kriteret e vlerësimit

Identifikimi i familjeve të prekura nga varfëria energjetike bazohet në vlerësimin e kombinuar të elementeve të përcaktuara në përkufizimin e varfërisë energjetike sipas ligjit nr. 37/2025, duke pasqyruar ndërveprimin ndërmjet gjendjes socio-ekonomike, shpenzimeve për energji dhe performancës energjetike të banesës.

Për qëllimet e kësaj metodologjie, vlerësimi do të bazohet në kriteret e mëposhtme:

- gjendja socio-ekonomike e familjes, përfshirë të ardhurat dhe statusin sipas sistemit të ndihmës sociale ose kategorive të tjera të verifikuara të mbrojtjes sociale;

- niveli i shpenzimeve të energjisë të përballuara nga familja, bazuar në të dhënat e disponueshme mbi konsumin e energjisë së familjes dhe kostot përkatëse; dhe

- performanca energjetike e banesës, bazuar në të dhëna që lidhen me ndërtesën, duke përfshirë certifikatat e performancës energjetike, regjistrat, ose burime administrative ekuivalente të përcaktuara sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm.

Kjo metodologji përcakton kuadrin për identifikimin dhe monitorimin e varfërisë energjetike. Zbatimi i saj operacional, duke përfshirë treguesit e detajuar, pragjet, burimet e të dhënave, metodat e llogaritjes, formatin e raportimit dhe shpeshësinë e raportimit, përcaktohet në nenet 8–11, më poshtë, dhe do të specifikohet më tej në aktin zbatues të miratuar në mbështetje të nenit 22(7), të ligjit nr. 37/2025.

Vlerësimi i kryer sipas kësaj metodologjie do t'u shërbejë qëllimeve të identifikimit, monitorimit dhe orientimit të politikave dhe do të zbatohet pa cenuar kriteret e veçanta ligjore që rregullojnë njohjen e klientëve në nevojë sipas ligjit nr. 43/2015.

Neni 6

Identifikimi dhe klasifikimi i familjeve

Identifikimi i familjeve të prekura nga varfëria energjetike do të kryhet në bazë të vlerësimit të përcaktuar në nenin 5.

Një familje do të konsiderohet e prekur nga varfëria energjetike kur vlerësimi i kombinuar i gjendjes socio-ekonomike, shpenzimeve të energjisë dhe performancës së banesës tregon se familja nuk është në gjendje të sigurojë akses në shërbimet thelbësore të energjisë, në përputhje me përkufizimin e përcaktuar në ligjin nr. 37/2025.

Një familje do të konsiderohet në rrezik të varfërisë energjetike kur vlerësimi tregon praninë e një ose më shumë kriterëve të përcaktuara në nenin 5 në një mënyrë që mund të çojë në pamundësi për të siguruar shërbimet thelbësore të energjisë.

Dallimi ndërmjet familjeve të prekura nga varfëria energjetike dhe familjeve në rrezik të varfërisë energjetike do të përdoret për qëllime monitorimi dhe për prioritetizimin e masave të politikave, duke përfshirë ndërhyrjet për eficiencën e energjisë dhe koordinimin më të gjerë të masave të zbatueshme për konsumatorët I sipas kuadrit ligjor përkatës.

Neni 7

Marrëdhënia me kuadrin për konsumatorët I

Identifikimi i familjeve të prekura nga varfëria energjetike sipas kësaj metodologjie bëhet pa paragjykuar kuadrin ligjor që rregullon njohjen dhe trajtimin e klientëve në nevojë sipas ligjit nr. 43/2015 dhe akteve zbatuese të miratuara në bazë të atij ligji.

Familjet e identifikuara si klientë në nevojë, në përputhje me nenin 95, të ligjit nr. 43/2015, mund të përputhen në masë të konsiderueshme me familjet e prekura nga ose në rrezik të varfërisë energjetike. Për qëllimet e monitorimit dhe koordinimit të politikave, marrëdhënia ndërmjet dy grupeve do të vlerësohet dhe raportohet në një



mënyrë, në përputhje me bazën e veçantë ligjore, qëllimin dhe funksionin e secilit kuadër.

Kriteret, procedurat dhe të drejtat që lidhen me statusin e klientit në nevojë, përfshirë masat mbrojtëse dhe kushtet e furnizimit, rregullohen ekskluzivisht nga legjislacioni i zbatueshëm i sektorit të energjisë elektrike dhe aktet zbatuese.

Kjo metodologji do të sigurojë kuadrin më të gjerë të nevojshëm për të mbështetur hartimin e politikave, synimin, monitorimin dhe vlerësimin, në lidhje me varfërinë energjetike dhe koordinimin më të gjerë të masave të zbatueshme për konsumatorët l.

Neni 8

Krijimi i Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike

Krijohet me këtë Grupi Ndërinstitucional i Përhershëm i Punës, i përbërë nga përfaqësues të ministrisë përgjegjëse për energjinë, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, INSTAT-i, Entit Rregullator të Energjisë (ERE), Operatorit të Shpërndarjes dhe Furnizimit të Energjisë Elektrike (OSHEE), ministrisë përgjegjëse për financat dhe Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë. Grupi i Punës do të jetë përgjegjës për hartimin e matricës së saktë ndërinstitucionale të shkëmbimit të të dhënave, dhe për përditësimin e rregullt, monitorimin dhe zbatimin e kuadrit kombëtar për uljen e varfërisë energjetike, duke përfshirë këtë metodologji dhe Planin e Veprimit për Varfërinë Energjetike.

Krijohet me këtë Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike, si një platformë ndërinstitucionale ndërvepruese, nën drejtimin e ministrisë përgjegjëse për energjinë, në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), INSTAT-in, OSHEE-n dhe operatorët e furnizimit të energjisë elektrike, Entin Rregullator të Energjisë, dhe të gjitha bashkitë.

Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike është pjesë e arkitekturës shtetërore të informacionit.

AKSHI parashikohet përgjegjës për ndërtimin e platformës softuerike, integrimin e saj në sistemin shtetëror (përfshirë, kur është e zbatueshme, përmes platformës së ndërveprueshmërisë *Government Gateway*), dhe garantimin e sigurisë së të dhënave personale, në përputhje me legjislacionin e zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale menaxhon Regjistrin Kombëtar të Ndihmës Ekonomike. Ky Regjistër do të ushqejë automatikisht Regjistrin Kombëtar të Varfërisë Energjetike me listën e familjeve që trajtohen si l ose që marrin kompensim për energjinë.

Neni 9

Modulet dhe parametrat bazë të të dhënave të Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike

Regjistri Kombëtar i Varfërisë Energjetike strukturohet mbi një bazë të dhënash të standardizuara, e organizuar në pesë module kryesore të të dhënave, të cilat së bashku mundësojnë llogaritjen e treguesve objektivë në veçanti treguesin e të Ardhurave të Ulëta dhe Kostos së Lartë të përcaktuar në nenin 11 dhe monitorimin e treguesve subjektivë.

Moduli I. Të dhënat identifikuese dhe gjeografike

Ky modul bën mbledhjen dhe përpunimin e vendndodhjes gjeografike të familjeve me statusin e varfërisë energjetike dhe përfshin:

- ID-në e kryefamiljarit; kodin e ndërtesës dhe lidhjen me Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile dhe Kadastrën;

- vendndodhjen administrative (bashkia, njësia administrative, dhe lagja/fshati); zonën klimatike, e klasifikuar në përputhje me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave, meqenëse vendndodhja ndikon drejtpërdrejt në nevojat për ngrohje/ftohje dhe, deri diku, edhe në nevojat për ujë të ngrohtë;

- dhe përbërjen e familjes, duke përfshirë numrin e anëtarëve, numrin e fëmijëve, numrin e personave mbi 65 vjeç, dhe numrin e personave me aftësi të kufizuara, këto të fundit si faktorë rreziku ndaj temperaturave ekstreme.

Moduli II. Të ardhurat dhe statusi social

Të dhënat e këtij moduli përdoren për të përcaktuar nëse familja bie nën kufirin e varfërisë pasi paguan për energjinë, dhe përfshijnë: të ardhurat totale mujore të familjes, duke përfshirë të ardhurat nga pagat, pensionet, remitancat (nëse ka), dhe të ardhurat nga aktivitete të ndryshme ekonomike, përfshirë të ardhurat nga fermat bujqësore familjare; statusin e ndihmës sociale, që tregon nëse familja është pjesë e skemës së Ndihmës Ekonomike ose merr trajtim tjetër social; dhe kostot



e strehimit, që përfshijnë pagesat mujore për qira ose këste kredie për banesën (të zbritura përpara llogaritjes së treguesit sipas nenit 11).

Moduli III. Karakteristikat e banesës

Ky modul regjistron tipin e ngrohjes së banesës (elektrik, dru, LPG, gaz, ose pelet) dhe statusin e izolimit termik (po/jo), të vendosur përmes anketave (INSTAT) ose auditimeve teknike vendore.

Moduli IV. Konsumi dhe statusi i pagesave

Ky modul regjistron konsumin dimëror të energjisë elektrike (kwh) dhe statusin debitor/të detyrimeve të prapambetura, të marra nga OSHEE-ja dhe FSHU-ja (furnizuesi i shërbimit universal).

Moduli V. Perceptimi subjektiv

Ky modul regjistron tregues të vetëdeklaruar të standardizuar, përkatësisht:

- komoditeti termik në dimër/verë: vetëdeklarim nëse banesa mund të mbahet ngrohtë mjaftueshëm,

i standardizuar si: “gjithmonë”, “ndonjëherë” ose “asnjëherë”;

- prania e lagështisë/mykut: deklaram i problemeve strukturore në banesë që ndikojnë në shëndet, i standardizuar si “pikime të mëdha të çatisë”, “mykje në pjesë të ndryshme të ndërtesës”, ose “gjendje normale (pa pikime dhe pa myk)”; dhe

- sakrifica e konsumit (vullnetare): deklaram nga kryefamiljari nëse ka fukur qëllimisht sistemin e ngrohjes ose ujin e ngrohtë, ose ka reduktuar numrin e dusheve në javë, për të paguar faturën e energjisë.

Matrica e përmbledhur e parametrave për strukturimin e softuerit të Regjistrat Kombëtar të Varfërisë Energjetike (nëse do të ndërtohet si databazë, përfshirë nga AKSHI) jepet në tabelën 1, më poshtë:

Nr.	Moduli	Parametri (fusha)	Lloji i të dhënave	Burimi i të dhënave
I.	Demografia	ID_Konsumatori/ID_Banesa	Alfanumerik (unik)	Gjendja Civile/Kadastra
		Zona_Klimatike	Kategori (A/B/C)	Ministria/Hartat zyrtare
II.	Ekonomia	Te_Ardhurat_Mujore	Monetar (lekë)	Tatimet/Vetëdeklarim
		Statusi_NE	Cilësor (po/jo)	Regjistri i Ndihmës Ekonomike
III.	Banesa	Tipi_Ngrohjes	Kategori (elektrik/dru/LPG/gaz/pelet)	Anketa (INSTAT-)
		Izolim_Termik	Cilësor (po/jo)	Auditim/anketë lokale
IV.	Konsumi	Konsumi_kWh_Dimer	Numerik	OSHEE-ja/FSHU-ja
		Statusi_Debitor	Cilësor/nr. faturash të papaguara	OSHEE-ja/FSHU-ja
V.	Perceptimi	Veshtiresi_Ngrohje	Shkallë (1 deri 3): gjithmonë, ndonjëherë, asnjëherë	Anketë subjektive (SILC/INSTAT)

Bazuar në të gjithë treguesit e përmendur në këtë nen, ministria përgjegjëse për energjinë përgatit Raportin Vjetor të Riskut të Varfërisë Energjetike të përmendur në nenin 16, i cili shërben për planifikimin e saktë trevjeçar të fondeve të eficiencës së energjisë për familjet e klasifikuara sipas statusit të performancës energjetike të banesës, në bashkërendim me veprimin 6 të Planit të cilit i bashkëngjitet kjo metodologji.

Neni 10

Përditësimi i Regjistrat Kombëtar të Varfërisë Energjetike

Të dhënat socio-ekonomike përditësohen deri më 30 prill të çdo viti, për vitin paraardhës, nga ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale dhe nga INSTAT-i apo edhe automatikisht nga sistemet qeveritare të të dhënave, si më poshtë:

- ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale realizon përditësimin e të



dhënave përkatëse, bazuar në Regjistrin Kombëtar të Ndihmës Ekonomike për vitin paraardhës; dhe

- INSTAT-i furnizon Regjistrin me të dhënat e përditësuara të anketave (SILC dhe HBS) në nivel makro, për të rregulluar pragjet e varfërisë për vitin paraardhës.

Furnizuesit e energjisë, OSHEE-ja dhe FSHU-ja, realizojnë përditësimin e të dhënave të konsumit dhe pagesave, si më poshtë:

- OSHEE-ja përditëson të dhënat e konsumit mujor të energjisë elektrike për vitin paraardhës, deri më 30 prill, bazuar në të dhënat reale të konsumit (në kwh/muaj); dhe

- OSHEE-ja përditëson të dhënat e pagesave mujore për vitin paraardhës, deri më 30 prill, bazuar në faturat nominale dhe historikun e vonesave në pagesa ose detyrimeve të prapambetura të familjeve në nevojë të regjistruara në sistem.

Bashkitë përditësojnë Regjistrin, përmes drejtorive të shërbimit social dhe zyrave të emergjencave ose planifikimit urban, deri më 30 prill, si më poshtë:

- përditësojnë dhe identifikojnë familjet që mund të jenë në varfëri energjetike për vitin paraardhës, por që nuk përfshihen në skemat standarde të ndihmës ekonomike; dhe

- përditësojnë në sistem të dhëna mbi cilësinë e banesave (për shembull: nëse një ndërtesë është e dëmtuar, pa izolim, ose pjesë e programeve të rindërtimit/sociale) për vitin paraardhës.

Neni 11

Përcaktimi i varfërisë energjetike përmes treguesit të të Ardhurave të Ulëta dhe Kostos së Lartë

Ministria përgjegjëse për energjinë, vetë ose përmes Agjencive përcakton Koston e Nevojshme të Energjisë për kategori referente banesash rezidenciale, bazuar në planin kombëtar të Rinovimit Afatgjatë të Stokut të Ndërtesave. Kostoja e Nevojshme e Energjisë llogaritet në bazë, të:

- nevojave të energjisë të llogaritura nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë për katër kategoritë referente të banesave rezidenciale, për të garantuar kushte normale komoditeti për

ngrohjen, gatimin, ujin e ngrohtë, ndriçimin, pajisjet kryesore elektroshtëpiake dhe ftohjen;

- çmimeve të drurit, LPG-së, naftës, dhe peletave, të përcaktuara nga Agjencia e Eficiencës së Energjisë, INSTAT-i apo tjetër institucion, bazuar në vlerat mesatare vjetore; dhe

- çmimit të energjisë elektrike për konsumatorët rezidencialë, të përcaktuar nga ERE bazuar në vlerat mesatare vjetore.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, me mbështetjen e INSTAT-it, llogarit të Ardhurat Neto pas Kostove të Energjisë (Ynet) sipas relacionit të mëposhtëm:

$$Ynet = T\text{ë Ardhurat Totale Familjare} - \text{Kostot e Strehimit (qira/kreditë)} - \text{Ereq}$$

Duke zbritur kostot e strehimit dhe Koston e Nevojshme të Energjisë nga të ardhurat totale të familjes, pjesa e mbetur përfaqëson shumën e të ardhurave që familja ka në dispozicion për nevoja të tjera thelbësore, si: ushqimi, shëndetësia, dhe arsimi.

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, me mbështetjen e INSTAT-it, realizon ekuivalentimin e të dhënave, duke përdorur konceptin e peshimit sipas madhësisë së familjes (si shkalla e OECD), në mënyrë që të lejohen krahasime të drejta të të ardhurave dhe kostove të energjisë ndërmjet familjeve me madhësi të ndryshme. Kjo është e nevojshme pasi një familje me katër anëtarë ka nevoja të ndryshme nga një person që jeton vetëm, ndërkohë që të dy mund të ndajnë kosto fikse të ngjashme (për shembull, ngrohjen e të njëjtës dhomë).

Ministria përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, me mbështetjen e INSTAT-it, përcakton pragjet dhe matricën sipas këtij neni, duke llogaritur koston mesatare kombëtare të ekuivalentuar të energjisë dhe prapun e varfërisë, si më poshtë:

- përcaktohet vlera mesatare kombëtare e pragut të koston të ekuivalentuar të energjisë;

- pragu i varfërisë vendoset në përqindje (p.sh. 60%) të vlerës mesatare kombëtare (medianës) të të ardhurave të mbetura, pas zbritjes së kostove të strehimit dhe energjisë;

- familjet që bien në kuadrantin LIHC (të ardhura të ulëta dhe kosto të larta) klasifikohen si familje me varfëri energjetike;

- familjet që bien në kuadrantin LILC (të Ardhura të Ulëta, Kosto të Ulëta) konsiderohen



në varfëri ekonomike, por jo domosdoshmërisht energjetike për shembull, familje me të ardhura të ulëta që jetojnë në banesa të vogla, me eficiencë të lartë ose në zona klimatike të ngrohta;

- familjet që bien në kuadrantin HIHC (të Ardhura të Larta, Kosto të Larta) konsiderohen se kanë të ardhura të mjaftueshme për t'i përballuar kostot e energjisë pa rrezikuar standardin e jetesës; dhe

- familjet që bien në kuadrantin HILC (të Ardhura të Larta, Kosto të Ulëta) konsiderohen në një situatë ekonomike të favorshme dhe energjetikisht eficiente.

Zbatimi i treguesit LIHC sipas këtij neni bëhet pa cenuar përdorimin, për qëllime krahasueshmërie, të treguesve plotësues të njohur në nivel evropian dhe të Komunitetit të Energjisë, përfshirë treguesin e barrës energjetike, treguesit M/2 dhe 2M, përqindjen e popullsisë që nuk është në gjendje të mbajë banesën e ngrohur mjaftueshëm, dhe incidencën e detyrimeve të prapambetura për faturat e shërbimeve, në përputhje me nenin 14.

Neni 12

Burimet e të dhënave dhe integrimi i të dhënave

Vlerësimi i varfërisë energjetike bazohet në përdorimin e të dhënave administrative dhe statistikore nga institucionet publike përkatëse, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 5 dhe njësinë e vlerësimit të përcaktuar në nenin 4.

Kuadri i vlerësimit do të integrojë, në masën e mundshme, burimet e mëposhtme të të dhënave:

- të dhëna mbi të ardhurat e familjes dhe statusin e ndihmës sociale, të nxjerra nga sistemi i mbrojtjes sociale;

- të dhënat mbi konsumin e energjisë elektrike dhe shpenzimet përkatëse, të ofruara nga operatorët e sektorit të energjisë elektrike; dhe

- të dhëna mbi performancën energjetike të banesave, duke përfshirë informacion nga certifikatat e performancës energjetike, regjistrat e ndërtesave ose burime administrative ekuivalente.

Të dhënat e mbledhura dhe të strukturuar përmes Regjistrat Kombëtar të Varfërisë Energjetike, të krijuar sipas neneve 8–10, do të përbëjnë burimin kryesor operacional të të dhënave për qëllimet e këtij neni.

Institucionet kompetente do të sigurojnë që të dhënat e përdorura për qëllimet e kësaj metodologjie të jenë të besueshme, konsistente, të përditësuara rregullisht dhe të përdoren në përputhje me kuadrin ligjor të zbatueshëm për mbrojtjen e të dhënave dhe shkëmbimin e të dhënave.

Integrimi i këtyre burimeve të të dhënave duhet të pasqyrojë natyrën e kombinuar të varfërisë energjetike, siç përcaktohet në ligjin nr. 37/2025, dhe duhet të lejojë një vlerësim të qëndrueshëm dhe të krahasueshëm me kalimin e kohës.

Neni 13

Përdorimi i sistemit të ndihmës sociale

Identifikimi i gjendjes socio-ekonomike të familjeve për qëllimet e kësaj metodologjie do të bazohet, në masën e mundshme, në sistemin ekzistues të ndihmës sociale të krijuar sipas ligjit nr. 57/2019.

Familjet që përfitojnë nga ndihma ekonomike, përfitimet e lidhura me aftësinë e kufizuar ose forma të tjera të njohura të mbrojtjes sociale, do të konsiderohen se përmbushin komponentin socio-ekonomik të vlerësimit të përcaktuar në nenin 5, subjekt i verifikimit përmes të dhënave administrative të disponueshme.

Përdorimi i sistemit të ndihmës sociale do të sigurojë:

- qëndrueshmëri në identifikimin e familjeve në nevojë;

- ulje të barrës administrative për institucionet dhe familjet; dhe

- mundësinë e përfshirjes automatike ose të thjeshtuar të familjeve të pranueshme në procesin e vlerësimit.

Neni 14

Zbatimi operacional i treguesve

Zbatimi operacional i kriterëve të përcaktuara në nenin 5 do të kryhet përmes treguesve, pragjeve dhe metodave të llogaritjes të përcaktuara në aktin zbatues të miratuar në mbështetje të nenit 22(7), të ligjit nr. 37/2025, duke u bazuar në metodologjinë LIHC të përcaktuar në nenin 11.

Këta tregues, do të:



- pasqyrojnë natyrën e kombinuar të varfërisë energjetike, duke integruar elemente socio-ekonomike, të shpenzimeve, dhe që lidhen me banesën;

- lejojnë identifikimin e familjeve të prekura nga varfëria energjetike dhe atyre në rrezik; dhe

- sigurojnë konsistencë me kalimin e kohës dhe krahasueshmëri përgjatë periudhave të raportimit.

Treguesit do të bazohen në burimet e disponueshme të të dhënave dhe do të projektohen për të mbështetur si monitorimin në nivel kombëtar, ashtu edhe synimin efektiv të masave të politikave.

Për qëllime krahasueshmërie me praktikën evropiane dhe rajonale, treguesit e zbatuar sipas kësaj metodologjie mund të krahasohen me treguesit kryesorë dhe ndihmës të rekomanduar nga Komisioni Evropian dhe nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë, përfshirë treguesin e barrës energjetike, treguesit M/2 dhe 2M, përqindjen e popullsisë që nuk është në gjendje të mbajë banesën e ngrohur mjaftueshëm, incidencën e detyrimeve të prapambetura për faturat e shërbimeve, dhe treguesit e cilësisë së banesës, si lagështia, pikimet, ose dëmtimet strukturore.

Neni 15

Përgjegjësitë institucionale dhe koordinimi

Zbatimi i kësaj metodologjie do të sigurohet përmes koordinimit ndërmjet ministrisë përgjegjëse për energjinë, ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë dhe mbrojtjen sociale, dhe institucioneve të tjera përkatëse, duke përfshirë autoritetin kombëtar statistikor, Entin Rregullator të Energjisë, Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit dhe operatorët e sektorit të energjisë elektrike, në veçanti përmes Grupit Ndërinstitucional të Përhershëm të Punës të krijuar sipas nenit 8.

Çdo institucion do të kontribuojë, brenda mandatit të tij përkatës, në:

- sigurimin dhe vlerësimin e të dhënave;
- zbatimin e kuadrit të vlerësimit; dhe
- përdorimin e rezultateve për hartimin dhe zbatimin e politikave.

Mekanizmat e koordinimit institucional do të krijohen për të siguruar:

- konsistencë në përdorimin e të dhënave dhe treguesve;

- harmonizim ndërmjet politikave të mbrojtjes sociale, energjisë dhe strehimit; dhe

- zbatim efektiv të masave që adresojnë varfërinë energjetike.

Neni 16

Monitorimi dhe raportimi

Monitorimi dhe raportimi për varfërinë energjetike do të kryhen në përputhje me nenin 22(7), të ligjit nr. 37/2025.

Autoriteti kompetent do të përgatisë raporte periodike, për:

- numrin e familjeve të prekura nga varfëria energjetike dhe atyre në rrezik;

- evolucionin e treguesve kyç me kalimin e kohës; dhe

- efektivitetin e masave të politikës të zbatuara.

Bazuar në treguesit e përmendur në këtë metodologji, në veçanti treguesin LIHC të përcaktuar në nenin 11, ministria përgjegjëse për energjinë përgatit Raportin Vjetor të Riskut të Varfërisë Energjetike për vitin paraardhës, deri më 30 prill. Ky raport shërben si bazë për planifikimin e saktë trevjeçar të fondeve të eficiencës së energjisë për familjet e klasifikuara sipas statusit të performancës energjetike të banesës, në bashkërendim me veprimin 6 të Planit të cilit i bashkëngjitet kjo metodologji.

Raportimi do të bazohet në metodologjinë dhe treguesit e përcaktuar sipas aktit zbatues përkatës dhe do të mbështesë hartimin e politikave të bazuara në prova, duke përfshirë hartimin, përshtatjen dhe vlerësimin e masave që trajtojnë varfërinë energjetike dhe bashkërendimin më të gjerë të masave të zbatueshme për konsumatorët l.

Neni 17

Përdorimi i rezultateve për masa politikash

Rezultatet e vlerësimit të kryer sipas kësaj metodologjie do të përdoren për të informuar hartimin, orientimin dhe vlerësimin e masave të politikave që trajtojnë varfërinë energjetike.

Masa të tilla do të përfshijnë:



- masa të mbështetjes financiare që synojnë uljen e barrës së shpenzimeve të energjisë;

- hartimin dhe koordinimin më të gjerë të masave mbrojtëse të zbatueshme për konsumatorët l, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, masat mbrojtëse që lidhen me kushtet e furnizimit sipas kuadrit ligjor të zbatueshëm; dhe

- ndërhyrje të eficiencës së energjisë që synojnë përmirësimin e performancës energjetike të banesave, sipas veprimit 6 të Planit të cilit i bashkëngjitet kjo metodologji.

Kjo metodologji do të mbështesë një qasje të koordinuar, sipas së cilës masat e menjëhershme mbrojtëse të zbatueshme për klientët në nevojë sipas kuadrit të sektorit të energjisë elektrike plotësohen nga masa strukturore që synojnë uljen e varfërisë energjetike me kalimin e kohës.

Neni 18 Zbatimi

Kjo metodologji do të shërbejë si bazë për:

- miratimin, me vendim të Këshillit të Ministrave, të kuadrit të monitorimit dhe raportimit në përputhje me nenin 22(7), të ligjit nr. 37/2025, duke përfshirë përkufizimin e treguesve, pragjeve, burimeve të të dhënave, metodave të llogaritjes, formatit të raportimit dhe shpeshtësisë së raportimit;

- krijimin dhe funksionimin e Regjistrit Kombëtar të Varfërisë Energjetike, në përputhje me nenet 8–10, përfshirë matricën ndërinstitucionale të shkëmbimit të të dhënave dhe rolin e AKSHI-t në zhvillimin e tij teknik;

- përgatitjen dhe publikimin e vlerësimit kombëtar bazë të varfërisë energjetike;

- vendosjen e ciklit të rregullt të monitorimit dhe raportimit mbi varfërinë energjetike, përfshirë Raportin Vjetor të Riskut të Varfërisë Energjetike të përmendur në nenin 16;

- zhvillimin dhe zbatimin e masave që trajtojnë varfërinë energjetike, dhe koordinimin me masat mbrojtëse të zbatueshme për klientët në nevojë, në përputhje me nenin 95, të ligjit nr. 43/2015 dhe masat e eficiencës së energjisë në përputhje me ligjin nr. 37/2025; dhe

- përgatitjen, zbatimin dhe përditësimin e Planit të Veprimit për Varfërinë Energjetike.

KËRKESË

Nr. 824/8, datë 22.7.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ajencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private që preken nga realizimi i projektit, ‘Rikualifikim urban, sheshi pranë shkollës ‘Martin Camaj’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Shkodër.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të përllogaritur për pasuritë e llojit “truall” dhe “ndërtesë social-ekonomike”, përllogaritur bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, i ndryshuar dhe vendimit nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat fizikë ose juridikë që preken nga realizimi i këtij projekti, emri i të cilëve pasqyrohet në tabelën e publikuar, si dhe personat fizikë ose juridikë, të cilët preken, por nuk figurojnë në këtë listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si dhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Bashkisë Shkodër, si dhe në Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake shpronësimi 6,305,869 lekë (gjashtë milionë e treqind e pesë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e nëntë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena



LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIM URBAN, SHESHI PRANË SHKOLLËS ‘MARTIN CAMAJ’”, ME SUBJEKT KËRKUES BASHKIA SHKODËR

Nr.	Pronari			Të dhëna kadastrale										Vlerësimet për shpronësim						Vlera totale (lekë)	Shënime (kuftizime hipotekore, barrë mbi pasuritë etj.)
	Emri	Atësia	Mbiemri	Qyteti	Z. kadastrale	Indeksi i hartës	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale (m²)	Truall (m²)	Ndërtesë (m²)	Volumi	Faqe	Truall=12,223 lekë/m² ZK 8594			Ndërtesë social-ekonomike ZK 8594 (vlerësuar me situacion punimesh)				
														Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F		G	H	I	J		K	L	M			Q	R	
1	VILFRED		PIRZHA	Shkodër	8594	N,O-8	5/380-ND	Ndërtesë	10	0	10	25	176	0	0	-	10	-	364,551	364,551	
2	MARJAN MARGARITA MARJANA NINETA SKENDER	PASHKO PASHKO PASHKO	KOTRRI KOTRRI VERBICA ISHIMAKU	Shkodër	8594	N,O-8	5/835	Truall	117.6	117.6	117.6	41	49	56	12,223.00	684,488	-	0	-	684,488	
3	SKENDER ADILE	SADIK HASAN	ISHIMAKEJ ISHIMAKEJ	Shkodër	8594	N,O-8	5/726	Tr.+nd.	22.4	22.4	22.4	9	49	22.4	12,223.00	273,795	22.4	-	998,336	1,272,132	
4	SHIET			Shkodër	8594	N,O-8	5/812	Brugë	615.75	615.75		27	86	615.75	0	-	-	-	-	-	
5	KOLETË AGUSTIN ANGJELIN EMILJA KARMEN	SHAN ENRIK ENRIK PIERIN	SUMA SUMA KOLIQI MARTINI	Shkodër	8594	N,O-8	5/468	Truall	134	134		20	107	43.7	12,223.00	534,145	0	0	-	534,145	
6	KOLETË AGUSTIN ANGJELIN EMILJA KARMEN	SHAN ENRIK ENRIK PIERIN	SUMA SUMA KOLIQI MARTINI	Shkodër	8594	N,O-8	5/206	Truall	1019.5	1019.5	113	27	188	212	12,223.00	2,591,276	0	0	-	2,591,276	
7	KOLETË AGUSTIN ANGJELIN EMILJA KARMEN	SHAN ENRIK ENRIK PIERIN	SUMA SUMA KOLIQI MARTINI	Shkodër	8594	N,O-8	5/467	Truall	236	236		20	108	70.3	12,223.00	859,277	0	0	-	859,277	
8	SHIET			Shkodër	8594	N,O-8	5/413	Truall	254	254		43	127	0	0	-	0	0	-	-	
9	BASHKIA SHKODER			Shkodër	8594	N,O-8	5/414	Truall	2173	2173	1121	43	128	0	0	-	0	0	-	-	
10	SKA INFORMACION			Shkodër	8594	N,O-8	5/375	0	0	0		0	0	0	0	-	0	0	-	Ska informacion.	
11	SKA INFORMACION			Shkodër	8594	N,O-8	5/378	0	0	0		0	0	0	0	-	0	0	-	Ska informacion.	
12	SKA INFORMACION			Shkodër	8594	N,O-8	5/379	0	0	0		0	0	0	0	-	0	0	-	Ska informacion.	
13	SKA INFORMACION			Shkodër	8594	N,O-8	5/376	0	0	0		0	0	0	0	-	0	0	-	Ska informacion.	
14	SKA INFORMACION			Shkodër	8594	N,O-8	5/377	0	0	0		0	0	0	0	-	0	0	-	Ska informacion.	
Total																4,942,981			1,362,888	6,305,869	

**VENDIM****Nr. 2070, datë 23.4.2026**

Nr. 6659/1669/1152/834/718/635/571/506
Regj. Themeltar
Datë regjistrimi 26.2.2019

SHKURTIM VENDIMI

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, me trupë gjyqësore të përbërë nga:

Gjyqtare: Amarilda Sulaj

Asistuar nga sekretar gjyqësor Klodiana Bishaj, sot më datë 23.4.2026, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile, që u përket:

KËRKUESE: Pëllumb Veizaj, i biri i Qamil dhe Dylbere, dtl. 7.12.1953, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, me shtetësi shqiptare, identifikuar me ID me nr. personal: F31207075S, përfaqësuar nga av. Fabjan Mehmeti me nr. licence 4368 dhe NIPT: L92210035B, anëtarë i Dhomës së Avokatisë Tiranë..

PERSONA TË TRETË: Shoqëria “Albit Diabra” sh.p.k. përfaqësuar nga administratorja e falimentit Shpresa Breçan dhe av. Fatjon Vila, me nr. license 8522, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, sipas prokurës së posaçme nr. 1724 rep., nr. 632 kol., datë 14.4.2019. Sejko Zeqiri, i biri i Jaho dhe i Feride, i datëlindjes 5.11.1952, përfaqësuar nga av. Fabjan Mehmeti me nr. licence 4368 dhe NIPT: L92210035B, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, sipas prokurës së posaçme nr. 1834 rep., nr. 449 kol., datë 27.3.2024.

Shoqëria “Tirana Auto” sh.p.k., përfaqësuar nga av. Saimir Kola me nr. licence 1448, anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë.

Drejtorja Rajonale e Tatimeve, përfaqësuar me autorizim nga z. Medi Duka.

Drejtorja e Taksave dhe Tatimeve Vendore, përfaqësuar me autorizim nga znj. Alma Ballçaj.

OBJEKTI: Miratimin e Raportit të Administratores së Falimentimit të datës 22.1.2026, për “Mbylljen e procedurës së falimentimit të ‘Albit Diabra’ sh.p.k.” shoqëri në procedurë falimentimi.

BAZA LIGJORE: Neni 144, 145, 146, 151, i ligjit nr. 110/2016, “Për falimentimin”.

Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga ana e Administratores së Falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k., dëgjoi këtë të fundit në

seancën gjyqësore të datës 23.4.2026, shqyrtoi edhe raportin e përgatitur nga ana e administratores së falimentimit të emërtuar: “Për mbylljen e procedurës së falimentimit të shoqërisë ‘Albit Diabra’ sh.p.k., shoqëri në procedurë falimentimi”, dëgjoi edhe përfaqësuesit e kreditorëve të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k. të cilët ishin dakord me përfundimin e procedurës së falimentimit,

VENDOSI:

1. Përfundimin e procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k.

2. Miratimin e raportit të administratores së falimentimit datë 22.1.2026, të mbylljes së procedurës së falimentit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k.

3. Urdhërohet mbyllja e llogarive bankare të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k.

4. Urdhërohet botimi i një kopje të shkurtuar të këtij vendimi për përfundimin e procedurave të falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k., në faqen elektronike të Gjykatës, në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe në Fletoren Zyrtare.

5. Urdhërohet administratorja e falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k., znj. Shpresa Breçani që të depozitojë vendimin e përfundimit të procedurës së falimentimit të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k. në regjistrat përkatës, me qëllim fshirjen si debitore të shoqërisë “Albit Diabra” sh.p.k. nga këto regjistra.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, afat i cili për të gjitha palët e procedurës së falimentimit fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

U shpall në Tiranë, sot më datë 23.4.2026.

SEKRETARE
Klodjana Bishaj

GJYQTARE
Amarilda Sulaj

K/SEKRETARE
Mimoza Tafa

Shënim. Vendimi mori formë të prerë pasi nuk u ankimua më datë 6.7.2026, Tiranë më 8.7.2026.



	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2026

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 288 lekë



[[FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË]]Vulosur elektronikisht nga Qendra e
Botimeve Zyrtare|Viti: 2026 - Numri: 165|Datë: 30.07.2026 14:36:16
+02:00|6b93dc58-36af-4736-b361-8ee29a56260a

Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik(Qendra e
Botimeve Zyrtare)